



SHIKOJ.COM

## Hyrje

Historianët flasin dhe shkruajnë për kulturat e krijuara nga popuj prehistorik dhe historik, por në lidhje me etnicitetin e popujve që krijuan këto qytetërime, ata flasin pak ose aspak. Me ose paqëllim ata e trajtojnë problemin e etnisë së këtyre popujve si çështje jo parësore. Duke lënë pas dore një temë të tillë, shpesh janë bërë edhe gabime trashanike në histori, pasi nuk janë studiuar kultura dhe gjuha e kombeve, që janë pasardhës direkt të këtyre popujve antik, me qëllim që të nxirret në pah e vërteta historike.

Kanë qënë historianët e huaj dhe veçanërisht austriakët, gjermanët dhe së fundmi amerikanët, që i kanë mëshuar me të drejtë rolit të etnisë më të vjetër evropiane. Kjo çështje fatkeqësisht nuk është parë fare nga historiografia shqiptare, pasi historianët shqiptarë janë marrë më tepër me vërtetësinë se shqiptarët janë pasardhësit e ilirëve, gjë që nuk diskutohet fare nga qarqet e historisë botërore, duke lënë pas dore shtrirjen dhe rolin etnik pellazgo-ilir dhe kulturën e tyre.

Historianët shqiptar duhet të jenë të parët që të shkruajnë, pasi një mangësi e historianëve të huaj është mosnjohja e gjuhës shqipe, e cila është çelësi i zbërthimit të kësaj historie. Edhe nëse ata do të dinin shqipen, nuk do njihnin dot dialektet dhe nëndialektet e saj të cilat edhe unë që jam shqiptar, nuk i njoh në nivelin e duhur.

Sigurisht që historianët dhe gjuhëtarët e huaj, nuk dinë se shqipja gjendet në të gjitha gjuhët e Evropës dhe në të dy gjuhët klasike antike, të cilat pa shqipen shpesh nuk kanë kuptim. Kjo gjetje e shqipes në këto gjuhë është justifikuar nga disa historianë që nuk dinë asnjë fjalë shqip, si huazim që ka bërë shqipja dhe në mënyrë tepër naive edhe gjuhëtarët e Shqipërisë, vazhdojnë t'u mbajnë këngën duke mos bërë asnjë studim serioz në lidhje me këtë çështje.

Fakti që shqipja, ndodhet në të gjitha gjuhët evropiane dhe në të gjitha gjuhët e quajtura nga studiuesit si indo-evropiane, tregon se është gjuha mëmë e tyre. Ajo gjendet kudo dhe ka rolin shpjegues të kuptimit të këtyre gjuhëve, të emrave të vendeve, maleve dhe lumenjve.

Të dhënat arkeologjike kanë treguar se kultura e bronzit në Evropë ka qënë uniforme. Varrimi me tuma dhe sëpata dyteheshe dhe shumë materiale arkeologjike, gjenden në të gjithë Evropën dhe Azinë Qëndrore, madje gjurmë të tyre janë gjetur deri në kontinentet Amerikane dhe Aziatike. Sipas të gjitha të dhënave historike, arkeologjike, gjuhësore dhe antropologjike, popullsia që krijoi këtë kulturë të bronzit ishte e etnicitetit pellazgo-ilir.

Edhe në Bibël thuhet për një popull që lundron të gjitha detet e botës dhe që lidhet me një popullsi të racës evropiane, e thënë më qartë atë pellazgo-ilire, që themeloi edhe kulturën më të vjetër evropiane. Pa frikë mund të thuhet se epoka e bronzit, ishte periudha e dominimit të kësaj popullsie në të gjithë territoret e zhvilluara të botës antike, nga Gjibraltari deri në Indi e ndoshta më tej. Ata janë krijuesit e qytetërimeve të para etnike evropiane si atij të Kretës, Trojës, Mikenës dhe Etrusk. Të dhënat tregojnë se janë ata që kanë themeluar dhe ngritur qytetërimet e para në Egjipt dhe Mesopotami, pasi antropologjia, arkeologjia dhe historia, tregojnë për praninë e kësaj popullsie në këto vende.

Pothuajse të gjitha kombet antike evropiane janë me origjinë nga substrakti pellazgo-ilir. Këtu, nuk bën përjashtim as Greqia e Roma, pasi të dhënat tregojnë se popullsia paragreke, por edhe ajo antike greke, ka qënë e një prejardhje pellazgo-ilire, po ashtu dhe ajo romake. Qytetërimi greko-romak, do ishte më drejtë që të quhej një nga fazat e zhvillimit të qytetërimit pellazgo-ilir. Ai nuk është gjë tjetër, veç fundi i këtij qytetërimi mijërvjeçar. Njihet qytetërimi antik, pasi ai ishte më afër historisë dhe kështu të gjitha mrekullitë e një kulture mijëra vjeçare etnike Evropiane, me pa të drejtë mbështillen në një epokë, në atë greko-romake.

Kombet antike evropiane, janë krijuar mbi bazën e këtij substrakti pellazgo-ilir, nga lëvizjet e fiseve të njëjta etnikisht brenda këtij territori, gjatë epokës së bronzit, por edhe të hekurit. Nga Atlantiku deri në Kaukaz, Evropa e bronzit ka folur një gjuhë pellazgo-ilire, nga trunгу i së cilës do krijoreshin dialekte dhe më pas gjuhë dhe kombe.

Ky substrakt ka luajtur rol vendimtar në krijimin e kombeve moderne evropiane. Emigrimi në masë, i popullsisë ilire, drejt perëndimit, njihet në histori me emrin *dyndjet gjermanike*. Territoret që popullsia ilirike u detyrua të lë bosh, u mbushën nga dyndjet e popullsisë iraniano-mongoliane, të cilat janë quajtur si avare, sllave, turke dhe që përfunduan në pjesën lindore të Evropës vetëm në shekujt XIII.

Ajo që kam trajtuar në këtë studim, është roli i ilirëve në krijimin e kombeve të Evropës, si dhe roli i gjuhës shqipe në lindjen e gjuhëve evropiane.

Pra katër janë tezat që kam si qëllim të vërtetoj:

- 1 – Substrakti pellazgo-ilir i Evropës prehistorike dhe antike.
- 2 – Origjina pellazgo-ilire e kombeve antike evropiane duke përfshirë atë romake dhe atë para-greke dhe antike-greke.
- 3 – Origjina ilire e shumë kombeve moderne evropiane.
- 4 – Shqipja apo dialektet e saj, ka qënë gjuha që ka folur ky substrakt evropian, nga u krijuan gjuhët moderne.

Për të vërtetuar këto teza kam shfrytëzuar të gjitha burimet historike që vijnë nga antikiteti si dhe kronikat mesjetare. Jam mbështetur dhe në të dhënat arkeologjike dhe antropologjike, për të nxjerrë ngjashmëritë kulturore dhe antropologjike. Risia e këtij studimi është fakti se kam analizuar edhe gjuhët më kryesore evropiane antike dhe moderne për të nxjerrë në pah, ngjashmëritë që ato kanë me shqipen dhe kam shpjeguar kuptimin e fjalëve të tyre me anë të shqipes.

Këto përkime dhe përkthime gjuhësore i kam realizuar nga gjuhët letrare aktuale të këtyre kombeve, se nëse do të njihja dialektet e tyre pa frikë mund të thuhej se nga ato mund të dilnin thesare. Siç do e shikojmë, shqipja luan rol kryesor në formimin e këtyre gjuhëve, pasi ajo është pasardhësja direkte e substraktit pellazgo-ilir të Evropës. Fal maleve dhe krenarisë së shqiptarit, sot bota ka të gjallë gjuhën substrakt, që mendon se është zhdukur, por që për shumë gjuhëtar dhe historianë, ashtu si dhe për mua, ajo është e gjallë dhe ruhet tek gjuha shqipe dhe atyre që dyshojnë iu themi ta mësojnë shqipen dhe pastaj të flasin.

Manjani e quan shqipen si: “... ajo gjuha e mrekullueshme që i përngjan një vendburimi të pasur, mbi të cilin mjafton të përkulesh dhe të mbledhësh kokrriza ari filologjik” (Z.Manjani, Fund i Misterit Etrusk, 1973, f.69)

## **Roli pellazgo-ilir, në krijimin e kombeve antike evropiane**

### **Territoret e mirëfillta pellazgo-ilire**

Për të kuptuar më mirë se kush ishin popujt më të vjetër të Evropës dhe lidhjet etnike që ekzistonin midis tyre, së pari do ta fillojmë me popullin e parë evropian, atë pellazgo-ilir.

Pellazgët, sipas burimeve historike, janë populli më i vjetër i Evropës. Ata konsiderohen nga autorët antik si të parët që kanë banuar Greqinë. Ndoshta për vjetërsinë dhe fisnikërinë, ata janë quajtur nga autorët antik me një fjalë “*të shenjtë*”.

Dionisi i Halikarnasit, thotë se pellazgët afër Dodonës, janë të shenjtë dhe askush nuk guxon të bëj luftë me ta. Madje autorët antik thonë se ata kanë qënë në territorin e Greqisë së sotme edhe para përmbytjes së madhe. Për herë të parë pellazgët përmenden në Iliadë si aleatë të Trojanëve.

**Homeri i vendos pellazgët në Azi të Vogël në Larisën pjellore (Ilirët dhe Iliria f.9), në Argon pellazgjike (Ilirët dhe Iliria f.9), në Dodonë (Po aty f.9) dhe në Kretë. Ai e quan Zeusin e Dodonës si Pellazgjik.**

**Herodoti i vendos pellazgët në Arkadhinë pellazge, (Ilirët dhe Iliria. f.16), në Krestonë të Thrakisë (Po aty), në Thesali (Po aty), në Athinë dhe Helespont (Po aty).**

Plini një autor romak, shkruan për pellazgët se: “**Peloponezin e quanin më parë Apia dhe Pellazgjia. Arkadhia, më parë, quhej Drymode dhe pastaj Pelasgia. Vjen pastaj Haimonia që ka ndryshuar shpesh emrin duke u quajtur Pelasges dhe Argo Pellazgjike (Po aty f.195)**

**Ishulli i Samothrakës ka qënë banuar më parë nga pellazgët. (Herodoti lib.II f.51) Ishulli i Samosit ku ka lindur Pitagora, është quajtur si ishull ku kanë banuar pellazgët.(Herodoti lib. I. f.142) Ishulli i Lesbos që lindi burra si filozofët Pitakus, Theofrasti historianët Helaniku dhe Theofan si dhe poeteshën Safo, është quajtur Pellazgjia.(Strabon lib. V. f.2, 4; Herodoti lib. V f.26) Ishulli i Rodos ku ndodhej një nga shtatë mrekullitë e botës antike, kolosi i diellit, ishte pellazg. (Diodor Siciliani lib. V f.55; Strabon lib. X f.3) Po kështu edhe në ishullin e Kosit dhe Eubes (Strabon lib. XIII f.3.3)**

Straboni thotë se: “**Pellazgët kanë qënë një popull madhështor, i cili mund të dokumentohet edhe nga burime të tjera. Sa për pellazgët, të gjithë janë të mendimit se ishin një fis i vjetër i përhapur në të gjithë Heladën e sotme, e sidomos në vendin e Eolëve afër Thesalisë. Për më tepër Thesalia, e cila gjendet midis grykës së Pineit dhe Thermopileve, quhet Argo Pellazgjike. Shumë autorë i kanë quajtur edhe Epirotët Pellazgjik, sepse ata shtriheshin deri atje në Epir.**

Menecratos Elaita na tregon se e gjithë zona detare që quhet Jonia duke filluar nga Mykale dhe ishujt fqinjë, kanë qënë banuar dikur nga pellazgët (Straboni lib. XIII 3.3, Herodoti lib. VII f.94).

**Në Efes ndodhej tempulli i Dianës që Jordanes thotë se e kanë ndërtuar Mysët. Ky tempull që ishte një nga mrekullitë e botës së vjetër, paraqet një nënë që ushqen të gjitha qeniet njerëzore dhe për idetë fetare pellazge, ajo e kishte kraharorin të mbuluar me gjinjë.(Pausania libr. IV f.31.6 dhe VII 5.2).**

Muret si ato që quhen pellazgjike gjenden nga Azia e Vogël deri në Spanjë dhe quhen ciklopike, që do të thotë se ata janë shtrirë deri në Spanjë ashtu siç tregojnë edhe burimet e tjera historike. Një pjesë e madhe e pellazgëve të Atikës së quajtur Jonë, u shpërngulën për në vendet e tjera brenda botës pellazgo-ilire, midis të cilëve themeluan edhe qytete apo koloni për shkak se

toka e Atikës ishte e pakët dhe nuk mund t'i ushqente. Brenda territorit ku ka qënë banuar me pellazg, ka pasur lëvizje të këtyre fiseve.

Herodoti thotë se: *"Pellazgët u detyruan të braktisin Atikën dhe u shpërndanë në vende të ndryshme ku një pjesë e tyre shkoi në Lemn..."*. (Po aty).

Dionis Halikarnasi, tregon gjithashtu për shpërnguljen e një pjese të pellazgëve. Ai thotë se: *"... duke u shpërndarë gjatë ikjes një pjesë e pellazgëve shkuan në Kretë, të tjerët pushtuan disa nga ishujt ciklade, një pjesë zunë vendet rreth Olimpiti dhe Osës, të tjerët shkuan në Beoti, Fokidë dhe Eube kurse ata që u hodhën në Azi, zunë vende pranë brigjeve të Helespontit. Pastaj pellazgët që banonin në të quajturën, Thesali të detyruar të lënë vendin e tyre shkuan dhe u vendosën pranë aborigëve. Aborigët i pranuan ata më tepër se ishin të afërt nga raca. Raca e pellazgëve ishte nga Peloponezi dhe ishin autokton.* (Po aty f.166)

Jonët-pellazg, ndërtuan atë që quhet qytetërimi i Athinës, ku mbizotëronte forma demokratike e drejtpërdrejt e qeverisjes, në të cilën merrnin pjesë vetëm burrat. Ky kuvend, i cili ishte më i madhi, është tipik me kuvendin e malësive të Shqipërisë, që gjithmonë kryesohej nga një pleqësi, që merrte dhe vendimet më të rëndësishme. Pavarësisht se ajo ishte më e zhvilluar se kaq, pasi kemi formimin e një qytet-shteti, ngjan me kuvendet e maleve shqiptare, të cilat ishin për një zonë të caktuar. Jonët-pellazg, i kanë dhënë qytetërimin botëror arritje tepër të larta kulturore dhe mendje të mëdha, të cilat kanë hedhur bazat e shkencave të ndryshme shoqërore dhe natyrore.

Pra, pellazgët, janë shtrirë në të gjithë territorin e Greqisë antike, Maqedonisë, Epirit, ishujve të Egjeut, Azisë së Vogël si dhe në Itali, siç do e shikojmë më pas ku do jepet më qartë shtrirja dhe kultura e tyre. Shohim shtrirjen e ilirëve sipas autorëve antik.

Mendoj se emri Ilir, për ilirët është një emër shqip dhe do të thotë i-lirë, pasi ata ishin një popull luftarak që nuk vihej dot nën pushtetin e të tjerëve dhe shpesh kanë pushtuar botën. Disa studiues mendojnë se kështu i kanë quajtur helenët e lashtë ndaj dhe nuk mund të jetë një fjalë shqipe. Studiuesit duhet të dinë mirë se helenët e lashtë ishin të gjithë pasardhës të fiseve pellazgo-ilire dhe patjetër kanë folur shumë mirë këtë gjuhë. Por lidhur me etnicitetin pellazgo-ilir të Grekëve antik, do të flasim më pas.

Apianit, i cili është i vetmi studiues romak që ka shkruar një vepër për Ilirinë, thotë se: **"Bijtë e Ilirit janë Enheleu, Autari, Dardani, Medi, Taulanti dhe Perrebi, vajzat e tij ishin Partha, Daortha, Dasara dhe të tjera nga kanë rrjedhur Taulantët, perrebejt, enhelejt, autariatët, dardanët, parthinët, dasaretët, dhe darsejt. Thonë se Autari pati për bir Panonin ose Paionin dhe ky i fundit pati për bir Skordiskun dhe Tribalin nga të cilët morën emrat fiset.**

**Sa për fiset Ilire këta janë edhe tani shumë të dëgjua siç është e natyrshme në një vend kaq të gjerë, këta banojnë ndër krahinat e Skordiskëve dhe Tribalëve. Pas Ardianëve janë Liburnët, një tjetër fis ilir.** (Apiani, Illyrike f.2-3).

Apiani vazhdon: **"...Thashë gjer këtu se cilët konsideroheshin ilirë prej helenëve, ndërsa për romakët, jo vetëm ilirët po edhe paionët që janë afër tyre edhe retët, edhe morikët edhe myzët që janë në Evropë edhe tërë fiset që janë kufitare me këta që banojnë nga e djathta e atij që lundron nëpër Istër nga lart-poshtë, i dallojnë nga helenët siç bëjnë edhe helenët vet dhe i quajnë secilin me emrat e tyre të veçantë, por viset e gjithë këtyre i quajnë me emrin e përbashkët Ilir.** (Po aty f.6)

Pra Apiani e shtrin konceptin Ilir, në të gjithë Ballkanin deri në Norikum që është edhe Austria e sotme. Ilirët kanë banuar edhe në Itali si Mesapët, Japigët, Daunët, Venetët, Retët,

Vendolikët etj. Autorët gjermanë i konsiderojnë ilirët si një etni që janë formuar në Lusace krahinë në Polonin perëndimore, pasi ka ngjashmëri kulturore midis ilirëve, të kulturës së vjetër Hungareze dhe asaj të Luzacit (Arsim Spahiu, Ilirët dhe Pellazgët në Greqin e vjetër 2006, f.31) Disa studiues e lidhin krijimin e tyre në Ilirinë e veriut në territoret e sotme Hungareze.

Por siç do e shikojmë, ata gjenden kudo në Evropë dhe është e vështirë të përcaktosh se ku u krijuan saktësisht ata. *Ilirët patën një nivel të lartë shtrirje në epokën e bronzit dhe ata dallohen për varrimet tumolare si dhe për sëpatën dytehtëshe, të cilat nga të dhënat arkeologjike tregohen se ndodhen në të gjithë Evropën, nga Skandinavia në Mesdhe dhe nga Anglia deri në Azi të Vogël dhe Ukrainë, madje deri në Azinë Qëndrore.*

Kultura e hekurit e Hallshtatit në Austrinë e shekullit të VII p.k., ka ngjashmëri me kulturën ilire. Ajo është quajtur iliro-kelto-venete, pasi këto popuj ishin të njëjtë nga pikpamja etnike dhe kjo duket edhe nga kultura materiale. Ka ngjashmëri në metalurgji midis ilirëve dhe Bohemëve, Moravës e Bavarisë. Nga të dhënat tregohet se ilirët kanë populluar të gjithë Evropën gjatë periudhës së bronzit dhe në ato territore që janë quajtur Kelte më pas. *Por keltët çfarë janë?*

Keltët nuk janë gjë tjetër veçse ilirë të cilët mund të jenë quajtur më pas me këtë emër, pasi ata dalin në histori shumë vonë. Edhe dakët nuk quheshin ilirë, por siç do e shikojmë, ata ishin të një etniciteti me ilirët. Vetëm disa studiues e pranojnë se Hallshtati i shekullit të shtatë ishte edhe kulturë kelte, pasi nuk ka pasur të dhëna më para për një kulturë arkeologjike kelte. Pra, mendoj se kanë qënë një degë e ilirëve dhe siç do e shikojmë më pas kjo vërtetohet, jo vetëm nga të dhënat arkeologjike, por dhe nga ato historike.

Sot nuk janë vetëm shqiptarët pasardhës të ilirëve pasi, siç do e shikojmë, shtrirja e tyre ishte gjigande dhe nga ata kanë gjak, pothuajse të gjitha kombet e Evropës së sotme. Evropa në antikitet ka patur një substrakt etnik dhe mesa del, të vetmit që kanë ruajtur gjuhën e popullsisë që ka folur pjesa më e madhe Evropës, janë shqiptarët e sotëm. Pra, me një fjalë shqiptarët, janë të vetmit që ruajnë gjuhën e ilirëve më pastër se të tjerët, ndërsa, kombet e tjera kanë trashëguar nga ilirët përsa i përket gjakut dhe gjuhës. Shumë studiues e lidhin këtë me faktin se shqiptarët i ruajtën malet nga mosasimilimi nga popullsitë barbare që emigronin nga Azia në drejtim të Evropës.

*A kanë lidhje pellazgët me ilirët?*

Të dhënat tregojnë se kanë qënë të një etnie. Kështu epirotët, maqedonasit, thrakët, dakët quheshin me emra të ndryshëm, por ishin etni e njëjtë. Kjo ndodh edhe me pellazgët.

Maqedonët antik, janë quajtur nga autorët antik si *Pellazg*, pra automatikisht të një etnie me epirotët.

**Kështu Justini thotë se: “Maqedonasit ishin Pellazgë. (Justinin lib.VII 1.1) Maqedoni del në gjenealogjinë e dhënë nga autorët antik, si pasardhës i Pellazgut”(Apollodorus lib.II. 8.1)**

**Herodoti thotë se pellazgët që jetojnë në rajonin e Pindusit janë quajtur Maqedon(Herodoti lib. I f.56).**

Nga ana tjetër Maqedonia është quajtur edhe **Paioni pra Ilire**, kjo do të thotë se nuk ka pasur dallim etnik midis pellazgëve dhe ilirëve, thjesht ata janë quajtur me emra të ndryshëm, por kanë qënë etni e njëjtë.

Disa kërkime bashkëkohore i lidhin **Dryopët si me pellazgët dhe me ilirët. Disa autorë i konsiderojnë si pellazg që kanë zënë vend në jug të Thesalisë dhe disa, si ilirë pasi kanë prapashtesën iop. Ky emër ka lidhje me fjalën shqip dru.**(Arsim Spahiu, Pellazgët dhe Ilirët në Greqin e vjetër, f.36)

**Jazoni është vëllai i Pellazgut sipas legjendës së Argosit. Por sipas një tradite tjetër ai është vëllai i Dardanit Ilir. Jazi është quajtur dhe një krahinë e Panonis së Ilirisë. Pellazgët njëlloj si ilirët, aplikonin fenë Druide, ashtu siç aplikonin në atë kohë e gjithë Evropa.**

**Hesiodi thotë se nga i biri pellazgut, nga hyjnori Lykaon, lindën gjashtë djem”.**

**Thesproti ishte i biri i Lykaonit dhe se nga ai rrjedhim nipi i Pellazgut. Kaonët dalin si fis Trojan, por edhe epiroto-pellazg, edhe si fis ilir në Itali.**

**Haemoni është banori i Haemonis dhe është i biri i Pellazgut dhe ati i Thesalit. (Straboni, IX, 5.23) Nga ana tjetër ai është nipi i Polidorit dhe është ilir, pasi Polidori është vëllai i Ilirit.**

Të dhënat gjuhësore që janë të pakta nga gjuha që kanë folur pellazgët, janë vetëm disa fjalë apo emra vendesh të cilat kanë lidhje me shqipen, si fjala *aspēt* që përdoret për Akil këmbë *shpejtin* dhe që lidhet po me fjalën *shpejt* të shqipes që ka po këtë kuptim. Fjala *pelīa* për *pleqtë*, e cila lidhet me fjalën *pleq* të shqipes. *Kodra* që quhet po një qytet pellazgjik që lidhet me fjalën *kodra* të shqipes. Shumë studiues serioz kanë përkthyer mitologjinë dhe emrat e heronjve dhe toponimisë së pellazgëve me shqipen e sotme.

Shqiptarët e sotëm, janë popull pellazgo-Ilir, flasin në të njëjtën gjuhë, që tregon se në antikitet pellazgët dhe ilirët kanë qënë të njëjtë etnikisht. Kështu, kombi shqiptar është epirot, pra pellazg pasi Epiri antik zë pjesën më të madhe të atij që quhet shtet shqiptar, është Maqedon, pasi shqiptarët etnik banojnë në një territor të gjerë në Maqedoninë antike. Pra meqë janë maqedon, janë pellazgë, pasi maqedonët quhen si pellazg. Nga ana tjetër nga të dhënat e tjera, maqedonët janë quajtur edhe si paion që nga Homeri, Herodoti, Straboni etj. Por paionët ishin një fis ilir, që do të thotë se maqedonët janë edhe ilirë. Dardanët ishin një nga fiset më të rëndësishme të ilirëve, që janë autokton dhe sot quhen shqiptar ashtu si dhe epirotë dhe maqedonët pellazg. Kjo tregon se nga etniciteti, pellazgët dhe ilirët kanë qënë të njëjtë.

Lidhur me autoktoninë e shqiptarëve në këto territore nuk ka diskutim nga historianët që ata janë pasardhës të popullsisë së vjetër ilire, por edhe pellazge, përderisa një pjesë e shqiptarëve të sotëm rrjedhin nga ata. Faktet historike dhe gjuhësore tregojnë se shqiptarët si komb janë krijuar në territoret që kanë. Lidhur me këtë çështje do flasim veç.

Disa studiues sllav, të cilët me doemos duan të nxjerrin sllavët si pasardhës të ilirëve, sulmojnë origjinën ilire të shqiptarëve, duke pretenduar se shqiptarët në këtë territor kanë ardhur me turqit, pra pas sllavëve. Se gjoja shqipja nuk ka fjalë tek greqishtja dhe latinishtja dhe kjo tregon se shqiptarët nuk kanë qënë këtu në kohët e lashta. Kjo tingëllon sa absurde aq dhe qesharake. Pse?

Shqipja sot ka fjalë si tek greqishtja dhe latinishtja dhe siç do e shohim në këtë studim shumë fjalë të latinishtes së vjetër dhe të re si dhe greqishtes së vjetër dhe të re janë të përbashkëta me shqipen.

Por ajo që është edhe më e madhja nga të gjitha shqipja i shpjegon kuptimin e këtyre fjalëve që tregon qartë se ato janë gjuhë derivative të shqipes. Shqipja jo vetëm ka qënë krijuar këtu, por është ajo që lindi këto gjuhë. Ndaj disa historian amator bëjnë mirë të studiojnë shqipen përpara se të flasin për të. Pasi të mësojnë shqip, të flasin për shqipen se aty i kanë të gjitha misteret historike dhe gjuhësore të gjuhëve dhe qytetërimit Evropian.

Kjo që pamë më sipër ishte shtrirja e pellazgo-ilirëve sipas të dhënave direkte të autorëve antik, pra shtrirja de jure.

Për të parë shtrirjen e vërtetë të ilirëve, atë de facto, duhet të studiojmë të dhënat historike dhe gjuhësore që tregojnë lidhjen midis tyre dhe popujve të tjerë të Evropës antike si thrakët, dakët, skithët, trojanët.

Do analizojmë një për një të gjitha faktet e shumta historike për të nxjerrë lidhjet etnike midis këtyre popujve të antikitetit për të përcaktuar qartë shtrirjen e etnisë ilire në kuptimin më të gjerë, në atë real. Iliria që njihet nga autorët antik me emrin Iliri, ka një koncept më të gjerë nga kufijtë që i kanë vendosur historianët e më vonshëm. Shumë popuj si maqedonët, epirotët, dakët, thrakët nuk janë quajtur ilirë, por të dhënat tregojnë se ato kanë qënë të një etniciteti me to.

Fillojmë duke trajtuar së pari qytetërimet më të ndritura të epokës së bronzit dhe etnicitetin pellazg të tyre.

Etniciteti pellazgo-ilir i Kretës dhe Mikenës.

**Kretasit prehistorik** kanë krijuar një nga qytetërimet më të vjetra të botës dhe sigurisht qytetërimin më të vjetër Evropian. Shkalla e nivelit kulturor të qytetërimin Kretas ka qënë e përmasave të larta dhe paraqitet me cilësi origjinale Evropiane. Qytetërimi i Kretës i zhvilluar rreth 3000 deri në 1400 vjet p.k. paraqet një nga shkallët më të larta të historisë së qytetërimin botëror. Ai është quajtur ndryshe dhe si qytetërim pallator pasi jeta e qytetit organizohej rreth disa pallateve madhështore dhe tepër luksoze edhe për kohën që jemi sot. Qytetërimin të Kretës, përsa i përket etnicitetit, nuk i është vënë emri se kujt i përket, pasi në këtë kohë nuk ekzistonte nocioni grek, pasi nëse do të kishte ndonjë shenjë edhe më të vogël, padyshim do e kishin quajtur Grek.

*Cila është etnia që ka ngritur këtë qytetërim?*

Qytetërimi i Kretës ka qënë një qytetërim pellazg. Nga të gjitha burimet antike, Pellazgu mbahet si njeriu autokton dhe që ka lindur nga dheu. Meqë kjo kulturë është kaq e lashtë nuk ka se si të mos jetë ndërtuar nga i vetmi popull i lashtë, që kanë njohur autorët antik në atë dhe. Le të shikojmë të dhënat historike në lidhje me etnicitetin e Kretës së vjetër. Homeri përmend në Iliadë, midis disa fiseve të tjera dhe pellazgun, i cili është autokton në territoret e Egjeut.

Me të vërtetë vazhdon Straboni, shikojmë pellazg në Kretë sikur dëshmon Homeri duke i vënë Odiseut në gojë këto fjalë: “**Në këtë ishull ku banojnë Akejtë, eteokretët trima, kydonët, dorët trefish edhe pellazgët hyjnorë**”. (Straboni, gjeografia lib. V, f.152)

**Kreusi, sundimtari që i dha emrin Kretës ishte i biri i Tegetit nipit të Lykaonit** (Pauzania, lib. VIII, f.53.2). Pra me origjinë pellazgo-ilire, pasi Kaonët janë quajtur dhe pellazg dhe ilirë.

**Minosi, themeluesi i qytetërimin Minoan, është i biri i Zeusit dhe i Evropës, motrës së Ilirit, pra ai është nipi i Ilirëve.**

Të dhënat që japin autorët antik, tregojnë se në Kretë kanë banuar disa fise të tjera ilire si Mesapët, Japigët, Daunët, Peuketët.

Pasi Dedali u arratis në Itali, Minosi iu vu në ndjekje. **Kretasit organizuan një ekspeditë ndëshkimore ndaj Italisë, por u mundën dhe në kthim e sipër i nxori stuhia në brigjet e Italisë ku u quajtën Mesap.** (P.Grimal vep. e cit. f.298).

Pra Mesapët e Kretës quhen ilirë në Itali. Siç thuhet **Japyksi dhe të vëllezërit, Dauni e Peuketi eponime fisesh ilire janë bijtë e Ilirit Lykaonë të birit të Pellazgut** (A.Spahiu, Pellazg. f.126).



**Dardani stërgjyshi i Trojës dhe Romës ka lindur në Kretë**, por Dardani del fis ilir në Iliri.

Ashtu si pjesa e bronzit, e Ilirisë dhe gjithë Evropës, Kreta nuk ka qendra fetare, pasi praktikohet besimi fetar **druid**, i cili ashtu si dhe në Dodona e deri tek Baltët dhe Britanikët, nuk kishte tempuj, por vende në natyrë apo shpella. Varrimi në Kretë, zhvillohej si në pjesën tjetër të Evropës me **tuma**, për shkak të ngurtësisë së tyre të madhe, pasi atje dominon guri, janë quajtur tholosi.

Disa autorë mendojnë se Tholosi i Kretës ka ardhur nga ngurtësimi i tumës dhe varri me dhomëza, nga zhvillimi i natyrshëm i kisteve dhe gropave të mëparshme. Pra edhe ceremonitë e varrimit janë si të ilirëve.

Perëndeshat mbanin titullin **potnia** që shqip është **zotnia** që tregon dhe zotin apo perëndeshën. Hyjnitë që adhuroheshin, ishin pellazge. Simbol është gjarpri, një simbol ilir, të cilët shqiptarët me emrin gjarpri i shtëpisë, e nderojnë edhe sot. Kreta ka pasur dy lloj shkrimesh, në fillim atë piktorografik më pas atë linear A. Të dy këto lloje të shkrimeve nuk janë deshifruar, megjithëse për linearin janë bërë përparime në identifikimin e disa shkronjave.

P.Fauer nga 100 emrat e qyteteve të Kretës, 93 janë pellazg. Në listën e tij ai paraqet emrat si: **Albe, Arbis, Istron, Lisos, Malla, Kidonia** etj. (G.Rachet, 1993, f.253).

Fjala Kretë mund të shpjegohet edhe me fjalën *Kret* e shqipes, që tregon kryet apo kokën, pasi ajo ishte edhe komanduesja e Egjeut dhe Mesdheut Lindor, ndoshta mund ta ketë marrë këtë emër se është në krye të të gjithëve. Drer, quhet një vend në Kret që lidhet me fjalën *drer* të shqipes që edhe kaprolli, Thes me *thesin*, Fest me *fest*, Rethimno ka kuptimin *sirrethim* etj.

Edhe të dhënat që japin autorët antik tregojnë se ishin pellazgët që e ngritën këtë kulturë nga zero.

Kështu Diodor Siçiliani thotë se: “**Në Kretë tregohet se fiset pellazge qenë të parat që u mësuan njerëzve të ndërtonin anije dhe të zbusnin kafshët, u mësuan njerëzve artin e shigjetës dhe të jetonin në një shoqëri të përbashkët. Ata kanë qenë iniciatorët e zakoneve të mira dhe të një jete të rregullt dhe të moderuar.**” (Diodor Sicilius lib. V f.64).

“... Ata ishin të parët që kanë bërë sakrifica dhe ceremoni fetare për zotat. (Herodoti lib. II f.52) – thotë Herodoti – grekët i huazuan këto tradita nga Pellazgët” (Herodoti libr. II f.51-53).

Pausania thotë se: “**Burri i parë që ka lindur në botë ka qënë Pellazgu, një burrë i dalluar për përmasat dhe bukurinë e figurës së tij që i kalonte të gjithë të vdekshmit e tjerë për kualitetet e shpirtit. Pellazgu ishte i pari që u mësoi njerëzve që të ndërtonin shtëpi dhe të mbroheshin nga të ftohtit, ai u mësoi njerëzve që të bënin rroba nga lëkura e deles. Pellazgu ka lindur nga dheu për të qënë filluesi i genit të vdekshëm**”. (Pausania lib. VIII. 1.4)

Herodoti thotë se: “**Grekët nuk e dinë sot, që unë kam shkruar këto se nga e ka origjinën çdo zot, ose nëse ata kanë jetuar gjithmonë dhe se çfarë forme kanë patur. Emrat e shenjtorëve të cilët egjiptianët thonë se nuk i njohin, grekët i kanë marrë nga pellazgët**”. (Herodoti, lib. II f.50-53).

Pra edhe për autorët antik, pellazgët, janë të parët që shpikën dhe ndërtuan qytetërimin e Kretës. Pellazgo-ilirët e Kretës, arritën t'i japin botës një nga qytetërimet më të lavdishme, që shërbeu si baza ku u mbështet qytetërimi i Mikenës dhe ai Antik.

**Mikena**

Mikena ishte një qytet në veri-perëndim të Argos Pellazgjike në Peloponez. Ky qytet nuk dihet kur është themeluar, por mendohet se më herët se 1500 vjet p.k. Termi qytetërim Mikenas, është vendosur nga autorët e mëvonshëm, pasi popullsia e asaj kohe quhej si akease, danaj, argiane. Mikena zhvilloi shkrimin linear B, i cili është deshifruar, por nuk është përkthyer ende. Janë bërë përpjekje që ta shpjegojnë me greqishten, por nuk kanë arritur rezultat. Madje disa studiues naiv, ende dhe sot e quajnë shkrim grek, por pa përkthyer asnjë fjalë nga greqishtja. Askush nuk di edhe sot, të thotë se kush është greqishtja që nuk përkthen dialektet e antikitetit dhe jo më të flitet për të përkthyer shkrimin e Mikenës.

Aty janë gjetur disa maska prej ari të quajtura të Atreut dhe Agamemnonit, por ato datojnë rreth shekujve XVII-XVI, pra shumë herët. Në këto shekuj ka një teknikë të mirë të përpunimit të arit, por dhe në ndërtim siç shihet tek varret me kupolë. Mikena e ngritur pranë Argos Pellazgjike nuk ka se si të mos jetë veçse një qytetërim pellazg dhe të dhënat e tregojnë qartë këtë.

Të dhënat antropologjike dëshmojnë që në Mikenën e kësaj kohe popullsia ishte brachycefalas, ashtu siç ishte e gjithë popullsia e Evropës së vjetër. Sot, brachycefalas në Evropë janë shqiptarët, gjermanët, austriakët, zviceranët si dhe disa zona të veçanta malore. Kjo tregon se shqiptarët janë pasardhës të tyre.

Pra, edhe nga të dhënat antropologjike, tregohet se popullsia e Mikenës e asaj kohe ka qënë e njëjtë nga etniciteti me gjyshërit e shqiptarëve apo me shqiptarët sot.

Të dhënat arkeologjike tregojnë se në Mikenë dhe në Peloponez, ku u shtri ky qytetërim, është gjetur **varrimi me tuma**, i cili në këtë kohë lulëzoi në të gjithë Evropën. Tumat në Greqi janë zbuluar në **Kersoneza, Lerna, Argolid, Peloponez, Kos**. Gjatë epokës së bronzit të mesëm tumat përhapen në Greqinë kontinentale si **në Mesinë, Argolidë, Atik, Fokid**. Varrimi me tuma vazhdon edhe në bronzin e vonë në Beoti dhe në Peloponez pranë Mikenës. Ato nuk ndryshojnë nga tumat Ilire. Kjo është një provë e fortë se Mikena ka pasur një kulturë të njëjtë me pellazgo-ilirët.

Në epokën e bronzit, në Mikenë, nuk ka faltore si në epokën klasike dhe disa studiues mendojnë se nuk ka fe. Në fakt fe ka patur në epokën e bronzit në të gjithë Evropën, por ajo është quajtur me emrin shqip si **fe druide** nga emri **dru**, që tregon se drurin e lisit, ata e kishin si të shenjtë.

**Heroi i Mikenës është Mikeneu nipi i Froneut, që ishte pasardhës i Pellazgut** (Pauzania, II 15.5). Pra, meqë heroi nga ka marrë emrin Mikena, është pellazg, atëherë sigurisht, që e kanë themeluar pellazgët, popullsia që në Peloponez ka lindur nga dheu.

**Në Spartë ndodhet faltorja e Zeus Messapeus që tregon se edhe në Spartë ka patur fise ilire.** Kjo faltore ndodhej edhe tek fisi ilir i Mesapëve.

Tek Homeri, skena e vendetës dhe mbledhja e kuvendit të pleqve për të vendosur për pagimin e gjakut, i cili në kohën e Homerit edhe blihej, është i njëjtë me atë të shqiptarëve sot në disa zona të veriut ku gjaku edhe blihet. Këtë e ka vënë në dukje Nikolla Hamond. (N.Hamond 1993, f.217-218). Kjo tregon se ata kanë pasur zakone si të ilirëve, të cilat janë ruajtur në Shqipëri në disa zona të thella malore, të cilat dallohen për ruajtjen e traditave prehistorike.

Siç e pamë, popujt, që gjatë luftës së Trojës kanë banuar në Peloponez ishin Akejt, Argejt dhe Danajt. Le të shikojmë me radhë origjinën e tyre sipas të dhënave historike.

## **Akejt**

Me emrin Akej quhen Mikenasit gjatë luftës së Trojës. Kështu quhet Ake, Atreu, Menelau, Agamemnoni. Por të dhënat që jep Straboni, tregojnë se dinastia e Mikenës, ishte me origjinë nga Frigjia në Trojë të Azisë së Vogël. Kështu ai e sqaron qartë se gjatë luftës së Trojës në Mikenë qeverisin pellazgo-ilirët.

Ai citon Hekateun, nga Mileti, i cili thotë për Peloponezin se **“... këtu para helenëve kanë banuar barbar. Kështu Pelopi solli popullin nga Frigjia në vendin e quajtur sipas tij Peloponez, Danau erdhi nga Egjipti, kurse dryopët, kaukanët, pellazgët, lelegët e të tjerë, ndanë midis tyre viset brenda Ismit. Atikën, e pushtuan thrakët.”**(Ilirët dhe Iliria f.157).

Siç dëshmon Straboni në kohën e luftës së Trojës nuk ka fare koncept grek, pasi vet dinastia e Mikenës ishte nga Frigjia dhe pjesa tjetër e saj ishte nën pushtetin e fiseve të tjera pellazgo-ilire. Homeri e quan Menelaun leshverdh dhe Ake. Nëse këta Akej do ishin jashtë botës pellazgo-ilire dhe me origjinë aziatiko-afrikane, sigurisht që nuk ka sesi të ishte Menelau me lesh të verdha, pasi që andej nuk ka popullsi të tillë.

**Akeu është vëllai i pellazgut dhe i Fthiut.**(Herodoti, f.56). Pra, Akeasit janë pellazgë. M.Saqellariu vë në dukje se: **“... është e pamundur të jepen shpjegime për gjuhën e akeasve me anë të greqishtes dhe të dhënave greke. Gjuha e akeasve vjen nga substrakti parahelenik indo-evropian.”**(M.Saqellariu 1977, f.321)

### **Argejt**

Ishin një popull që banonte në Argo të Peloponezit. Të dhënat që japin autorët antik e quajnë Argon Pellazgjike. Pra të dy këto fise të epokës së luftës së Trojës ishin pellazge. Eskili, në Iktidet dhe Danaidet thotë se: **“... raca e pellazgëve kishte dalë nga Argo pranë Mikenës. Efori pretendon se dikur Peloponezi kishte mbajtur emrin Pellazgjia.”**(Straboni, Gjeografia, lib. V f.152)

### **Danau**

Ky është i vetmi fis në Greqinë e lashtë që nuk është pellazg, por egjiptian. Të dhënat tregojnë se danajt kanë emigruar nga Egjipti për në Pellazgji.

Eskili pranon prejardhjen egjiptiane të danajve, pasi ai tregon se ata ishin krejt të ndryshëm fizikisht, nga popullsia vendase.(Eskili, Lutset f.219-237). Kur Danau mbërrin nga Egjipti në Pellazgji, mbreti i vendit Pellazgu iu tha: **“Si mund të jeni ju të një race me ne? Ju ngjasoni me shumë libianë, pra jo grave të vendit tonë, sepse vetëm Nili mund të ushqejë një racë të tillë. Më tregoni që të bindem më mirë si mund të jenë argiane zanafilla dhe gjaku yt”.**(Euripidi Suppliantes 277-290). Danai, ishte i biri i Belit mbretit të Egjiptit dhe vëlla binjak i Aegipti. Mbreti i Egjiptit para se të vdiste e bëri Danaun mbret të Libisë, pasi kishte ngritur në Libi faltoren e Amonit.

Danajt kur erdhën nga Egjipti, i thonin Pellazgut, që ata ishin të një race me Argët, por ai u tregonte atyre se ata ishin një racë afrikane, që nuk kishin të bënin me pellazgët. Për këtë mund të ketë edhe një shpjegim tjetër.

Nga burimet historike, raca pellazgo-ilire, ka qënë krijuesja e dinastive të vjetra si në Egjipt, por edhe në Mesopotami e Indi. Ndoshta Danau që ishte bir mbreti mund të pretendonte se origjinën e kishte nga këto vende, por me qëndrimin e dinastisë së tij atje ata ishin afrikanizuar, pasi ishin përzier me popullsinë vendase. Ndaj dhe pellazgu i thotë se gratë tuaja nuk ngjajnë si gratë e Argosit që ishin të bardha, por si gratë e Libisë, që dalloheshin për lëkurën e tyre, të zezë midis të kuqes dhe kjo sigurisht nuk e bindte dot Pellazgun që ta pranonte atë si të

një race me veten. Vetë Danau, mund të pretendonte një origjinë pellazge, se ishte bir mbreti, por populli që ai solli mbas ishte i racës egjiptiane.

I vetmi element i huaj etnik në Mikenën apo Peloponezin antik, janë danajt, të tjerët janë pellazgët. Kështu që Mikenasit dhe qytetërimi i tyre ishte pellazg.

Euripidi, tek Arhelau, thotë se: **“Danau, i ati i 50 vajzave, si erdhi në Argo u vendos në qytetin Inah dhe urdhëroi që pellazgët të linin emrat e tyre dhe të quheshin danaj”**.(Straboni, lib. V, f.4) *Pra një pjesë e pellazgëve mund të jenë përzierë me këtë racë egjiptiane dhe sigurisht dhanë dhe morën nga kulturat e njëri-tjetrit. Se sa janë përzierë pellazgët vendas me këtë popullsi me origjinë egjiptiane dhe sesa ndikoi kjo në krijimin e kombit antik Grek, kjo mbetet për t’u verifikuar nga të dhëna të tjera. Shumë studiues mendojnë se veprat e Homerit janë shkruar shumë vonë dhe ndoshta janë shtuar disa gjëra që kanë ndodhur më pas. Ajo që vlen të theksohet është fakti se Mikenën e themeluan dhe ndërtuan pellazgo-ilirët dhe ishin ata që krijuan atë qytetërim.*

Megjithatë sërish pjesa më e madhe e pellazgëve e ruajtën identitetin e tyre dhe vazhduan të quheshin me emrat e tyre si Arge, Pellazg apo dhe emrat e fiseve të tjera.

Po japim disa fjalë nga gjuha Homerike të cilat nuk kanë lidhje me greqishten e sotme, por me shqipen e sotme.(A.Kola, Arvanitët, f.171).

Shqip	Greqishtja Homerike	Greqishtja sot
nëm	nëm	katara
anda ënda	andha	efkaristis
arë	arura	horafi
bashkë	vask	porevume
deti	theti	thalasa
dhe dheu	dhor, dha	ji
dru	dris	ksilo
edhe dhe	idhe	qe
errët	ere-vos	skotos
ethe	ethir	piretos
flas	flio	milao
fryma	frimao	fisima
iki	iki	fevgo
kalë	kelis-tos	alogo
korr	kir	thiro
krua	krunos	vrisi
kri, krye	krithen	qefalo
leh, lind	leh	jenieme
lepur	leporis	lagaes
lesh	lesios	mala
lig	ligos	adhinatos
loz	lizo	pezo
lutem	litome	parakalo
marr	mar-ptο	perno

iki	iko	fevgo
i marrë	margos	trelos
mend	mendothem	medhome sqeftome
mëri, mëni	minis	thimos
miu	mis	ponda
mjeshtë	mistor	tehntis
mjet	mitos	nima
ne	noi	emis
nisem	nisome	kseqinao
nuk	niuk	dhen
nuse	nisos	nifi
para	paros	brosta
për ty	par ti	jasena
punë	punos	dhulia
qen	qion	skilos
re	rea	sinefo
rrah	rahso	dherno
rronjë	rronio	zo
ruaj, rojtar	rrio, rritor	filaso
shkel	skel	patio
tati, ati	tata ata	patera
thërres	thros	fonazo
udha	odhos	dhromos
vanë	van	pigan
vend	ved	edhafos
vera	vear	kaloqeri
vesa	versa	dhrosos
vesh	ves-this	forao
zien	zei	vrazi

Siç e pamë, Kreta dhe Mikena prehistorike dhe ajo Homerike, kanë qënë banuar nga raca pellazge. Kultura dhe qytetërimi i Kretës, Mikenës dhe më pas ai i Athinës që ishte derivat i tyre, ishin qytetërime pellazgo-ilire. Le të shohim se sa kanë ndikuar pellazgo-ilirët, në krijimin e etnisë dhe qytetërimit antik grek.

### **Roli pellazgo-ilir në krijimin e etnisë dhe qytetërimit antik grek**

Deri pas luftës së Trojës në atë territor kanë banuar pellazgët, të cilët patën një qytetërim tepër të zhvilluar. Në shekullin e X, Greqia ka një regres kulturor dhe mendohet se ka dyndje të një popullsie të huaj. Mund të ketë dyndje të popullsisë të tjera që kanë patur edhe nivel kulturor më të ulët. Mund që edhe ky regres të ketë ardhur edhe si pasojë e rënies së fuqisë së pellazgëve që kishin dominuar gjatë bronzit të gjithë botën e atëhershme. Ajo që na intereson në këtë studim është etniciteti i fiseve që quheshin me emrin Grekë, në antikitet.

Shumë studiues bashkëkohorë, mendojnë se nuk ka një etnos grek në antikitet. Një nga ata është edhe Th. Harrison, i cili shkruan se: **“Helenët nuk përbëjnë një trung etnik e**

**kombëtar të veçantë, por janë grupe kulturor i disa popujve. Në kohët klasike, helenët e konsideronin veten një ansambël familjesh. Ata nuk përbëjnë një etnos.”**(Th.Harrison. 1988, f.24)

Grenier thotë se: **“Helenët përbëjnë një larmi të madhe etnike të shkaktuar nga origjina e tyre”**(J.de la Grenier, 1995, f.39)

Le të shikojmë me radhë të gjitha fiset e Greqisë antike dhe origjinën e tyre etnike.

### **Origjina pellazge e jonëve**

Origjina e grekëve të vjetër është një çështje e debatueshme, por ajo që është mëse e sigurtë dhe e qartë në këtë mes, është origjina pellazgo-ilire e tyre. Shumë autorë antik, i quajnë helenët si pellazg. Eforit, thotë për pellazgët se: *“... ishin me prejardhje nga Arkadia të dhënë pas jetës luftarake, të cilët u shtuan nga ata që morën anën e tyre dhe të cilëve ata u dhanë emrin e tyre. U bënë të famshëm ndër helenët dhe në të gjithë vendet ku vajtën.”*(Straboni, Gjeografia, liv V f.152). Edhe Tukididi thotë se emrin helen ia kanë dhënë Helladës, fiset pellazge.

Edhe Halikarnasi i quan pellazgët si helen dhe thotë se: **“Edhe raca e lashtë e pallazgëve, ishte helene nga Peloponezi. Në fillim, banonin pranë qytetit Argo e Ahes dhe ishin autoktonë** (D.Halikarnasi Lib. If.17) Pra emri pellazg helen identifikon po pellazgët e atij territori, që është quajtur Hellad dhe jo ndonjë nocion etnik abstrakt siç e emërojnë disa historianë sot.

**Athinën e kanë banuar fiset iliro-pellazge të lapëve, molosëve, thesprotëve, dardanëve.**(Homeri, Iliada f.72).

Në shekullin e V, Herodoti vëren se athinasit, arkadasit dhe argianët janë me prejardhje pellazge. Ai thotë se: **“Banorët e Atikës në kohën kur quheshin kranej, nën mbretin Kekrops ata u quajtën Kekropide, sipas emrit të këtij të fundit kur pushteti kalonte në duart e Erekteut, ata i thoshin vetes athinas dhe kur patën për shef Jonin birin e Ksuthit, morën emrin jonas.”**(Herodoti, VIII.44)

Po ky autor sqaron se: **“... pellazgët morën emrin jonas dhe eolasit ashtu siç thonin grekët, quheshin pellazgë. Pellazg ishin gjithashtu dhe arkadasit dhe argianët.”**(Herodoti, VII. 9)

Kështu Herodoti thotë se: **“... pellazgët kishin gjuhë barbare dhe del se popullsia e Atikës, me prejardhje pellazge, harroi të folurën e saj dhe u kthye në helene prej të cilëve mësoi edhe gjuhën”**(Ilirët dhe Iliria f.16)

Athinasit ishin autokton, kjo dëshmohet nga Isokrate tek Panegjiriket, ku athinasit thonë për veten e tyre kështu: **“Ne nuk e fituam vendin, por ne e mbajtëm atë duke dëbuar të tjerët nga ai. Nuk jemi një racë mikse e përzier me shumë kombe. Paraardhësit tanë janë kaq fisnik dhe gjeni, sa që ne kemi vazhduar për të gjithë kohën posedimin e vendit nga ku u shpërndamë duke qënë fëmijë të tokës që na lindi dhe në gjendje t’i drejtohem qytetit tonë me të njëjtat tituj që ne iu japim të afërmve tanë. Nga të gjithë helenët, ne kemi të drejtë ta quajmë qytetin tonë atdhe e nënë.”**(Sokrates, Panegjiriket 23-5)

Pra të dhënat e historianëve antik tregojnë qartë se athinasit që ishin jonë, ishin një racë autoktone, jo e ardhur nga diku me origjinë pellazge dhe e papërzierë me asnjë racë tjetër. Mendoj se Herodoti dhe Isokrati e kanë shpjeguar qartë origjinën pellazge të athinasve dhe nuk

ka nevojë për shumë komente. Duhet sqaruar se emri “jonë” është shqip dhe do të thotë po jonë, por edhe ion.

### **Origjina ilire e dorëve**

**Dori quhet i biri i Fthiut, por ky është një nga bijtë e Lykaonit, të birit të pellazgut.**(Apollodor, Bibliotheque, II, 8,1) Dorët mbaheshin si pasardhës të Herkulit, të cilëve iu ishte rrëmbyer fronit mbretëror nga Pelopi Frigas. I ati i Atreut dhe ata po riktheheshin ta merrnin. Ylli ishte një nga udhëheqësit e Dorit. Hyllasi ishte një gadishull i Ilirisë. Fjala “dorë” do të thotë në shqip po dorë dhe fjala “yll” po yll.

Në lidhje me vendbanimin e Hyllëve, autori Scylacis Cariandenis tek Periplus thotë: **“Banojnë aty, (në një pjesë të Ilirisë) popuj barbarë që quhen me një emër lotofagë, këta janë hierastamnët, bulinët, hyllët. Hyllët, thonë se aty kishte banuar Hylli, i biri i Herkulit. Këta janë barbar dhe banojnë në një gadishull pak më të vogël se Peloponezi. Prej këtij gadishulli gjatë bregut të detit ngjitur me ta, banojnë bulinët që janë ilirë.”**(Scylaksi, Illyroi, f.22)

Yllët, janë ilirë që kanë banuar afër Bulinëve para se një pjesë e tyre të emigrojë për në Peloponez, pra ata janë larguar nga Iliria. Bulinët, sot janë një krahinë e quajtur Mallakastër, në Shqipëri dhe afër tyre kanë qënë yllët që më vonë dalin si dorë. Pra, dorët kanë emigruar nga Iliria, që sot ndodhet në territorin e shtetit shqiptar. Ka disa mendime se mund të jenë edhe ku është sot Mali i Zi, që në atë kohë ka qënë Iliri. Është interesante se ai e quan fisin e yllëve të Ilirës si vend nga doli Ylli i dorëve, por nga ana tjetër ai i quan barbar, por këta barbar quheshin helen, pasi dorët ilirë quheshin jo barbar, në Peloponez. Është tepër e pasigurtë përdorimi i termit barbar nga historianët antik, nëse do të thotë i huaj apo personi që nuk ka një shkallë zhvillimi me ato fise që quheshin helene.

**Herodoti thotë se dorët ishin me prejardhje nga Maqedonia dhe se i pari i popullit të tyre ishte Pellazgu.** (J Burckhardt, 1998, f.287) **Ai thotë gjithashtu për dorët, se ata në fillimet e tyre ishin të dobët e bredharak dhe u shkëputën herët nga pellazgët...**

Macedon është emri i heroit që i vendosi emrin Maqedonisë. *Ai është i biri i Lykaonit stërgjyshit të Arkadasve Pellazg. Temeni, një nga gjyshërit e Maqedonasve, është një nga udhëheqësit e Heraklideve. Pasardhësit e tij janë përzënë nga Argosi dhe në Maqedoni themeluan mbretërinë e Maqedonisë.*

Herodoti thotë se: **“Perdika, i biri i shtatë i Aleksandrit, është ai që ndërtoi në këtë mënyrë shtetin e Maqedonasve. Prej Argoje shkuan tek ilirët tre vëllezër pinjoll të Temenit: Guani, Aeropi dhe Perdika, dhe duke ikur nga ilirët u vendosën në Maqedoninë e sipërme, në qytetin Lebae.”**(Herodoti, VII f.138). Disa studiues thonë se, meqë dinastia Maqedonase është themeluar nga Argo e Peloponezit, atëherë dinastia antike Maqedone është me prejardhje Greke. Justifikim tepër i gabuar. Pse?

Këtu bëhet fjalë, kohë para luftës së Trojës, ku pushtetin e merr Atreu Frigas në Peloponez, pra kohë kur i gjithë vendi ishte pellazgo-ilir dhe nuk ka mbi dhe, ndonjë komb grek. Siç po e shikojmë edhe kombi grek antik, ishte pellazg dhe autorët nuk duhet të ngatërrojnë grekët antik me ata modern. Këtu bëhet fjalë për lëvizje të popullsive nga territoret pellazgo-ilire në territoret e tjera pellazgo-ilire.

Së dyti ata ishin bijtë e Temenit, që në gjenealogjinë e shkruajtur nga autorët antik, janë pasardhës të Pellazgut. *Atëherë tre djemtë e një pellazgu të Temenit, ikën nga Argo Pellazgjike e Peloponezit tek pellazgo-ilirët që atë kohë quheshin me emrin Paioni apo edhe Maqedoni dhe aty*

*formuan këtë dinasti mbretërishe, që mori fund me Aleksandrin e Madh. E parë në këtë prizëm, Filipi i II ishte gjysëm ilir dhe gjysëm maqedon, por maqedonët quheshin ndryshe pellazgo-ilirë. Atëherë nga një baba pellazgo-ilir dhe nga një nënë epiroto-pellazge, lindi Aleksandri i Madh që ishte 100% pellazgo-ilir.*

**Edhe Platoni e thekson zbritjen e dorëve, por shton se ata nuk janë gjë tjetër veçse akej që ndërruan emrin, ndërsa Pindari i quan këta pasardhës të spartanëve, pasardhës të Herkulit dhe disa prej tyre të rekrutuar në ushtri.**

Pra ka tre variante në histori lidhur me origjinën e dorëve se ata ishin racë pellazge dhe që emigroi nga territoret e Ilirisë, të Maqedonisë apo Paionis, drejt Peloponezit, për të marrë pushtetin që iu kishin marrë Akejt. Tjetra është se, ishin Akej pellazgë që ndryshuan emrin në dorë.

Si do të jetë ajo, i sigurtë është fakti se ata ishin pellazgo-ilirë. *Dorët megjithëse erdhën të fundit në Greqi, dalloheshin nga helenët e tjerë jo nga qytetërimi, por nga shkalla e zhvillimit, duke u kujtuar për këtë qëllim, helenëve të këtushëm, rregullat e trashëguara të jetës shoqërore dhe zakonet e tyre të lashta.*(Po aty, f.92)

**Lidhur me dorët thuhet se ata zbritën në Peloponez 80 vjet pas pushtimit të Trojës.**

Dorët erdhën në dy valë. Së pari me pasardhësin e Herkulit **Hyllin** dhe vala e dytë mendohet se i ka prirë **Teutam**, ku sipas Saqellariut ky është emër ilir.(M.Saqellariu 1977, f.131).

Herodoti bën dallimin midis *tunikes* së hollë të jonëve *peplosit* doras, të bërë prej leshi. Herodoti thotë se dorët e kanë marrë këtë emër, pasi janë vendosur në Peloponez. Dorët ndaheshin në tre fise: në **yllë, dymanët dhe pamfilët**. Yllët e kishin prejardhjen nga Herkuli. Ylli sot është shqip, sepse nuk përdoret në ndonjë gjuhë tjetër në këtë formë, e i thuhet yllit dhe përdoret në emra djemsh. Po kështu edhe emri Teuta që përdoret edhe sot për vajzat. Yllasi ka qënë edhe perëndia e dritës e Frigolidasve. Këto ishin të dhëna që ata ishin me origjinë ilire.

Nga ana tjetër ka disa të dhëna të tjera që tregojnë se ata ishin me origjinë egjiptiane ose kananite. Në testamentin e vjetër, përmendet një fis i dorëve në Izraelin e sotëm, të cilët u shpërngulën që aty me forcë në kohën e Davidit, pra rreth shekullit X p.k.

Edhe Herodoti arrin t'i quajë dorët si pasardhës të Danaut që ishte egjiptian.(Herodoti, lib VII f.53-54 dhe lib. VIII, f.73). Këtu ka dy kontradikta, pasi nuk mund të qartësohet nëse ishte paria mbretërore me origjinë egjiptiane apo populli, pasi populli na del si ilirë.

M.Aref mbron idenë se popullsia dore ishte pellazgo-ilire, pasi dhe emri dorë përkthehet nga shqipja dorë, por ata që e sundonin atë ishin egjiptian, pra pushtuesit e saj ishin racë afrikane.

Disa studiues modern grekë, si *Kordati* dhe *Saqelariu* thonë se pellazgët nuk kanë asnjë lidhje me kombin grek, pasi grekët janë me origjinë nga Egjipti dhe nga Lindja e Mesme. Kordati thotë se dorët nuk është fare e vërtetuar se zbritën nga Ballkani.(Po aty, f.92)

Padyshim që ka një racë jo-evropiane me origjinë egjiptiano-kananite në Greqinë e asaj kohe. Ajo që nuk dimë me siguri është fakti nëse u përzhjenë apo jo me popullsinë pellazge apo thjesht ata ishin sundues, ndoshta dhe skllevër?! Kjo mbetet për t'u vërtetuar.

Megjithatë nuk duhet të ngatërrojnë formimin e kombit të sotëm grek, që është konglomerat popujsh dhe që sigurisht ka popullsi egjiptiano-semite, pasi nga të dhënat



antropologjike një përqindje e madhe e racës së sotme greke, ngjan me ata të Lindjes së Mesme dhe një pjesë që janë arvanitët apo shqiptarët, janë racë Evropiane.

Dorët ngritën shtetin e Spartës dhe përdorën formën oligarkike në qeverisje, ku qeveriste një mbret në bashkëpunim me një klasë aristokratike.

Aristidh Kola, jep disa fjalë spartane, pra dore dhe i krahason me gjuhën shqipe të arvanitasve.(A.Kola, Arvanitët..., f.)

Lakonike	shqip
Laros	lara
Balios	bala
Ekso-vathia	vath ku futen delet
Kalarines	kaloj
Irenes	i ri që ishin ushtarakët e rinj të Spartës
Vagaron	i vakët

### **Eolët, etolët, amfilohët, tebanët, eubeasit, beotët**

*Herodoti thotë gjithashtu se: Eolët janë pellazgë.*(Herodoti, Histories, Lib.II.171)

**Etolët**, Tukididi i përkufizon si një etnos, ku pjesa më e madhe duhet të ketë folur një gjuhë të panjohur.(Tukididi, I,5)

Polibi thotë se “...çfarë kuptoni ju me fjalën grek dhe cilët janë për ju kufijtë e saj? Vetë, etolianët, në pjesën më të madhe nuk janë grek. As krahinat e banuara nga apodët dhe amfilokët nuk janë greke.”(Polibi, 18, 1.5) Ka një krahinë ku përfshihet Lokriga, Etolia, Akarnania, Eritanët, Dolopëve dhe Amfilokëve nuk ishin quajtur me emrin helen dhe këto territore ndodheshin midis Maqedonisë, Epirit dhe botës së quajtur me emrin “grek” në antikitet.

**Tebanët**, kanë patur një etnicitet ilir. Kadmi, që themeloi Tebën ishte babai i ilirëve. Kadmi nuk erdhi nga Fenikia, por i ati i tij, kishte ikur nga territoret pellazgo-ilire për në Feniki, kështu që ishte nga etniciteti pellazgo-ilir. Burimet tregojnë se i grihë Mesdheu në prehistori ka qënë sunduar nga raca pellazgo-ilire dhe ata duhet të kenë ndërtuar koloni atje. Edhe të dhënat antropologjike, madje edhe sot, tregojnë se në bregdetin lindor të Mesdheut ka mbetje të një popullsie evropiane. Ai u kthye për shkak, se si thotë legjenda, motrën e tij Evropën e rrëmbyen dhe themeloi Tebën.

Kadmi është ai që solli alfabetin në Pellazgji nga Fenikia. Teba që ai themeloi, është quajtur edhe Enkelida, pra me emrin e një fisi ilir.

Stefan Bizantini në veprën “Kombëtarja në shekullin e VI”, thotë se: “**Miti i Kadmit dhe Harmoniasit ruhej në Iliri deri në atë kohë dhe saktësisht në qytetin Butoj, ku banorët e qytetit i tregonin dhe varrin ku ishte varrosur Kadmi dhe Harmonia.**”(Vep e cituar A.Kola, Arvanitasit 58).

Ky qytet duhet të ketë lidhje me fjalën Buaj dhe ndodhet në vendin e Kaonëve ku edhe vdiq Kadmi. Homeri e quan malin, në qytetin e Tebës si Plako Ypoplakia.(Iliada VI 397).

Disa e lidhin Tebën me Egjiptin se ata ishin Fenikas dhe egjiptian, por qyteti ka patur emrin tepi ose tep dhe më vonë e quajtën Tebë. Nga ana tjetër tregohet se faraonët pellazg ishin ata që themeluan Tebën, kështu që nuk mund të jetë emër egjiptian. *Në territorin pellazg nuk është përmendur kurrë ndonjë koloni fenikase, por përkundrazi në territoret fenikse ka patur koloni pellazge.*

Nga ana tjetër në gjenealogjinë antike, **Tebe është e bija e Pellazgut Adramis.**(P.Grimal 1951, f.447) Teba që sot quhet Thiva, flet aktualisht një shqipe të pastër, që Tebanët e kanë ruajtur nga gjuha pellazgjike. Teba sot, është një qytet që i gjithi flet shqip madje dhe fëmijët e vegjël.

**Euben, thonë se banojnë një popullsi ilire. Helopët ishin banorë të helopisë së Epirit.** (Po aty, f.69) **Homeri i quan eubeasit me origjinë nga Thrakia. Pas luftës së Trojës një pjesë e aubeasve, pra amantë, u zhvendosën për në Iliri, me kryeqendër Bylisin, ku dhe u quajtën si fis ilir.**

Tukididi i quan **Beotët** emigrant nga zona e Epirit të veriut>(Po aty, f.59).

**Termin Helen për të emëruar këto fise iliro-pellazge, e përdor Herodoti në shekullin e V p.k.**(Herodoti Histories, lib I f.57)

Tukididi e shpjegon qartë origjinën pellazge të termit Helen: **“Para luftës së Trojës Hellada mesa duket nuk ka bërë asgjë me forcat e përbashkëta. Mua më duket se ajo si tërësi nuk e mbante akoma këtë emër, se një emërtim i tillë as nuk ekzistonte para Helenit, birit të Deukalionit, dhe se emrin ia kanë dhënë asaj sipas emrave të tyre, fise të ndryshme, më tepër pellazgët”**(Thucididis, Historiae Lib I, f.3)

Pra, Helenët janë një popull që kanë patur origjinë pellazgo-ilire dhe që kanë folur një gjuhë pellazge që sot është shumë afër shqipes.

Kultura e quajtur greke antike është një nga fazat e zhvillimit të kulturës pellazge, ndoshta e gërshtuar me një element të huaj dhe në këtë rast semito-kananit. Por mund të jetë edhe një përzierje pellazge me pellazgë, që kishin qënë zotërues të territoreve të Egjiptit dhe Fenikis dhe kthehen pasi bie fuqia e tyre apo dhe humbasin pushtetin. Një gjë e tillë duket edhe tek Danau, që pretendon se ka të njëjtën racë me pellazgun. Por kjo popullsi, që mund të ishte me origjinë pellazge dhe kishte jetuar në kolonitë pellazge në këto territore, mund të ishte përzier me një element jo-pellazg, pasi vet mbreti i pellazgëve i quan ato gratë që kishte Danau, si femra të Nilit, pra jo si ato pellazge. Edhe numri i egjiptianëve nuk ka qënë i madh, pasi vetëm danajt janë nga Egjipti, të gjitha fiset e tjera ishin pellazgo-ilire, kështu që nuk kanë ndikuar në krijimin e etnisë antike greke.

Nuk ishte rastësi që në atë territor të quajtur Greqi, të krijohet një kulturë e përparuar, pasi po të hedhim sytë pas, do shohim se pellazgët ishin ata që ngritën në Kretë dhe Miken një qytetërim tepër të lart, madje për shumë aspekte dhe më të lart se ai antik.

### **Çështja e gjuhës greke antike**

Siç e pamë, pjesa më e madhe e fiseve apo popujve që kanë banuar në Greqinë antike, ishin pellazgë dhe ilirë.

Disa studiues mund të thonë se ka një komb grek antik dhe një gjuhë greke. Problemi sot, është se ne nuk dimë se çfarë gjuhe ka folur populli që quhej grek. Pse?

Ka një gjuhë që quhet greke e vjetër, por kjo gjuhë nuk përkthen dialektet që ka folur populli. Sot nuk dihet se çfarë gjuhe ka folur Athina, pasi dialekti jonik, nuk përkthehet nga greqishtja e vjetër dhe as nga ajo e re. Si ka mundësi që greqishtja e vjetër të mos përkthejë dialektet, gjoja greke?

Pra se çfarë gjuhe ka folur Athina, nuk e di askush dhe është aq mister sa dhe shkrimet e padëshiruara, por kjo fshihet nga historianët dhe nuk i vihet theksi fare. Madje bëhet analiza gjuhësore gramatikore, që do t'i quaja skandaloze, pasi nuk ka një gjuhë të përkthyer. Si mund të bësh analizë gramatikore kur nuk di fjalët e kësaj gjuhe? Deri këtu kanë arritur marrëzitë e shkencës së gjuhësisë dhe historisë. Madje marrëzitë arrijnë deri aty, sa ta quajnë gjuhën greke,

të krijuar në atë territor si 2000 vjet para-krishtit, kur ne shikojmë greqishtja artificiale e vjetër dhe e re nuk përkthen gjuhën e popullit të ashtuquajtur grek antik.

Përse greqishtja e vjetër nuk përkthen dialektet e saj?

Greqishtja e vjetër, nuk është gjuha e popullit, sepse do ta kishte përkthyer jonishten. Kjo tregon se populli i quajtur grek, ka folur një gjuhë që nuk është greke. Atëherë çfarë gjuhe ka folur populli grek antik? Le të shikojmë të dhënat.

Kur flet për origjinën e grekëve, Herodoti thotë se: **“Raca helenike nuk e ka ndryshuar gjuhën kurrë, që nga origjina e parë e saj. Ishte një krah i pellazgëve që u nda nga trupi kryesor dhe që në fillim ishte e pakët në numër dhe me pak fuqi, por që gradualisht u zgjerua dhe u rrit në disa kombe, nga hyrja vullnetare në shumë fise barbare. Unë mendoj, se pellazgët, nga ana tjetër, ishin një racë barbare, që kurrë nuk u shtua në numër.(Herodoti lib. I p.57). Duke u nisur nga një pakicë e ikur, helenët u shtuan derisa u bënë një popullsi e madhe, sidomos që nga koha kur shumë fise të tjera barbare u bashkuan me ta.(Po aty).**

Nga ana tjetër Herodoti thotë: **“...se çfarë gjuhe flisnin pellazgët është një çështje për të cilën nuk mund të themi asgjë. Vetëm nëse mund të mësojmë ndonjë mendim nga pellazgët e ditëve të tona, nga ata që janë sot në Kreston, sipas tyrsenve të cilët dikur fqinjë të dorëve të sotëm, banonin në tokën e quajtur tani Thesali. N.q.s. këtyre pellazgëve u shtohen ata që kanë themeluar Plakien dhe Skylaken në Helespont, që kanë banuar dikur me athinasit dhe banorë të qyteteve të tjera pellazge, emri i të cilave është ndryshuar, del se pellazgët kanë patur gjuhë barbare.**

**Në qoftë se, gjuha e pellazgëve, ishte e tillë, del se popullsia e Atikës, me prejardhje pellazge, harroi të folurën e saj duke u kthyer në helene, prej të cilëve mësoi gjuhë.**(Herodoti, Lib I, f.58).

**Pra siç dëshmon Herodoti, Athina është një popullsi pellazge që fliste një gjuhë që nuk e kishte ndryshuar asnjëherë.** pra që ishte gjuha e pellazgëve, por nuk arrin që ta shpjegojë, derisa ishte gjuhë pellazge ku ndryshonte nga pellazgjishtja e kohës së Herodotit.

Nga ana tjetër Herodoti shpreh pasiguri dhe nuk ka dijeni se nga ndryshon gjuha e pellazgëve të asaj kohe nga pellazgët helen.

Pra vërejmë dy kontradikta

1 – Helenët janë pellazgë që u shkëputën nga trangu pellazg dhe që flasin gjuhën pellazge pa e ndryshuar asnjëherë. Nga ana tjetër ai i quan pellazgët barbar edhe pse athinasit e kishin origjinën nga ata. Pra, athinasit pellazg, nuk ishin barbar, por pellazgët e tjerë ishin.

2 – Athinasit që nuk e kishin ndryshuar gjuhën asnjëherë harruan të folurën e tyre dhe mësuuan atë helene. Por helenët, thotë ai, janë vet pellazgët.

Pra helenët janë pellazgë që nuk kanë ndryshuar kurrë gjuhën e tyre pellazge, por ata harruan të folurën pellazgjike dhe mësuuan atë helene.

A nuk thotë Herodoti, që helenët ishin vet pellazgët dhe nuk e kanë ndryshuar asnjëherë gjuhën?! Nga ana tjetër, a nuk thotë ai, që ata harruan të folurën dhe u kthyen në helen?! A nuk ishin vet pellazgët helenë dhe kush i'a mësoi gjuhën helene, helenve?

Herodoti, duket tepër i paqartë, konfuz e i pasaktë në atë që shkruan. megjithatë ai thotë se n.q.s. e tillë ishte gjuha e pellazgëve, pra barbare (e ka kuptimin se nuk e kupton), pasi ai nuk e di se si ishte dhe e tregon se nuk ka të dhëna për këtë dhe nuk flet me siguri, atëherë pellazgët e

Athinës për të, duhet të kenë ndryshuar gjuhë. Pra nuk thotë se ai e di, hedh një hipotezë të cilës nuk i jep përgjigje.

Çështja është kush është kjo gjuhë helene, që rridhte nga populli pellazg, që e mësuan po këta pellazgë të Athinës dhe kush e pruri në Athinën që fliste pellazgjisht dhe shkruante në jonisht?

Kjo pyetje ka vetëm dy përgjigje logjike:

1 – *Platoni*, thotë tek “*Kratilo*”, në lidhje me gjuhën: “**Çdo gjë që ne sot nuk e kuptojmë dhe nuk e njohim në gjuhë, ka të ngjarë të jetë barbare, por ka të ngjarë të jetë e të duket e tillë për shkak të vjetërsisë.**” (Vepër e cituar A.Kola, Arvanitasit, f.39). Ai thotë se një gjuhë, që nuk e kuptojmë, mund të jetë barbare, por mund të duket e tillë dhe mund të mos jetë. Pra mund të flisnin të dy etnitë të njëjtën gjuhë, por që për shkaqe dialektikore mund të mos kuptoheshin plotësisht. Edhe sot një vesh i pastërvitur me të folurën gegërisht të disa zonave malore të thella të Shqipërisë, nuk e kupton qartë kur ata flasin, por në thelb ata flasin shqip dhe janë fjalë të një rrënje. Atëherë, kjo nuk do të thotë se në këto zona që flasin një shqipe e cila nuk kuptohet me lehtësi nga pjesa tjetër e shqiptarëve, nuk është shqip. Pra, në këtë pikë ose Herodoti është shtrembëruar nga ata që e kanë shkruar, ose ai nuk ka pasur njohuri të mira në fushën e gjuhëve, pasi e pranon që nuk mund të thotë asgjë për gjuhën e pellazgëve, se nuk ka njohuri për të.

2 – Ka një greqishte të vjetër, e cila është quajtur gjuha e përbashkët e grekëve me emrin Koine në shekullin e IV dhe ishin dy studiues nga Siçilia, që e sollën në Athinë. Ç’është kjo gjuhë që u soll nga dy persona? *Kush ishte kjo gjuhë greke?*

Kjo gjuhë antike greke, ishte një gjuhë artificiale e krijuar nga dijetarët për ta patur si gjuhë të arsimit.

Kjo gjuhë e stisur, u bë edhe gjuha e administratës dhe e njerëzve të kulturuar që më pas u mësua nga populli që banonte në polis, pasi populli i fshatit nuk mund ta ketë mësuar dot. Fakti, që është kështu, na e tregon edhe Isokrati, i cili ka thënë se “**Grekët janë pjesëmarrësit e shkollimit grek. Shkollim, do të thoshte mbi të gjitha, të mësoje gjuhën greke.** Pse duhet ta mësonin këta grek, greqishten? A nuk e kishin gjuhën e nënës?

Pra të dhënat tregojnë qartë se në Greqinë antike është folur një gjuhë pellazge dhe ato që quhen dialekte greke si jonishtja, eolishtja dhe dorishtja nuk janë dialekte të greqishtes, përderisa greqishtja e vjetër nuk i përkthen ato, por janë pellazgjisht. Meqë ky popull ishte me origjinë pellazgo-ilire, ka folur një gjuhë pellazgo-ilire.

Le të përkthejë ndonjë studiues gjuhën e tre dialekteve të Greqisë antike. Pse nuk e ka bërë kush deri më sot? Janë përpjekur dhe asnjë rezultat nuk kanë dhënë. Deri sa nuk e kanë bërë të pushojnë së gënjeri për etnicitetin real të grekëve të vjetër dhe të rishkruajnë historinë ashtu siç është realisht.

Të marrin njëherë shqipen e sotme dhe ta provojnë, se nuk i dihet se çfarë surprize mund të marrin. Nëse nuk e bëjnë një gjë të tillë dhe do vazhdojnë ta trajtojnë dialektet antike pellazge jashtë gjuhës pellazge dhe shqipe, asnjëherë nuk kanë për të marrë vesh ndonjë gjë.

Autorët, ashtu si dhe Herodoti, kanë shkruar në jonisht, që ishte dhe gjuha e Athinës të cilat u përkthyen më pas në gjuhën greke artificiale, se nëse nuk do ishin përkthyer në këtë kohë nga jonishtja, asgjë nuk do dihej sot për qytetërimin dhe mendimin antik, pasi pothuajse të gjithë të diturit e asaj kohe shkruanin në jonisht dhe jo në greqishten që njihet si ajo antike. Madje, pjesa më e madhe e të diturve të antikitetit, ka shkruar në jonisht edhe pse doli kjo greqishte artificiale.

F.R.Adrados thotë se: “Jonishtja që Herodoti përhap në të gjithë botën Greke nuk ishte gjuhë greke dhe as dialekti i greqishtes ashtu siç trillohet, por ishte një gjuhë e panjohur edhe jo greke që do të thotë se gjatë viteve 500-400 p.k. nuk flitej greqisht në Athinë”.(F.R.Andrados, Hisstoria de la lingua Griega, Madrid 1999, f.196)

Nga shekulli VI deri në shekullin XI-XII, për Greqinë, ashtu si dhe për të gjithë Ballkanin, nuk dihet asnjë gjë. Faktet tregojnë se në shekullin e XII kur ai territor del nga kronikat historike nuk flet greqisht, por deri në shekullin e XIX flitet vetëm shqip. Kjo tregon qartë se ata në antikitet kanë folur shqip dhe kanë qënë të gjithë pellazgë.

Nëse në Greqinë antike, populli, do fliste greqisht, atëherë pse populli i mesjetës dhe kohëve moderne fliste vetëm shqip? Kjo tregon qartë se nuk ka grek, por vetëm pellazg që në antikitet janë quajtur me emrin Helen, ashtu siç quheshin dhe fiset e tjera të pellazgëve me emra të ndryshëm.

Më kot evropianët e shekullit të XIX preokupoheshin se ku kishin shkuar grekët dhe ngritën teorira se ata janë asimiluar nga sllavët apo dhe kanë ikur.

Popullsia e vjetër e Greqisë, ka qënë pellazge dhe nëse ka pasur një racë egjiptiane, ajo nuk u përzi, në pjesën më të madhe të saj, me të ardhurit. Fakt sot, është vet Shqipëria, që ka një minoritet egjiptian, i cili i ruan tiparet e tij, sikur të ishte në Egjipt, pasi popullsia vendase shqiptare është tepër konservatore dhe ka qënë kundër martesave me racat e huaja. Kjo ndodhi dhe në Greqinë antike, ku pjesa më e madhe e pellazgëve ruajti gjuhën dhe racën e saj të pastër. Gjuhë që një pjesë e atyre pellazgëve e flasin edhe sot në Greqi.

Pra nuk ka ekzistuar kurrë etni greke e ndarë nga pellazgët dhe nëse thua grek antik duhet të thuash pellazg, pasi grekët antik ishin pellazgë që nuk kanë patur ndryshim në gjuhë nga të tjerët. Ata kanë patur një kulturë më të lartë se fiset e tjera pellazge, pasi aty ishte djepi i qytetërimit Evropian që në kohën e bronzit dhe ndoshta për këtë dallonin veten nga të tjerët. Tek fiset e një kombi nuk ka patur një zhvillim të njëjtë nga ana kulturore, pasi kjo varet nga pozita gjeografike, kushtet klimaterike etj. Nuk mund të ishin në një nivel vendet bregdetare me vendet që ishin më në thellësi në kontinent dhe të izoluar nga bota tjetër.

Me një fjalë jonët, dorët, eolët kanë folur pellazgjisht apo një dialekt të evoluar të pellazgjishtes dhe ajo që quhet greqishtja e vjetër, derisa nuk i përkthen këto dialekte tregon se nuk është gjuha e tyre reale.

*Lind pyetja po kjo greqishtja e sotme nga doli?*

Greqishtja e sotme nuk është gjuha e popullit, por e kishës, e cila u fut si gjuhë e shtetit të ri grek, pasi populli në pjesën më të madhe fliste shqip. Kisha e ruajti si gjuhë fetare greqishten e vjetër dhe e ripërpunoi. Kjo greqishte artificiale, u përdor edhe si gjuhë zyrtare në Bizant. Nëse nuk do kishte ekzistuar shteti i Bizantit, që e vendosi si gjuhë për administratën dhe kishën, sot ajo gjuhë do të ishte shuar, pasi ishte një gjuhë artificiale që nuk e fliste populli. Nga gjuha e shtetit dhe e kishës greke u bë gjuha e shkollës dhe iu imponua shqiptarëve, vllahëve, sllavëve, pra etnive të ndryshme që bënë shtetin grek modern.

Roli i masmedias dhe vendosja si gjuhë shkollë të detyrueshme, e bënë atë gjuhë të kombeve që janë brenda shtetit grek. Kështu një gjuhë artificiale u bë gjuha e shqiptarëve, vllahëve, turqve, sllavëve dhe etnive të tjera që jetojnë atje, një pjesë e të cilëve nëpër fshatra flasin secili gjuhën e tij në shtëpi.

Le të shikojmë disa fjalë që janë përdorur në gjuhën e popullit pellazg të asaj kohe.

Kështu, Straboni na tregon një fjalë të gjuhës që përdornin athinasit e asaj kohe, pra jonishtes, që sot greqishtja artificiale meqë e ka ruajtur Straboni kur bëri pastrimin e gjuhës, e futi në fondin e saj, por që sigurisht nuk ia jep dot kuptimin.

Ai thotë se: “... **ka pasur pellazgë që kanë banuar në Athinë dhe për shkak se këta popuj duke u endur në të gjithë anët shkonin në grupe në disa vende të ndryshme si disa zogj, ku banorët vendas të Atikës i quajtën me emrin pelarg**”(Ilirët dhe Iliria f.152).

Me emrin **pelarg** banorët e Athinës tregonin fisin e **lelegëve**. Leleg, do të thotë nga shqipja po leleg të cilët shtegtojnë **pe-largu**. Një nga sinonimet e fjalës leleg është fakti se ata emigrojnë pe larg, që është edhe kuptimi i fjalës. Por fjalët leleg dhe pe-larg janë shqip edhe përdoren edhe sot dhe kanë po këtë kuptim, ndërsa greqishtja artificiale nuk u jep dot kuptimin që ato kanë realisht. Pra kjo fjalë jone e folur në Athinë dëshmon qartë se athinasit kanë folur një gjuhë që ka qënë pellazge dhe që sot shqipja e përkthen kuptimin e kësaj fjale. Sikur Straboni dhe të tjerë të kishin ruajtur edhe disa fjalë të tjera, do t'i kishin bërë një shërbim të madh kulturës botërore. *Ndërsa Apollodori thotë se Homeri e quan Zeusin, pellazg, sepse ai nuk është shumë larg nga asnjë nga ne.*

Straboni kur flet për malin e shenjtë të Tomorit, ku ndodhej edhe orakulli i Dodonës thotë se: “... është mirë të shkruajmë tomurë, se sa themistë, se poeti (Homeri) në asnjë vend nuk i quan themistët orakuj, por vetëm mendimet, regjimet dhe ligjet.”(Straboni, VII, f.11).

Pra fjala **themiste**, që tregon ligjet dhe mendimet, është një fjalë që kuptimin e saj mund ta shpjegojë vetëm shqipja dhe pikërisht fjala **them** e shqipes që është edhe sinonim apo shprehja e mendimeve apo ligjeve. Dhe fjala theo që quhet zoti duhet ta ketë origjinën nga fjala them që tregon edhe fjalën që thotë Zoti.

Po aty thuhet se ata që profetizojnë quhen **hypofet**(Straboni, lib VII, f.12.). Edhe fjala **hy-po-fet** shpjegohet vetëm nga shqipja për të treguar kuptimin e saj, si **hy-që quhet edhe hyu apo zoti** dhe **po-pro, fe-fe** pra që tregon personin që tregon se është **pro besimit ndaj hyut** apo ndaj zotit dhe këto fjalë i ruan shqipja.

**Krato**, që tregon shtetin, është një fjalë me origjinë shqipe, pasi fjala kratao, që do të thotë mbaj, e ka kuptimin në shqip dhe jo në greqisht. Pasi të vetmit organe të njeriut që mbajnë diçka janë **krahët** dhe fjala krat ndodhet aktualisht në shqip dhe jo në greqisht.

Fjala **etnos** që tregon kombin, fjalë shqipe, është shumësi i fjalës **at** dhe që në të dyja format sot e ka vetëm shqipja. Fjala etni rrjedh nga fjala etrit që tregon edhe një kombësi të caktuar.

**Anije** quhet ishulli, por anije e ruan shqipja, që tregon diçka që është mbi ujë, pra anijen, por grekët me gjuhën artificiale të sotmen përdorin fjalë tjetër për të dhe jo fjalën anije.

**Hipia** është quajtur kali dhe kjo në shqip tregohet nga fjala **hip**, që tregon kalërimin, pra që nënkupton atë funksion që ka patur kali në antikitet, për t'i hipur. Dhe fjala hipizëm është shqip, pasi tregon kalërimin, duke u mbështetur tek fjala hipi.

Efori, tregon se zona malore e Thesalisë është quajtur **omolos**(Efori historia I f.256) në shqip dhe sot tregon malin apo **mol** në gegërisht.

Saturni, që paraqitet me një instrument prerës, nga autorët e vjetër, quhet **drepanon** pra **drapër** sot në shqip.

**Pelagos** quhej ndryshe edhe **oqeani**(Aristotel De mundo f.3) që rrjedh nga fjala shqip **pelg apo pellg**, tregon, si në shqipen e sotme, një pellg me ujë.

Fjala **punos për punën** që e përdor aktualisht shqipja, po për punën në të gjitha format.

**Gra** quhen në një skulpturë të antikitetit disa femra, të cilat paraqiteshin në atë skulpturë. Por gra, grave sot u thuhet vetëm në shqip dhe jo në greqisht.

**Skeptri** që mbante Zeusi në dorë, e ka origjinën nga shqipja gjithashtu. Skeptri i Zeusit paraqiste një kokë shqiponje, pra skeptri është sqepi apo skepi si i thuhet në gegrisht. Pra skepi është sqepi i shqiponjës. Këtë fjalë e ruan shqipja, si ka qënë, pa ndryshuar fare.

**Uranos**, që quhej qielli, ashtu siç e quajnë edhe sot nga fjala shqipe “vranur” që tregon retë e qiellit. Pra nga vrana apo vranësira që përdor shqipja është emërtuar qielli nga greqishtja.

U ndala në disa fjalë tipike dhe tepër të rëndësishme të cilat janë shqip. Kjo tregon qartë se në Greqinë e asaj kohe, është folur një shqipe e pastër, që nuk ndryshon shumë nga ajo që flasin shqiptarët sot.

## **Lidhjet etnike iliro-romake**

Illirët, kohë para se Roma të forcohej dhe gjatë kohës që ajo ishte perandori, kanë banuar edhe në gadishullin Italik. Ata kanë zënë pjesën më të madhe të tij, përveç zonës së Toskanës së sotme që ishte një popullsi e përbashkët nga ana etnike me ilirët, por që quhej si etruske dhe afër saj kanë banuar edhe një popullsi që quhej pellazge që është shtrirë deri në Francën jug-lindore me fisin e aborigëve.

## **Etruskët**

Etruskët edhe sot nga disa historianë, konsiderohen si një popull i mistershëm, i cili nuk dihet se nga e ka origjinën. Ky popull ka patur një kulturë tepër të lashtë, por që sot nuk i vihet emri se cilit popull i përket. Studiuesit që nuk njohin asnjë kulturë tjetër veç asaj greko-romake, kanë provuar që të përkthejnë gjuhën e etruskëve me latinishten, greqishten apo me gjuhë të tjera aziatiko-afrikane dhe nuk kanë mundur t’i përkthejnë shkrimet e tyre. Ata i kanë vënë një kapak sipër, ashtu siç i është vënë të gjithë qytetërimit etnik të vjetër evropian dhe mbi të kanë vënë emrin mister.

Në fakt ata studiues që në pjesën e madhe të tyre, janë evropianë, në një farë mënyre, i kanë vënë kapak kulturës së tyre më të lashtë.

Kështu, lidhur me origjinën e etruskëve ka pasur disa ide kontradiktore.

1. *Një grup historianësh mbështet idenë se etruskët janë me origjinë nga Azia e Vogël, pra nga fiset Trojane.* Ata mbështeten tek Herodoti, i cili tek libri “Historia” thotë se: “Lidët dhe pellazgët e Lemnosit emigruan për në Itali”. **Edhe Straboni thotë se pellazgët ishin të parët që banuan ishujt Lemno dhe Imbro dhe disa prej tyre kaluan për në Italik me Tyrrenin të birin e Atit**”. (Gjeografia, Straboni lib. V f.4) Pasi erdhën në Itali, ata e ndryshuan emrin e tyre nga Lidë në Tirren pasi kështu quhej njëri nga prijësit, që i priu për në Itali.

Nga ana tjetër Tyrrenët quhen edhe si pellazg. Helleniku i Lesbosit që ka shkruar në shekullin e V p.k. përmend gjithashtu një grup pellazgësh që mbërritën në Itali dhe që atje e kthyen emrin e tyre në Tyrren.

Burimet e tjera i lidhin etruskët ngushtë me pellazgët e ishujve të Lemnosit. **Tukididi thotë se etruskët ishin një degë e pellazgëve**”(Z.Manjani, Fundi i misterit Etrusk, Tiranë 1973, f.25)

Edhe Plini thotë se: “**Umbret kanë qënë përzënë këtej prej pellazgëve, këta prej lidëve të quajtur tyrren nga emri i mbretit të tyre të cilët më vonë në gjuhën greke u thirrën tusk, sipas riteve të tyre të flijimit**”.(Plini Secundi, Naturalis Historie, Lib. II.f.8)

Herodoti në lidhje me tyrenët, pra etruskët thotë se: “... ata janë thesaliot të vendosur në Lidi prej nga ku shkuan në Itali”(Herodoti I. 57, VI, 137-139)

Pra, të dhënat që japin disa autor antik, tregojnë se etruskët ishin me origjinë nga Lidia e Azisë së Vogël, pra trojan. Herodoti e pranon se janë nga Lidia, por ai thotë se janë me origjinë nga Thesalia që historikisht ka qënë banuar nga raca pellazge. **Tarkuinia ishte një qytet i themeluar nga Tarkuini, i vëllai i Tyrrenit dhe bir i Telefit. Por ky i fundit është pasardhës i Lykaonit të birit të Pellazgut**(Pauzania, VII, 4,1) Atëherë edhe Etruskët që ishin nga Lidia apo nga Thesalia nuk ishin gjë tjetër veçse pellazg.

Straboni (lib.V) vë në dukje gjithashtu se “**nuk është për t’u habitur nëse gjen në Italinë e lashtë legjenda që përkojnë njëherazi me pellazgët dhe Trojanët, sepse këta tre popuj (edhe etruskët) rridhnin nga i njëjti trung**”

Briquel, vë në dukje se shkrimet e Helanikut, Hekateut, Thukidit dhe Sofokliut i konsiderojnë pellazgët si etrusk. Tradita e origjinës pellazge të etruskëve ishte e gjallë tek ata deri në shekullin e IV p.k.(D.Briquel, 1984, f.628)

2 – Në shekullin e parë p.k. Dionisi i Halikarnasit i quan etruskët si autokton pra si popull që nuk ka emigrua nga zona pellazge e Egjeut Lindor.

3 – Një teori tjetër thotë se ata kanë zbritur nga retët, pra nga një fis tjetër ilir në veri të Italisë së sotme.

*Të gjitha këto teori të çojnë në të njëjtin drejtim, tek origjina pellazgo-ilire e etruskëve. Pse?*

*Nëse etruskët janë nga ishujt e Lemnosit nga Troja dhe kanë emigruar, ata janë pellazgë ashtu siç është thënë nga autorët antik. Nëse etruskët, janë nga Retia, atëherë sërish janë ilirë, pasi retët ishin një fis ilir sipas Apianit. Nëse janë autokton, atëherë sërish janë ose ilirë ose pellazgë, pasi gadishullin Italik edhe gjatë kohës që Roma dardane ishte superfuqi, banohej nga ilirë.*

### ***Tosko epirotët me tosko etruskët.***

*Toskët e Epirit në antikitet, janë quajtur pellazgë, po kështu shpesh janë quajtur edhe etruskët, që tregon se ka lidhje etnike midis toskëve shqiptarë dhe toskëve etruskë. Gjuha e toskëve në Shqipëri, është gjuha zyrtare si gjuha e toskanës në Itali. Fakti që sot shqiptarët i kuptojnë shumë lehtë gjuhët latine si ajo italiane, spanjolle apo portugeze tregon lidhjet e qarta etnike midis pasardhësve të këtyre kombeve, me paraardhësit e shqiptarëve.*

Latinishtja e vjetër dhe e re, ka një ngjashmëri të madhe gjuhësore me shqipen. Në të ndodhen fjalë që shqipja nuk i ka huazuar ashtu siç mund të thuhet, pasi ato, shpjegimin e kanë vetëm me anën e gjuhës shqipe.

Në një kohë kur spanjolli shkon në Itali dhe flet spanjisht, italianët nuk e kuptojnë, ashtu dhe anasjelltas, nëse të dy vijnë në Shqipëri, pjesa më e madhe e popullsisë i kupton menjëherë se çfarë duan të thonë. Pra latinët nuk kuptojnë njëri-tjetrin, ndërsa shqiptarët që flasin shqip i kuptojnë shumë mirë ata. Çfarë tregon kjo?

Kjo tregon, se këto gjuhë kanë patur për bazë një gjuhë që ka qënë folur në Evropë para krijimit të kombeve, por që atë gjuhë për shkak të natyrës kokëforte dhe maleve, e ruajtën vetëm shqiptarët. Ajo gjuhë është baza e gjuhëve latine, por edhe e gjuhëve të tjera evropiane.

Kur bëhet historia dhe kur dëshiron që të tregosh se kujt i ka përkatur ky apo ai shkrim, së pari shikohet se cili popull ka banuar aty. Shikohet se cila gjuhë apo cili popull është sot më afër nga ana etnike me këtë popull dhe merret gjuha e tij për ta provuar. Padyshim, kjo, shumë pak studiuesve iu ka shkuar nëpër mendje dhe atyre që njohin shqipen. Kështu disa autorë francez, që kanë patur njohuri për shqipen, kanë shpjeguar një numër të madh shkrimesh nga etruskishtja me



anën e shqipes. E thënë më qartë, të vetmet fjalë që njohim nga etruskishtja, janë përkthyer vetëm me anën e gjuhës shqipe. Pra, nga pikpamja etnike, etruskët janë pellazgë ose ilirë. *Edhe tek etruskët, varrimet kanë qënë në disa periudha me tuma si në të gjithë Evropën, gjithashtu mbizotëron sëpatën dytehëshe tipike ilire.*

Disa fjalë etruske që janë shqip, të nxjerra nga Z.Manjani (Z.Manjani, Fundi i misterit Etrusk f.419)

Etruskisht	Shqip
<b>kortona</b>	<b>gurtona</b> nga fjala gur
<b>thura</b>	<b>thura</b> që quhej fortesa si në Lidisht dhe në Etruskisht
<b>Ape rucen</b>	<b>hape ruken apo rrugën</b> dhe në Spanjë ka ekzistuar një term i tillë arrugia për galeritë e minierave, pra që hap rrugën për në galeri
<b>ap</b>	<b>ap hap</b>
<b>athna</b>	<b>at</b>
<b>ast</b>	<b>asht</b>
<b>at, ati</b>	<b>at ati</b>
<b>atranes</b>	<b>atrit, etrit</b>
<b>kan</b>	<b>qan</b>
<b>kur</b>	<b>gur</b>
<b>kuie</b>	<b>kuje</b>
<b>etna</b>	<b>etrit</b>
<b>ersi</b>	<b>eret</b> pra ngryset apo bëhet natë
<b>ve</b>	<b>ve vendos</b>
<b>vras</b>	<b>vras</b>
<b>vanth</b>	<b>vand</b>
<b>vaze</b>	<b>vajz</b>
<b>zar</b>	<b>ziarr</b>
<b>Zi</b>	<b>zi</b>
<b>ha</b>	<b>ha</b>
<b>hulu</b>	<b>hulli</b>
<b>dalius</b>	<b>dal</b>
<b>dhusk</b>	<b>dushk</b>
<b>theruse</b>	<b>ther</b>
<b>ikni</b>	<b>ikni</b>
<b>ika</b>	<b>ika</b>
<b>kru</b>	<b>e kry</b> pra e bërë
<b>lart</b>	<b>lart</b>
<b>lur</b>	<b>lyr</b>
<b>lus, lut</b>	<b>lut</b>
<b>lar</b>	<b>lar</b>
<b>malava</b>	<b>mali</b>
<b>maie</b>	<b>maje</b>
<b>mir</b>	<b>mir</b>
<b>neri</b>	<b>njeri</b>

<b>nuk</b>	<b>nuk</b>
<b>nuna</b>	<b>nena</b>
<b>pi</b>	<b>pi</b>
<b>pleni</b>	<b>bleni</b>
<b>preve</b>	<b>preva</b>
<b>se</b>	<b>she</b>
<b>ri</b>	<b>re i ri</b>
<b>rit</b>	<b>rit</b>
<b>ru</b>	<b>ruaj</b> pra kujdesem
<b>repin</b>	<b>rrepin</b>
<b>ranem</b>	<b>i ranëm</b> pra ka rënë
<b>sa</b>	<b>sa</b>
<b>siune</b>	<b>syne</b>
<b>stre</b>	<b>shtrij</b>
<b>sil</b>	<b>sill</b> pra sjell
<b>tur</b>	<b>Thur</b>
<b>treci</b>	<b>tregu</b>
<b>tesi</b>	<b>deshi</b>
<b>uthi</b>	<b>udhi udha</b>
<b>fler</b>	<b>fler fle flijoj</b>
<b>calus</b>	<b>kale</b>

Dionisi i Halikarnasit thotë se: “... **disa nga pellazgët, banonin në të quajturën tani Thesali, të detyruar të lënë vendin e tyre, u vendosën pranë Oborigëve dhe së bashku me këta luftonin kundër Sicilotëve. Aborigët i pranuan ata me shpresën se do të përfitonin nga këta, por sipas mendimit tim i pranuan se ishin të afërt.**”(Dionis Halikarnasi, Antiquitatum Romanarum, lib I f.17) Madje një pjesë e tyre janë vendosur deri në Francën juglindore.

**Venetët** janë quajtur si venet. Homeri përmend enetët të cilët kanë marrë pjesë në luftën e Trojës përkrah trojanëve. Enetët apo venetët nga burimet antike dalin si ilirë dhe ndonjëherë si koloni e trojanëve. Autorët si P.Althajm, J.Pokornidhe H.Krahe i konsiderojnë venetët si një degë të trungut ilir.(Z.Manjani, f.28).

Venetët gjenden edhe në detin Baltik, në gjirin e Dancigut. Ky emër u trashëgua nga sllavët që u vendosën në këto toka. Ato gjenden pranë tribalëve thrako-ilir, ku në Paflagoni kemi henetët që janë thjesht ilir(Z.Manjani, f.28) Venetët e quanin veten e tyre **vend** që lidhet me fjalën **vend** të shqipës.

**Mesapët** ishin një fis ilir, që banonin në pjesën jugore të Italisë së sotme. Me emrin Mesap ka disa emra. Në Kretë, nga mendon Herodoti se ata kanë ardhur, ka një lumë me emrin Mesap, në Peloponez edhe sot në Shqipëri ka një vend të quajtur Mesaplik.

*Dauni, Mesapi e Peuketi janë bijtë ilir Lykaon, birit të Pellazgut. Dauni me vëllezrit e tij në krye të një ushtrie ilire u hodh në Italinë e Jugut, përzuri auzonët dhe në vendin e tyre formoi tre mbretëri të daunëve, mesapëve dhe të peuketëve.*(Ovidi, Fastes, IV.76).

*Sipas një varianti tjetër ata janë ilir, por kanë emigruar nga fiset pellazgo-ilire që banonin në Kretë. Plini e konsideron Japiksin si kretas dhe bir të Dedalit e të një gruaje nga*

Kreta. Straboni e bën Japyksin heroin eponim të fisit të ilirëve të japygëve, vëlla të Daunit dhe të Peuketit.(Straboni, lib. VI, 3,2)

Ira ose Oria ishte qyteti më i vjetër i Mesapëve dhe ka një zhvillim e kulturë të lartë, që është e një niveli me atë etrusk apo trojan, me qytete dhe ndërtime madhështore. Kjo tregon qartë se ilirët kanë qënë një popullsi me kulturë të lartë. Qyteti i Veretos, është quajtur edhe me emrin **Hyria** që përdoret edhe sot në shqip, në emra vajzash. Në Mesapi gratë kishin të drejta të barabarta me burrat, pothuajse edhe më tepër se sa burrat.

### Fjalë mesape janë

<b>bilia</b>	<b>bija</b>
<b>ara</b>	<b>ara</b>
<b>rhinos</b>	<b>re</b>
<b>anda</b>	<b>ndë a-ndë</b> që asht ndër
<b>brendon</b>	<b>dre nga bri</b>
<b>dalamia</b>	<b>delm</b>
<b>ikka</b>	<b>ika</b>
<b>menzana</b>	<b>mëza</b>

**Japigët**, një fis i rëndësishëm ilir, kanë patur kultin e quajtur **Jupiter Mezana**. Ata i flijonin mëzat për nder të Jupiterit dhe sot në këtë formë fjalën “**mëz**” e ruan shqipja.

**Kaoni**, që vijnë gjithashtu nga iliria, po në të njëjtën kohë, kaonët janë edhe në Trojë. Ajo që është interesante është fakti se kaonët e Epirit me të Italisë mbanin marrëdhënie të mira, pasi e dinin që ishin nga një fis i përbashkët.

**Kalabrit**, që studiuesit i quajnë me origjinë nga dardanët e Ilirisë apo Shqipërisë së sotme.

**Umbret, Plini i quan si një fis të vjetër Pellazg**(Plini lib.III. f.19.1)

**Ligurët**, Hesiodi i përmend se banonin afër *Skithëve Hypomologian*. Aristoteli flet për **ligur në Thrakë dhe një pjesë e tyre jetojnë në Kapadoki të Azisë së Vogël**(Herodoti Lib.VII f.72) Pra, ligurët e Italisë, kanë banuar në Skithi apo edhe në Thrakë e Azi të Vogël para se të dalin në Itali. Kjo do të thotë se ligurët janë një popullsi, që ose ka emigruar nga zonat e Skithis, Azisë së Vogël, Thrakës në kohë të hershme prehistorike dhe janë vendosur në Itali, ose ata të Italikut janë emigruar në Lindje. Dy qytete të rëndësishme të ligurve kanë qënë Alba dhe Albia.

Oenotria ku banonin jukanët dhe bretianë shtrihej nga Posedonia deri në Taranto. **Oentori është i biri i Lykaonit të birit të Pellazgut.**

**Pisa** më parë është quajtur me emrin **Teuta**, të cilët ishin me origjinë nga Elida, që e ka marrë këtë emër nga Pintinët fis ilir (M.Sakellario, 1977, f.86)

**Retët**, sipas Apianit, që është i vetmi autor që ka shkruajtur një vepër të plotë për ilirët, janë ilirë. “**Romakët, jo vetëm ilirët po edhe paionët që janë afër tyre edhe retët, edhe norikët i quajnë ilirë**”(Apiani, Ilirike, f.6)

### Fjalë rete

**retia** nga fjala **re** e shqipes dhe ky fis banonte një pjesë në Alpe

**barga** kasolle me **bar** nga fjala bar

**ber** në lombardisht i thoshin deles që në shqip është edhe fjala **ber**

**criu ngriu** pra ftohtë

**lopë** fjalë nga savoja dhe zvicra që lidhet me fjalën **lopë** të shqipes

**palta** në Lombardi është **balta** në shqip

**Dardanët e Romës.** Burimet historike tregojnë se Ene Dardanidi princi trojan pas luftës vendoset në Itali dhe pasardhësit e tij, themeluan Romën dhe e bënë atë një perandori. Pra në antikitet Roma është banuar nga dardanët e Trojës si dhe nga fise të tjera pellazgo-ilire. Dardanët e Trojës janë dardanët e Ilirisë, sepse për këtë dëshmon Straboni dhe autorët romak.

Pra, me fjalë Japigët jetojnë në Kroaci dhe në Italinë jugore, Galabroit në afërsi të Dardanisë dhe në Kalabri, dardanët e Mesisë së Epërme bëhen dardanët e Italisë, kaonianët e Epirit vendosen pjesërisht në Lukani, liburnët e pjesës veriore të Adriatikut i gjejmë në Itali, piçensave të Paionis iu përgjigjen picenumi. (Z.Manjani, f.42).

Edhe emrat deti Adriatik dhe Jon i kanë marrë nga fiset ilire të adrianëve dhe emri i një princi ilir, Jon.

Sipas një varianti *Joni është biri i Dyrrahut. Ai është vrarë aksidentalisht nga Herkuli. Kufoma e tij është hedhur në detin Jon që mban emrin e tij.* (Appien, Bell, Civ. II, 39) *Joni, emri i detit Jon, është biri i një mbreti ilir, Adrit, emrin e të cilit mban deti Adriatik* (Scholie a Apollonios de Rhodo, Argonautiques, IV, 308).

Pra në antikitet, por edhe gjatë periudhës kur Roma u shndërrua, nga një qytet dardan në një perandori të dytë me rrënjë dardane, elementi ilir, ishte mbizotërues ose e thënë më qartë romakët apo vet italikët ishin ilir. Ajo, që në histori njihet si kultura romake, nuk është gjë tjetër veçse kultura e krijuar nga toskët, dardanët dhe fiset e tjera ilire. **Gërmat e alfabetit, i sollën në Lat pellazgët.** (Plini, Lib. VII, f.57) Pra ata janë të parët kudo që zbuluan qytetërimin, shkrimin.

Në kohën antike Italiku ka folur të njëjtën gjuhë me Iberikun dhe Galinë. Në atë kohë ata merreshin vesh me njëri tjetrin. Meqë Italikët siç dhe do shohim edhe latinët e tjerë flisnin një gjuhë pellazgo-ilire, ajo ka shumë nga gjuha shqipe brenda saj.

Madje italishtja e sotme e toskanës dhe toskërishtja e shqipes kanë shumë ngjashmëri me njëra-tjetrën.

Meje, thotë se gjuha latine ishte krijimi i një kaste të pasur shfrytëzuesish bujqësor, të cilët pushtuan Romën pasi kishin dëbuar prej aty etruskit. Romakët për t'u dalluar nga paraardhësit e tyre, duhet të kenë krijuar këtë dialekt, i cili më pas u bë gjuha zyrtare e Romës, pastaj rajonale dhe më pas kombëtare me atë prestigj që pati në të gjithë Evropën.

**Dionisi Halikarnasit thotë se romakët flisnin një gjuhë, e cila nuk është as krejtësisht barbare as plotësisht greke, por një përzierje e këtyre të dyjave, u mbizotruese është gjuha eoliane,** por ajo ishte pellazgjisht. *Këtu vërtetohet edhe njëherë se fiset helene kanë folur të njëjtën gjuhë si fiset e tjera ilire pasi ato edhe mund të kuptoheshin.*

Megjithëse latinishtja mund të ketë qënë një gjuhë e krijuar, ajo ka pasur si bazë shqipen, pasi fjalët e saj nuk kanë kuptim pa shqipen. Këtë do e shikojmë tek kapitulli ku do flasim për gjuhën Italiane.

Kultura etrusko-romake, është një kulturë pellazgo-ilire, pasi etruskët ishin pellazg dhe fiset e tjera Italike ishin me origjinë ilire dhe sigurisht ishin ato që krijuan këtë qytetërim dhe kulturë të lartë.

Po të shikosh qytetet e vjetra në Italik, para-romake të ndërtuara nga Ilirët, nuk bëjnë dallim nga ndërtimet madhështore dhe qytetet e mëdha, nga bota tjetër e zhvilluar pellazgo-ilire.

Roma dardane arriti që të bëhej një perandori e fuqishme, e cila mbajti të pushtuar pjesën më të madhe të botës së atëhershme për pesë shekuj dhe ishte e vetmja superfuqi mbi tokë.

Roma, për të drejtën, arriti majat dhe sot pothuajse pjesa më e madhe e sistemeve juridike të vendeve më të zhvilluara, janë mbështetur tek e drejta romake, sidomos Evropa me sistemin romano-gjermanik të së drejtës.

Pra origjina e etnisë, gjuhës dhe kulturës romake antike është pellazgo-ilire.

### **Lidhjet etnike iliro-thrake**

Thrakët ishin një etni e shtrirë në lindje të ilirëve deri në Detin e Zi dhe në jug kufi kishin detin Egje ndërsa në veri dakët. Ata kanë jetuar që prej kohësh shumë të lashta në gadishullin Ilirik. Lidhur me etnicitetin e tyre janë të shumta faktet historike që tregojnë se ata ishin të një etnie me ilirët. Për ta vërtetuar këtë ka një mori faktesh historike dhe gjuhësore. Varret e gjetura në Thrak, pra ato mbretërore janë si të tipit të Mikenës. *Aty si dhe në Miken edhe Iliri gjendet sëpata dy teheshe dhe varre me tuma, që tregon për një etnicitet të përbashkët iliro-thrak.* Disa fise janë quajtur edhe ilire dhe thrake, që tregon se kanë patur etnicitet të njëjtë.

*Fisi ilir i dardanëve, është quajtur nga autorët antik, si fis ilir, por nga disa burime të tjera edhe si fis thrakas. Babai i Dardanëve ishte mbreti Ark i Arkadhëve, i cili pas një përmytjeje që shkatërroi fushat e tyre emigroi në Samothrak.* (Po aty, f.73). Ndërsa Straboni, thotë se që aty ata emigruan në Trojë, nga e cila u quajt Dardane. Nga ana tjetër të gjithë autorët antik tregojnë se dardanët ishin një fis ilir. Edhe historianët e sotëm, dardanët i quajnë si fis iliro-thrak.

*Fisi ilir i tribalëve, shpesh është quajtur si thrakas dhe autorët e kanë shtrirë në fushë dardani.* Nëse dardanët ilir ishin thrakas atëherë dhe thrakasit ishin ilirë.

Fisi ilir i mysëve, në burimet antike del herë si fis ilir dhe herë si fis thrakas dhe nga burimet gjermanike mysët janë jo më shumë dhe jo më pak por vet gotët gjermanike. Nga ana tjetër Apiani i quan mysët si ilirë. (Apiani Illirike, f.6)

Në Iliri ka një fis me emrin bryg, për të cilin na njofton Straboni i cili thotë se: **“Pas Epidamnit dhe Apolonis gjer në malet Keraune banojnë bylinët, taulantët, parthinët e brygët.”** (Straboni, lib. VII, f.7) Edhe në Thrakë, ka një fis me emrin bryg, që në Trojë quhen frig apo frigjia. Straboni, thotë se vet **vrigasit janë brigian një fis thrakas.** (Straboni, lib VII, 3.2) Por ky fis i njohur si thrakas, del edhe si fis ilir dhe në zemër të Ilirisë.

Pra, siç e shikojmë, fise të quajtura si thrake janë edhe ilire njëkohësisht, që tregon se midis thrakasve dhe ilirëve nuk ka pasur dallime nga ana etnike. Të dhënat tregojnë se thrakët kanë folur të njëjtën gjuhë si dhe ilirët. Po Straboni thotë se **mysët iliro-thrakas të quajtur si Getae flasin një gjuhë të njëjtë me thrakët dhe dakët.** (Straboni, lib VII, 2.10)

Siç do e shikojmë, gjuha e dakëve përkthehet vetëm me anën e shqipës së sotme, që tregon se si thrakët ilirët dhe dakët kanë folur të njëjtën gjuhë dhe kanë qënë të së njëjtës etni. Gjuha antike e thrakasve ka shumë ngjashmëri me shqipen, aq sa të gjithë studiuesit për fjalët e saj i drejtohen shqipës që t'i përkthejnë. Shumë fjalë të thrakishtes janë përkthyer vetëm nga shqipja.

Në gjuhën thrake, të gjitha fshatrat kanë pasur fjalën **para ose fara**, që tregon se kemi të bëjmë me fshat. Studiuesit nuk arrijnë të kuptojnë se çdo të thotë fjala fara dhe se çfarë lidhje ka ajo me një fshat. Nëse këta studiues do të dinin mirë shqipen, do ta kuptonin menjëherë se çdo të thotë fjala fara. Nga shqipja, fara, do të thotë njerëzit e një fare, të një gjaku dhe në Shqipëri ka ekzistuar dhe në disa zona të thella ende ekziston ndarja në fara.

Pra, “Fara”, që përdoret tek thrakët për fshatin, është shqip dhe ka lidhje me një fshat të caktuar që ngrihet nga njerëz të një fare.

Kështu në Thraki janë 35 emra vendesh me emrin Fara nga pas dhe po jap disa si **Besafara**, pra vendi quhet **Fara e Besve**, në të cilën bëjnë pjesë antarët e një fare që quhet besa, **Dardafara** që do të thotë **fara e dardave**, **Bendofara që do të thotë fara e bendove** që me këtë emër është quajtur një perëndi. **Buzifara fara e buzve** etj.

Ndërsa qytetet e tyre kishin të gjitha një fjalë që quhet **bria**, por që sërish nuk është zbuluar se çfarë do të thotë dhe se çfarë lidhje ka ajo me një qytet. Qytetet e thrakasve kanë qënë edhe qendrat kryesore të fiseve dhe ndoshta këtë emër e kanë nga fjala **pria**, pra që prin apo drejton pasi që nga qytete drejtonte apo qeveriste.

Le të ndalemi tek disa të dhëna gjuhësore që kanë mbërritur nga Thraka, të cilat studiuesit i kanë përkthyer me shqipen. Gjuhtarët kanë mundur të përkthejnë disa shkrime shumë të shkurtra dhe me figura që tregojnë qartë fjalët dhe pjesës më të madhe të tyre iu jepet kuptimi nga shqipja.

<b>briza</b>	<b>briza</b> , puhiza pra një lloj ere
<b>daton</b>	<b>dhe-ton</b> vend ynë
<b>dreni</b>	<b>dreni</b>
<b>huri</b>	<b>huri</b> është quajtur dhe <b>hurri</b> në gjuhën e vjetër thrake si në gjuhën shqipe
<b>bardh</b>	<b>bardh</b>
<b>bolinth</b>	<b>buall</b>
<b>buza</b>	<b>buza</b> me këtë emër kanë quajtur veten e tyre thrakët. Fjala buza ruhet në gjuhën rumune dhe në atë shqipe pasi rumanishtja e ka ruajtur nga dakishtja. Nga fjala buzë ka marrë emrin edhe <b>Bizanti</b> pasi aty banonte fisi i Buzëve.
<b>ketra</b>	keter
<b>mar, mer</b>	<b>mar, mer</b>
<b>mezna</b>	<b>mez</b> pra i vogli i kalit. Kjo është gjetur në një shkrim ku flitej për një rritës kuajsh.
<b>manteia</b>	<b>man</b> pra fruti i manit
<b>phara</b>	<b>fara</b> siç është quajtur fshati
<b>ruamus</b>	<b>ram</b>
<b>rera</b>	<b>rera</b> , ose lera
<b>putra</b>	<b>putra</b>
<b>reza</b>	<b>reza</b> e diellit
<b>skalm</b>	<b>shkalm</b>
<b>spino</b>	<b>shpin</b>
<b>skila</b>	<b>skile</b> që i thonë ndryshe dhelprës
<b>skreta</b>	<b>shkreta</b>
<b>struna,</b>	<b>shtrun</b> lumë që ecën shtruar
<b>struma</b>	
<b>suka</b>	<b>shuka</b> rash në një grop apo kurth
<b>tunda</b>	<b>tund</b> , shtyn troket
<b>turm</b>	<b>turm</b> , që vrapon ose lufton
<b>titha</b>	<b>dita</b>

<b>zura</b>	<b>zura</b>
<b>zalmo</b>	<b>helmo</b>
<b>zenis, zënë</b>	<b>zënë</b> , pra fëmija është zënë dhe ka lindur që është edhe kuptimi i kësaj fjale.
<b>zeri</b>	<b>theri</b> sepse bëhet fjalë për therje të kafshëve.
<b>zi</b>	<b>zi</b> ka qënë zot
<b>ver</b>	<b>vera</b>

#### Emra vendesh

<b>armula</b>	<b>ar-mula</b>
<b>artan</b>	<b>ar-tan</b> të tre emra vendesh
<b>arzos, arzum</b>	<b>ar-zum</b>
<b>athos</b>	<b>athi ati</b>
<b>atlas</b>	<b>at-lash</b>
<b>byzantion</b>	<b>buza-ton</b> ky është shpjegimi i studiuesve, por në shqip d.m.th. Buza-ton
<b>kalsu</b>	<b>kal</b>
<b>chalastra</b>	<b>kala fortes</b>
<b>germania</b>	<b>germania</b> qytet në Thraki
<b>harmonia</b>	<b>harmonia</b>
<b>ide</b>	<b>ida</b> si në Trojë
<b>ilion</b>	<b>ilion</b> si në Trojë
<b>kalindonia</b>	<b>kalin-donia</b>
<b>kapisturia</b>	<b>kapistura</b>
<b>kersula</b>	<b>kesula</b>
<b>mygdonia</b>	<b>myg-donia</b>
<b>sërm</b>	<b>sërm</b>
<b>strambai</b>	<b>shtramb</b>

#### Emra personal

<b>bendi</b>	<b>bendi, bendo</b> ka qënë emri i një hyjnie dhe në Shqipëri ka sot mbiemra të tillë
<b>brinkazi</b>	<b>brin-ka-zi</b> edhe kjo hyjni
<b>buza</b>	<b>buza</b> edhe kjo perëndi dhe emri i Thrakasve
<b>darda</b>	<b>dardha</b>
<b>muka</b>	<b>muka</b> mbiemra që ekzistojnë edhe sot në Shqipëri
<b>zile</b>	<b>zile</b>
<b>ziper</b>	<b>djal i perëndisë</b> , që duhet të rrjedhi nga sipër, pra nga lart
<b>Emrat e Fiseve</b>	
<b>besa</b>	<b>besa</b> të gjithë studiuesit janë dakort që është shqip
<b>edoni</b>	<b>e-doni</b>
<b>medobithyni</b>	<b>me-do-bith-yni</b>
<b>bithyni</b>	<b>bith-yni</b> me këtë fjalë tregohen njëziti e një fisi
<b>thyni</b>	<b>thyni</b>

Të dhënat historike dhe gjuhësore, tregojnë qartë se thrakët ishin të një kombësie me ilirët dhe përderisa gjuha shqipe është gjuha bazë që përkthen ato pak fjalë të gjuhës thrake, atëherë ky është një fakt i fortë që tregon etnicitetin e njëjtë midis ilirëve dhe thrakasve.

Në Thraki ka ekzistuar festa **Baba Mart** që bëhej në fillim të marsit dhe kremtonte ardhjen e pranverës ku bëheshin dhe verore ashtu si aktualisht bëhet edhe në Shqipëri në 14 mars. Kjo festë është në traditën shqiptare, madje është kthyer edhe në festë kombëtare. Në Mysi veroret bëheshin me pe të kuq dhe të bardhë dhe në Thrak ishin të zeza me të kuqe ndërsa në Shqipëri, sot bëhen si tek Mysët me të bardha dhe të kuqe. Pasi shikonin zogjtë e parë i hiqnin dhe i hidhnin tek pemët e çelura.

Pra faktet historike gjuhësore, tregojnë se thrakët kishin të njëjtën etnicitet me ilirët. Janë të shumtë historianët sot, që me një emër ilir-thrak quajnë të gjithë popullsinë e gadishullit Ilirik, pasi ata i konsiderojnë këto dy popuj të së njëjtës etni.

### **Lidhjet etnike iliro-dake**

Dakët, ishin një popullsi që ka banuar në Rumaninë e sotme dhe pasardhës të tyre mbahen rumunët, por për nga gjuha pasardhësit e tyre direkt, mbahen shqiptarët. Pse shqiptarët/ Kjo sepse gjuha e tyre përkthehet vetëm me shqipen.

Nga burimet antike, dakët dalin si të njëjtë nga etniciteti me mysët iliro-thrak dhe me skithët. Pra të një etniciteti me ilirët.

Duke u mbështetur nga të dhënat gjuhësore del qartë se dakët kanë folur shqip dhe këtë nuk e ka hedhur dot poshtë asnjë studiues deri më sot, pasi shqipja është autoritare dhe bindëse në përkthimin e gjuhës së dakëve. Madje disa studiues duke parë afërsinë e madhe të gjuhës shqipe me dakishten, arrijnë në konkluzionin se shqiptarët janë dakë që kanë emigruar për në truallin që janë sot.

Kjo është e vërtetë pjesërisht, vetëm përse i përket asaj pjese, që meqë dakët dhe shqiptarët e sotëm kanë të njëjtën gjuhë, atëherë ata janë të një etnie, por ajo që nuk është e vërtetë, është pjesa tjetër që dakët nuk kanë emigruar në territoret e sotme shqiptare, por në antikitet dakët kanë qënë të së njëjtës etnie me ilirët pra me shqiptarët, ose e thënë ndryshe dakët kanë qënë gjyshërit e shqiptarve ashtu si ilirët, thrakët, trojanët, italikët.

Nga 160 fjalë që studiuesit mendojnë se kanë origjinë dake 90 fjalë gjenden në gjuhën e sotme shqipe. Shqipja e sotme përkthen pjesën më të madhe të fjalëve të dakishtes, gjë që se bën as rumanishtja, populli i së cilës është pasardhës për nga gjaku i dakve. Kjo tregon se dakët dhe ilirët kanë patur një gjuhë të përbashkët, por dakët më pas u romanizuan duke mësuar gjuhën e shtetit romak, ndërsa shqiptarët janë të vetmit nga ajo racë e lashtë e Evropës që flasin ende këtë gjuhë të vjetër.

*Straboni e ka dëshmuar në antikitet që dakët flisnin të njëjtën gjuhë me mysët iliro-thrak, me vet thrakasit dhe me skithët. Derisa dakët kanë folur një shqipe të variantit të pastër, atëherë edhe fiset e tjera që kanë patur një gjuhë me dakët, kanë folur po këtë shqipe. Po japim më poshtë fjalët shqip tek dakishtja.*

Në Rumani sot një majë e maleve Karpate quhet **omul pik**, pra pika më e lartë e molit, por rumunët nuk e përkthejnë dot me gjuhën e tyre.



Lumi Ister, pra Danubi, nga të dhënat që jep Straboni, u quajt nga Dakët me këtë emër, pasi në pjesën e poshtme të rrjedhës së tij ishte i shtruar. Fjala istru që kanë përdorur dakët ka kuptimin nga shqipja si **ishtru pra i-shtru** që është edhe kuptimi i vërtet i kësaj fjale.

Dacia që ndodhej në anë të lumit është quajtur nga vendasit si **Dacia Analumase** që është Dacia **ana-lumase pra an-lumit**.

Dacia malore, quhej me emrin **Dacia malpensa** dhe më pas **Ripensa**, pra dacia në **mal apo rripa rripa** që është sërish sinonim i malit. Le të shikojmë një për një listën e fjalëve dake të cilat përkthehen nga shqipja dhe që i pranojnë të gjithë historianët dhe janë pothuajse në të gjitha enciklopeditë.

<b>Dakisht</b>	<b>Shqip</b>
<b>abur</b>	<b>avull</b>
<b>alak</b>	<b>a-lak-er</b>
<b>Agal</b>	<b>ngadal</b>
<b>Amurg</b>	<b>a-murg</b>
<b>a-zuga</b>	<b>zhuga</b>
<b>baliga</b>	<b>balga</b>
<b>balta</b>	<b>balta</b>
<b>bara</b>	<b>bar</b>
<b>barza</b>	<b>bardha</b>
<b>basca</b>	<b>bashk</b>
<b>balan</b>	<b>bala</b> ose <b>balo</b> një njeri me lara që përdoret edhe sot si balo balash
<b>boare</b>	<b>bora</b> ere bore
<b>brad</b>	<b>bredh</b>
<b>briu</b>	<b>brez</b>
<b>broasca</b>	<b>breshka</b>
<b>buk</b>	<b>byk</b>
<b>bukura</b>	<b>bukur</b> fjalë që ndodhet edhe në rumanishten e sotme dhe vet kryeqyteti i rumanisë është shqip <b>bukur-është pra që është-bukur</b> .
<b>bunget</b>	<b>bunk</b> që do të thotë pyll i erret dhe i dendur
<b>burta</b>	<b>barku</b> i kanë thënë stomakut, barkut
<b>buza</b>	<b>buza</b>
<b>bufnita</b>	<b>buf</b>
<b>bulz</b>	<b>bulz</b>
<b>kaciula</b>	<b>kasula</b>
<b>kapusa</b>	<b>kepusha apo këpusha</b>
<b>kaputa</b>	<b>kapuca</b> pra këpuca
<b>karaban</b>	<b>karabishte</b>
<b>katun</b>	<b>katund</b>
<b>koc</b>	<b>kok</b>
<b>kodru</b>	<b>kodra</b> thuhet një vend me pyll të egër
<b>kopac</b>	<b>kopaç</b>
<b>kursa</b>	<b>kurtha</b>
<b>das</b>	<b>dash</b>

<b>deh</b>	<b>deh</b>
<b>don</b>	<b>don</b>
<b>droaie</b>	<b>droje</b>
<b>farima</b>	<b>therima</b>
<b>gard</b>	<b>gardh</b>
<b>gata</b>	<b>gati</b>
<b>galbeaza</b>	<b>gelbaza</b>
<b>gjimpe</b>	<b>gjemb</b>
<b>gjionte</b>	<b>gjuante</b>
<b>gjiuj</b>	<b>gjysh</b>
<b>grapa</b>	<b>grep</b>
<b>gresie</b>	<b>gërresë pra kur fle gjumë</b>
<b>groapa</b>	<b>gropa</b>
<b>grumaz</b>	<b>grumaz</b>
<b>grunz</b>	<b>grundë</b>
<b>gudura</b>	<b>gudulis</b>
<b>gusa</b>	<b>gusha</b>
<b>iazma</b>	<b>fantazma pra një hije</b>
<b>leagan</b>	<b>legan djep ku tundesh</b>
<b>mal</b>	<b>mal, kodër breg deti</b>
<b>maces</b>	<b>mace</b>
<b>magar</b>	<b>gomar</b>
<b>mamaliga</b>	<b>mamaliga një lloj ushqimi që edhe sot kështu quhet në Shqipëri</b>
<b>markat</b>	<b>markat nga folja marr e shqipes ku merr ushqime</b>
<b>matura</b>	<b>i matur i pjekur</b>
<b>mieru</b>	<b>mjer</b>
<b>mire</b>	<b>mire</b>
<b>mistret</b>	<b>mistrec</b>
<b>miska</b>	<b>mika</b>
<b>mot</b>	<b>moti</b>
<b>mos</b>	<b>mosh</b>
<b>mugure</b>	<b>mu-gure</b>
<b>murg</b>	<b>murg</b>
<b>napirca</b>	<b>neperca</b>
<b>olog</b>	<b>ulok një njeri që është i gjymtuar</b>
<b>pastra</b>	<b>paster</b>
<b>pastai</b>	<b>pishtai bishtai ku ka zëvendësuar</b>
<b>pinza</b>	<b>pinca</b>
<b>rata</b>	<b>rasa, rosa</b>
<b>rinza</b>	<b>renza</b>
<b>skapara</b>	<b>shkarpa</b>
<b>skrum</b>	<b>shkrum</b>
<b>skula</b>	<b>shkula</b>
<b>spin</b>	<b>shpin</b>

<b>sterp</b>	<b>shterp</b>
<b>stina</b>	<b>stina</b>
<b>strunga</b>	<b>shtrungoj</b> e mbys dikë, i marr frymën
<b>sumbull</b>	<b>sumbull</b>
<b>tap</b>	<b>cjap</b>
<b>vapaie</b>	<b>vapa</b>
<b>vatra</b>	<b>vatra</b>
<b>vatui</b>	<b>vata e vete</b>
<b>zara</b>	<b>zara</b>
<b>zar</b>	<b>zar</b>
<b>zgarda</b>	<b>zagar</b>
<b>zgiria</b>	<b>zhgara-vis</b>
<b>zgura</b>	<b>zgjyra</b>

Pra siç shihet nga fjalët që kanë mbërritur nga dakishtja, ato janë të një varianti shqip të pastër. Këto dëshmojnë se dakët kanë qënë të një etnie me ilirët dhe vetëm shqiptarët ruajtën gjuhën e vjetër të Evropës që kanë folur ilirët, thrakët, dakët e më gjerë. Asnjëherë në antikitet nuk është thënë direkt se dakët dhe ilirët flisnin të njëjtën gjuhë, kjo tregon se sa pak kanë ditur autorët antik për etnicitetin e Evropës së kohës.

Për krijimin e kombit të ri rumun do flasim më pas, si dhe për gjuhën e tij sot dhe ngjashmëritë që ka ajo me shqipen.

### **Lidhjet etnike iliro-dardano-trojane**

Troja ka patur një nga qytetërimet më të lavdishme të historisë së njerëzimit si dhe një nga më të vjetrit. Kur Herodoti, shkruan për trojanët thotë se “... **ata në kohën e fuqisë dhe lavdisë së tyre më të madhe, kishin pushtuar Thrakën deri në detin Jon.**”(Herodoti lib. VII f.20) Pra Troja në prehistori apo në kohën historike ka qënë një perandori dhe sot nuk dimë asnjë gjë për historinë e saj.

Ajo që sot nuk është përcaktuar, është etniciteti i trojanëve dhe kjo jo pa ndonjë qëllim të caktuar. Shkenca e historisë nuk i kushton shumë rëndësi etnicitetit të këtyre popujve, por kulturës apo historisë së tyre dhe kjo ndoshta me ndonjë qëllim të caktuar. Trojanët nga pikëpamja etnike, ishin popullsi e njëjtë me ilirët, pellazgët, thrakët, dakët, skythët etj. Faktet që vijnë nga historia, e dëshmojnë një gjë të tillë.

Me emër Trojan, po quaj të gjithë popujt që banonin në Azi të Vogël gjatë dhe pas luftës së Trojës, pasi këto popuj ishin të një etnie.

### **Mysët, lidët, karët dhe lelegët**

Herodoti thotë se: “... **lidianët, karianët dhe mysët ishin vëllezër**”(Herodoti, I, f.171) Emër i vjetër i karianëve ishte leleg, kështu që edhe lelegët ishin të një etnie me ta. Pra, me një fjalë popujt kryesorë që banonin në Azinë e Vogël si lidët, mysët, karët, lelegët, ishin të një etnie.

Straboni në lidhje me etnicitetin e mysëve të Trojës thotë se ata janë nga Thrakia. Mysët, gjithashtu, janë thrakas dhe identik me njerëzit që tani quhen Moesi. **Nga këta mysë rrjedhin dhe mysët që jetojnë midis lidëve, frigëve dhe trojanëve. Dhe vet frigit janë brigi, një fis**

**thrakas ashtu siç janë mygdoni, bebri, medobithyni, bithyni dhe thyni.**(Straboni, lib VII, 3.2)

Pra, mysët dhe frigët janë thrakas, por ata janë edhe ilir pasi mysët dhe brygët dalin dhe si fise ilire. Mysët nga ana tjetër ishin edhe të një etnie me lidët, karët dhe lelegët. Atëherë edhe këta të fundit ishin të një etnie me ilirët.

### **Dardanët**

Dardanët, ishin fis trojan dhe ilir. Sipas të dhënave të autorëve antik, ku së pari citojmë Strabonin: “... **Dardania e Azisë së Vogël, është themeluar nga dardanët e Ilirisë**”(The geography of Strabon, botuar në 1917 nga Leob Classical Library, Libri VII, paragrafi 48) Ndërsa autorët romak tregojnë qartë se **dardanët e Ilirisë janë ata të Trojës, kur flasin për origjinën nga dinastia e Trojës, si perandori ilir me origjinë dardane, Klaudi II.**(Ilirët dhe Iliria f.325)

Sipas Diodorit të Siçilisë: “**Dardani është biri i Zeusit me Elektrën të bijën e Atlasit dhe vëllai i Harmonis, nënës së Ilirëve.**”(Diodor Sicilius, lib V. f.48).

I biri i Dardanit ishte Eriktoni që pati për djalë Trosin emrin e të cilit mban Troja, pasardhës i tij ishte Ili që themeloi Trojën. Ili ishte gjyshi i Priamit.

Dardani i ka dhënë emrin e vet Samothrakës. **Pasardhësi i tij Eriktoni dhe Bateaia bëhen mbret të Thinës**(R.Bell, 1989 f.98)

Një traditë e quan **Dardaninë, si Pallasin të birin e Lykaonit**(Servius a Virgjil, Eneide, II, 325; IX,10) **Pallasi, është një nga bijtë e Ilirit Lykaon,**(Halicarnasis I.68) **Jasoni është vëllai i Dardanit dhe i Harmonis, nënës të Ilirëve.**(Tab, Gjenealogjike nr.7 Diodor de Sicile, V,48).

Dardanët gjenden në Iliri, Trojë, në Itali, ndërsa pasardhësit e tyre shkojnë deri në Angli dhe Belgjikë.

Pra, nga të dhënat që sjellin autorët antik, dardanët e Trojës janë të njëjtë etnikisht me dardanët e Ilirisë dhe ata janë me origjinë pellazgo-ilire pasi dalin si pellazg, ilir dhe trojanë. Fisi dardan i Ilirëve (që sot quhet me emrin sllav Kosovë) është në territoret e tij etnike dhe përbën një pjesë të konsiderueshme të atij që quhet komb shqiptar.

Pra në botën antike, dardanët e Ilirisë, me kohë u quajtën se kishin të bënin me një fis me të njëjtin emër që jetonte në viset e Azisë jug-perëndimore dhe që emrin e të cilëve e mori krahina e Dardanisë nga rrjedh edhe sot emri i Dardaneleve.

Shpërngulja e dardanëve nga Troja dhe vendosja e tyre në Romë pas luftës, është përjetësuar në “Eneidën” e Virgjilit. Ndërsa emigrimi i tyre më tej për në Britani, është përjetësuar nga Geofrey of Manmonthis me “Historia e mbretërve Britanik”.

Sot historianët më serioz, e kanë pranuar lidhjet midis dardanëve të Ilirisë dhe të Trojës, pasi kjo mbështetet dhe nga burimet historike, por dhe nga vetë emri që ka kjo krahinë shqiptare që sllavët e quajnë Kosovë. Ky fis i lavdishëm ilir i mbijetoi dyndjeve barbare duke ruajtur etnicitetin dhe gjuhën ilire.

Pra, dardanët janë vetë dardanët e Ilirisë që kanë themeluar Trojën. *Ata janë themeluesit e njërit prej qytetërimeve më të vjetra të botës, atij të Trojës, por gjithashtu nga ky fis dardanësh u themelua edhe Roma që u bë perandori disa shekulle.* Nga dardanët e Ilirisë kanë dalë disa perandorë si, Klaudi II, Konstandini i Madh, Justiniani i Madh etj.

### **Frigët**

Në disa përkime emrash të tjerë etnik mbështetet ideja e ekzistencës së lidhjeve midis Ballkanit e Azisë së Vogël duke i vënë mysët e Ballkanit në Azi dhe *frygët e Ballkanit si fryg të Azisë*. Sot, qarkullon një shpjegim që jep si rrethanë të mundshme shpërnguljen masive të fiseve në fund të epokës së bronzit XII p.k., ku disa nga fuqitë e mëdha të themeluara në Mesdhe u tronditën nga dyndjet e popujve të detit. Ajo që vlen të theksohet është fakti se janë edhe disa fise të tjera ilire-thrake që e kanë pasur origjinën nga Troja që vërteton edhe origjinën e dardanëve. Frigët dalin në afërsi të Durrësit, Thraki dhe Azi të vogël.

### **Kaonët**

Kaonët e Epirit në antikitet quheshin me prejardhje nga Lykaonët e Trojës, po kështu dhe Kaonët e Italisë. **Lykaoni, sipas mitologjisë, ishte i biri i Pellazgut**. Një pjesë e këtyre kaonëve pas luftës së Trojës, u vendosën në Epir dhe i vunë emrin vendit Kaoni dhe një pjesë e tyre emigruan për në Itali.

### **Paionët**

Ata mbanin veten e tyre se ishin me origjinë Trojane ashtu si dhe vet maqedonët, që ishin Paion, ashtu si dhe vet dinastia Epirote që rridhte nga Andromaka e Hektorit me Pirron e Akilit. Herodoti, vë në gojën e një të riu paion, që po bisedonte me Darin në lidhje me etnicitetin e Paionëve, këto fjalë: *“Paionia në brigjet e Strymonit dhe ky lumë nuk është larg nga helesponti, se ishin me prejardhje Teukrase dhe koloni e trojanëve”*. (Herodoti, Historia, lib. V, f.13)

Paionët në histori njihen si fis Ilir, kështu që edhe trojanët ishin ilir. Madje nga paionët popullohej në pjesën e saj më të madhe, Maqedonia e vjetër.

### **Pellazgët**

Në Trojë, përveç dardanëve, mysëve, kanë jetuar edhe pellazgët që kishin prijës Leto Teutamidin. Pellazgët, janë quajtur ndryshe edhe maqedonët dhe epirotët, që tregon se ata ishin të një etnie me ilirët dhe fise të tjera në Azi e Ballkan. Edhe sot epirotët etnik janë pasardhës të epirotëve të vjetër dhe përbëjnë sot një pjesë të konsiderueshme të kombit shqiptar. Ajo që vlen të theksohet është fakti se shqiptarët e sotëm e kanë origjinën nga disa fise pellazgo-ilire. Pak fjalë që kanë mbërritur nga gjuha e Trojës mund të shpjegohen nga shqipja.

Kështu disa fjalë të frëngjishtes janë përkthyer me anën e shqipes së sotme. **Buk** që frigët i thonin **bukës**, në kët formë e përdor vetëm shqipja.

Herodoti, tregon një histori lidhur me fjalën buk të frigasve. Sipas tij faraoni i Egjiptit donte të dinte se cila ishte gjuha më e vjetër në botë, ajo egjiptiane apo ajo frige. Për të gjetur këtë ai vendosi dy fëmijë në një ambient të izoluar, ku askush nuk do i fliste asnjë fjalë dhe pas disa viteve do nxirreshin për të parë fjalën e parë që do të flisnin.

Pasi dolën fëmijët e uritur përmendën fjalën buk. Atëherë faraoni tha se frigasit që kanë fjalën buk, kanë edhe gjuhën më të vjetër në botë.

Studiuesit sot, me kë nuk e krahasojnë fjalën buk. Nuk kanë lënë gjuhë pa e krahasuar për ta gjetur se me kë ka ngjashmëri. Sigurisht që këta studiues e dinë që në Shqipëri sot i thonë bukës, buk, por faraoni tha që ajo është gjuha më e vjetër në botë dhe kjo disave, mesa duket, nuk ju pëlqen.

Në gjuhën frike **Ati**, ishte një perëndi e lartë dhe dashuronte perëndinë **nënë**, që ata e quanin në gjuhën e tyre **nana**, ashtu siç quhet edhe sot në shqip.

**Sybyla**, quhet edhe sot një enigmë për historianët, sigurisht po të dinin shqip nuk do ishte e tillë. Sybela ose sybyl, ishte një profeteshë, që tregonte fatin me sy mbyllur, pra sy-mbylla.

Nuk ka asnjë dyshim se popullsia e Azisë së Vogël, në prehistori dhe histori, ishte e etnicitetit ilir, madje dhe të dhënat antropologjike tregojnë praninë e popullsisë me tregues qefalik, brachycefal, si ai i popullsisë më të vjetër të Evropës, ashtu siç janë shqiptarët dhe raca gjermanike sot.

### **Lidhjet etnik midis maqedonasve, epirotëve dhe ilirëve**

Maqedonët shtriheshin në territoret, nga liqenet e Ohrit dhe Prespës në perëndim (dhe ndonjëherë me emrin maqedoni janë përfshirë të gjitha territoret e shtetit Ilir, pra ku ndodhet shteti i sotëm shqiptar) në lindje kishte kufi Thrakën dhe në veri mysët, ndërsa në jug Epirin dhe Thesalinë.

Ndërsa Epiri shtrihej nga lumi Vjosa deri në Ambraki, edhe Amfilohët quheshin gjithashtu epirot.

Shtrohet pyetja çfarë etniciteti kanë patur maqedonët dhe epirotët e vjetër? Kjo është një pyetje që e ka marrë përgjigjen nga vetë autorët antik.

Maqedonët dhe epirotët ishin të një etnie me ilirët ose e thënë ndryshe ishin ilir. Maqedonia është quajtur **Emathia** që në shqip do të thotë e mathia apo e **madhja**. Kryeqyteti ishte **Pela**, që do të thotë po pela në shqip, pasi maqedonët mbaheshin për rritës kuajsh dhe ka shumë emra vendesh me këtë emër. Ka një mal me emrin **bora**, që i përgjigjet po fjalës bora në shqip, pasi ai duhet të ketë ndenjur me borë gjatë gjithë vitit.

Straboni, pohon se popullsitë që ndajnë territorin e saj janë **epirotët, ilirët, beotianët dhe thrakët**(Mathiu Aref, Shqipëria... f.66) **Maqedonia është konsideruar si pjesë e Thrakisë.**(Hekateuc frag 115)

Pra, Straboni e tregon qartë se nuk ka ndonjë etni maqedone të veçantë, thjesht janë disa fise ilire, thrake, epirote, të një etniciteti, të cilët sundoheshin nga një mbret. Territoret e saj, herë bëheshin të ilirëve, herë të epirotëve dhe herë të thrakëve, kjo varej se sa i zoti ishte mbreti që t'i mbante nën pushtetin e tij.

**Homeri tek "Iliada", i quan maqedonasit paion.**(Ilirët dhe Iliria f.10) **Straboni thotë të njëjtën gjë tek gjeografia, se paionët në viset rreth lumit Aks janë quajtur për këtë, amfaksitë.**(Ilirët dhe Iliria. f.162)

**Herodoti thotë po të njëjtën gjë dhe i vendos paionët rreth lumit strymon.**(Ilirët dhe Iliria f.17) **Justini i quan maqedonasit si pellazgë.**(Ilirët dhe iliria f.291)

**Straboni i quan si të njëjtës etnicitet si maqedonët dhe epirotët, pasi ai e shtrin konceptin e Maqedonisë deri në Korfuz, për arsye se të gjithë këta kanë të njëjtën kulturë dhe të folur.**(Ilirët dhe Iliria f.160)

Plini plak thotë se: **"Epiri do të jetë quajtur Dryopid. Ai ishte i biri i Apollonit dhe Dias, bijës së Lykaonit ilir"**.(Plini Plak, lib IV 2.2) Sipas Arkadhasve Dryopi, është pasardhës i mbretit Lykan të birit të Pellazgut. **Kurse Epirja është bija e Ekionit dhe Agavës, motrës së Ilirit, pra mbesa e Ilirit.** Krahina e Epirit mban emrin e saj.

Epir, nga shqipja do të thotë i epërm, pra i lartë. Grekët thonë se ia kemi vendosur ne emrin "epir", për të treguar tokën stere, pra një tokë mbi ujë. Grekët antik, që ia kanë vendosur, siç e pamë, kanë folur një gjuhë shqipe dhe fjala Epir është shqip. Nëse ajo e ka kuptimin që është tokë mbi ujë, atëherë është shqip e epërme, pra e lart. Nëse sot do kishim dhe dialekte që kanë folur grekët e lashtë, do të dilte në shesh e vërteta, pasi shqipja ka sot ato pak fjalë, që

njohim nga ata dialekte që fliteshin nga një popull pellazgo-ilir. Kjo fjalë mund të ketë kuptimin se ishte i epërm pra i lartë, ngaqë aty ishte orakulli i Dodonës, dhe pellazgët epirot quheshin edhe si hyjnor dhe me ta nuk bënte luftë njeri se ishin të shenjtë. Autorët antik, e quanin orakullin e Dodonës si pellazgjik, po kështu dhe epirotët.

Epirotët flisnin të njëjtën gjuhë me maqedonët. Plutarku (Pirrua 11) thotë se: *Maqedonasit dhe epirotët flisnin të njëjtën gjuhë, një idom aq të ngjashme aq sa merreshin vesh me lehtësi, me njëri-tjetrin*. Territorët e “ashtuquajtura greke”, fillonin në gjirin e Ambrakisë dhe në grykderdhjen e lumit Peneu. Këtë na i vërteton Pseudoskilaksi, Straboni etj.

Pra, nga të dhënat e autorëve antik maqedonasit dalin si paion, pra ilirë si epirot dhe si pellazgë. Meqë nga historianët më të mëdhenj dhe më serioz të antikitetit janë quajtur si paion, atëherë ata kanë qënë të një etnie me ilirët. Epirotët, të cilët edhe sot përbëjnë një pjesë të madhe të atij që quhet komb shqiptar, janë quajtur pellazg ashtu si maqedonët dhe të një etnie me ta, kështu që epirotët dhe maqedonët janë një kombësi me njëri tjetrin, si dhe me ilirët. Të gjitha faktet historike të sjella nga autorët antik, tregojnë qartë etnicitetin ilir.

Siç e kemi parë edhe vetë, grekët e vjetër, ishin pellazg, por nga Hellada e vjetër vetëm pellazgët apo arvanitët kanë mbetur, pasi kombi modern grek ka gjak shumë të përzier me sllav, vllah, turq, egjiptian dhe në njëfarë mënyre vetëm arvanitët mund të pretendojnë se janë grekët e vjetër dhe jo racat e tjera që përbëjnë kombin grek.

Pretendimet territoriale ndaj Shqipërisë që historikisht dhe antropologjikisht është etnia më e vjetër dhe më autoktone në Evropë, janë qesharake, pasi kërkohen nga një racë që nuk ka të bëjë fare me grekët antik që ishin pellazg dhe pasardhës të tyre janë vetëm shqiptarët arvanit, që kanë kaq vite që po iu bëjnë terror psikologjik për t’iu mbushur mendjen se duhet të bëhen disa grek artificial, kur në të vërtetë ata janë grekët e vërtetë, pasi ishin pellazgët ata që lindën kombin antik grek. Deri në Korinth edhe sot del një popullsi që antropologjikisht ka karakteristikat e shqiptarëve të sotëm.

Aleksandri i Madh, gjuhën e nënës kishte maqedonishten apo ilirishten dhe greqishten artificiale që përdorej për letrat, ia mësoi Aristoteli. Plutarku vë në dukje se ka një gjuhë maqedonase pasi gjeneralët e moshuar maqedon e përshëndetnin Aleksandrin në maqedonisht.

Polibi thotë se: **“Etolianët, akarnanët dhe maqedonasit janë njerëz të një gjuhe të ndryshme nga greqishtja.** (Polibi IX, f.37) Askush nuk mund të tregojë sot, se sa e ndryshme ka qënë greqishtja nga gjuhët e tjera pellazgo-ilire.

Çështja tjetër kur bëhet krahasimi me gjuhët e tjera, bëhet me gjuhën që fliste populli pellazg i Greqisë së asaj kohe, apo me gjuhën artificiale greke, që Sokrati thonte që duhej ta mësoje, që të ishte grek.

Meqë maqedonët mund të përdornin gjuhën greke në monedha, kjo nuk do të thotë se janë të një etniciteti me këta grekët e sotëm. Grekët e sotëm e përdornin greqishten po kaq artificialisht siç e përdornin vet grekët antik, mbretërit maqedon, ilir, thrakë, që e kanë një gjuhë artificiale dhe jo të etnisë së tyre. Ajo gjuhë ka qënë ndërkombëtare artificiale dhe si e tillë përdorej nga të gjithë. Pra maqedonët ishin të një kombësie me ilirët dhe epirotët. Me emrin *Hiperboreal tregohej një vend ku vinin shpirtrat dhe që disa mendojnë se është Epiri*. Shqipja, është ajo që jep kuptimin e fjalës hiperboreal nga *hipër* që do të thotë **sipër**, pasi hip tregon diçka që është sipër, plus **boral**, pra që tregon borën pasi vendi konsiderohej i ftohtë.

## **Lidhjet etnike midis ilirëve skitho-saramante dhe baltëve**

---

## Popullsia e vjetër e Iberikut

.....

## Galia e vjetër

.....

## Albioni i vjetër (Britania) dhe pjesa tjetër e Evropës

.....

## Pellazgo-ilirët në Azi dhe Afrikë

.....

## Pellazgo-ilirët në Afrikën Veriore dhe Lindjen e Mesme

.....

## Në Azi

.....

## Të dhënat arkeologjike

.....

## Të dhënat antropologjike për racën shqiptare dhe evropiane

Të dhënat antropologjike janë gjithashtu një fakt historik, që ndihmojnë shumë në zbulimin e të vërtetave historike. Madje ato ndonjëherë janë të vetmet dhe vendimtarët në përcaktimin e çështjeve që nuk mund t'i përcaktojnë shkrimet historike. Çfarë tregojnë të dhënat antropologjike për çështjen që po trajtojmë?

Për të përcaktuar etnitë dhe racat, shpesh antropologjia ka si etalon matës, treguesin e kafkës së kokës, i cili është edhe një provë e qartë për përcaktimin e etnicitetit të popujve dhe vjetërsisë së tyre.

Në bazë të madhësisë së kafkës së kokës popullsia ndahet në:

**Brachycephalas** që tregon një kokë, tepër e gjerë madje quhet dhe koka e rumbullakët. Treguesi cephalik është mbi 80.

**Mezocephalas** që është një kafkë koke më e ngushtë se ajo e para. Treguesi qefalik është 75-80.

**Dolicephalas** që është një kokë e gjatë dhe e hollë. Treguesi cephalik është nën 75.

*Lind pyetja se çfarë lloj kafke ka mbizotëruar në Evropë në kohërat prehistorike?*

Që nga epoka e Paleolite dhe Mezolite në Evropë shfaqet një tip njeriu brachycephalic. Pra ky është edhe tipi më i vjetër i njeriut në Evropë, që tregon një autoktoni të padiskutueshme për etnitë që e kanë. Pra etnitë brachycephalas, janë dhe më të vjetrat e Evropës.

*Cilat janë etnitë sot, që kanë një kokë të pastër brachycephalas?*



Shqiptarët me një tregues cephalik nga më të lartët në Evropë, (me tregues 85-90), shpesh quhen dhe si hiperbrachycephalas. Shqipëria e jugut ka dhe brachycephalin më të lartë ndoshta më të lartën në Evropë, pra hiperbrachycephalas.

Janë brachycephalas si shqiptarët, gjithashtu Gjermania, Austria, Zvicra, Franca Lindore, Belgjika në pjesën më të madhe të saj, Popullsia e Karpateve nga dolën Rumunët dhe Hungarezët.

Pse Hungarezët, kur dihet se ato janë të një etnie të ardhur?

Kjo tregon se pjesa më e madhe etnike hungareze, është etnike evropiane dhe rrjedh nga fisi panon i ilirëve ndaj dhe ka këto karakteristika. Ato pak fise hungro-file që erdhën dhe pushtuan Hungarinë nuk përbënin pjesën më të madhe të saj, ndaj dhe nuk dominojnë antropologjikisht. Populli brachycephalas, ka një pjesë e Irlandës, Skocia, një pjesë e Holandës perëndimore e quajtur Frizia, që është një popullsi me origjinë ilire dhe ka ruajtur këto karakteristika, bregdeti perëndimor i Norvegjisë, një pjesë e madhe e Danimarkës e Islandës dhe Italia Veriore e Qëndrore. Edhe Armenia në Kaukaz ka të njëjtin tregues cephalik. Kjo racë është quajtur ndryshe dhe si raca alpine.

### **Çështja e Ballkanit**

Në Ballkan popullsia sllave është e ndryshme antropologjikisht nga raca shqiptare pasi sllavët janë *mezocephalas*.

Përveç shqiptarëve që janë brachycephalas, dalin dhe pjesa bregdetare e Bosnjës dhe Malit të Zi me një kokë brachycephalas. Çfarë tregon kjo? Pse këta sllavë janë me një kokë si shqiptarët?

Këta sllavë nuk janë sllavë, por ilirë të një race me shqiptarët. Malazetët janë shqiptarë të sllavizuar dhe pjesa bregdetare e Bosnjës. Një pjesë e Bosnjës sot është me origjinë nga Thrakia që u shpërngul nga turqit për në Bosnje. Por thrakët dhe ilirët ishin të një etnie ndaj dhe sot boshnjakët kanë, në një pjesë të madhe të tyre, tregues cephalik si tek shqiptarët.

Kështu treguesi cephalik që identifikon etninë ilire apo shqiptare vazhdon në të gjitha zonat që janë banuar nga shqiptarë, si në Dardani dhe Maqedoni, vazhdon në Epirin e jugut që sot e ka shteti i quajtur Greqi mandej në pjesën e bregdetit deri në Korinth e theksojmë nga ana bregdetare dhe jo në brendësi të territoreve, ka po të njëjtin tregues.

Kjo tregon se antropologjikisht, deri në Korinth kemi të bëjmë me një popullsi të pastër shqiptare. Këtu ia kanë vënë kufirin antropologjik brachycephalas. Në popullsinë e Greqisë, është antropologjikisht e përzier raca shqiptare siç u tha, brachycephal, raca sllave mezocephalas dhe dolicephalas e njëjtë me atë të Afrikës, si popullsia e Kretës dhe disa territoreve të tjera. Ajo është e përzier ashtu siç janë dhe etnitë që formojnë kombin modern grek.

Interesante është prania e brachycephalas në Azinë e Vogël. Turqit sot kanë një tregues cephalik arkaik evropian. A nuk thonë studiuesit se turqit kanë ardhur nga Mongolia? Nëse turqit mongol do përbënin një pjesë të madhe të popullsisë, atëherë popullsia e sotme turke do ishte mongole.

Prania e këtij treguesi cephalik tregon se popullsia që përbën sot etninë turke është popullsia e vjetër pellazgo-ilire e Azisë së Vogël. Edhe të dhënat historike tregojnë se në shekullin e XV-të, disa feudalë mongolë, e pushtuan atë territor me ndihmën e shqiptarëve, por popullsia nuk ndryshoi vetëm u kthye në një identitet të ri gjuhësor, por jo antropologjik. Ndonjë

brachycephal mund të gjendet në bregdetin e Sirisë dhe Libanit dhe në disa koloni të veçanta në atë territor që tregojnë se ato toka kanë qënë nën ndikimin e popullsisë së bardhë.

**Mezocephalas** është popullsia sllave e Evropës, nga Rusia deri në Poloni dhe nga sllavët e jugut deri në Baltik. Mezocephalas duhet të ketë dalë nga përzjerja e popullsisë vendase evropiane brachycephalas me popullsinë aziatike nga dolën sllavët, që është dolicephalas dhe rezultati është një mezocephalas.

**Të përzierë brachycephalas, mesocephalas dhe dolicephalas**, janë zona e Britanisë, pjesa më e madhe e Hollandës, pjesë të Belgjikës, një pjesë e Francës, pjesa më e madhe e Skandinavisë, Finlandës, Estonia, Latavia. Kjo quhet ndryshe dhe raca nordike. Si ka ndodhur që ka një përzjerje të tillë? Skandinavët janë dolicephal, pra me një kokë të gjatë. Si është e mundur që ata janë të vetmit popullsi etnike evropiane me një kokë të tillë kur dihet që popullsia e Evropës prehistorike ka qënë brachycephala? Kjo i ka çuditur antropologët, pasi është një dallim i madh me të dhënat antropologjike të popullsisë së vjetër evropiane dhe e shpjegojnë edhe me kushtet klimaterike. Kjo është çështje që iu përket antropologëve ta shpjegojnë. Britanikët dhe pjesa veri-perëndimore e Evropës ka qënë brachycephalik, por në shekujt X-XII ka një dyndje nordike në Britani dhe kjo shkaktoi edhe këtë përzirje.

Një pjesë e Iberikut, Franca e jugut, Italia e jugut, Kreta kanë dominim Afrikan, pra një popullsi evropiano-afrikane që shpesh quhet dhe mesdhetare.

Pra siç shihet Evropa sot është një kontinent brachycephal dhe mezocephal. Një pjesë e madhe e kombeve etnike evropiane, sot trashëgojnë treguesin cefalik më të vjetrin evropian dhe pjesa tjetër del një përzjerje evropiane me një element të huaj jashtë Evropës. Kjo është edhe gjendja e etnive sot edhe nga të dhënat historike që do t'i sqarojmë më pas kur të flasim për kombet moderne.

Pra, me një fjalë treguesi cefalik i Evropës ndryshoi në epokën e dyndjeve të popullsisë aziatike, por shumë kombe sot ende ruajnë atë tregues cefalik që kanë patur që në epokën e paleolitit dhe në mes tyre shqiptarët. Duhet thënë se popullsia e vjetër evropiane është ruajtur nga malet. Vërejmë se është ruajtur nga Alpet evropiane, malet Karpate, Dinariket, Pirenejt dhe malet e Kaukazit.

**Madhësia e Kokës** që tregon dhe madhësinë e volumit të trurit. Është vënë re se popullsia brachycephalas, që ka kokë të rrumbullakët, ka dhe kokën më të madhe. Megjithatë ka edhe nga ato që nuk janë brachycephalas që kanë kokë të madhe dhe ka brachycephalas që e kanë vëllimin e kokës së vogël.

Kokën më të madhe në Evropë apo vëllimin e trurit më të lartë e kanë shqiptarët, irlandezët, islandezë, belgët, gjermanët, francezët e zonës së Alpeve, Danimarka e jugut dhe malazezët që janë ilirë të sllavizuar.

Hunda në Evropë është tipike leptorrhin ose dhe mesorrhin. Në Paleoliti njerëzit ishin leptorrhinë në pjesën më të madhe të tyre. Më tepër leptorrhin në Evropë është rajoni i Dinarikeve dhe veçanërisht shqiptarët e veriut dhe malazezët.

Të dhënat antropologjike dëshmojnë se shqiptarët janë një etni tepër e vjetër dhe e pa përzier me raca të tjera. Edhe Evropa Qëndrore ku dominon raca gjermanike, ka një popullsi tepër të vjetër. Evropa perëndimore dhe veri-perëndimore ka një popullsi të përzier nga ana etnike. Evropa lindore dhe Ballkani, ku jeton popullsia sllave, ka një popullsi mezocephalas që tregon për përzjerjen e një pjese të sllavëve të ardhur me popullsinë vendase.

## Pjesa e dytë

# KRIJIMI I KOMBEVE TË EVROPËS

## Origjina e shqiptarëve

Shqiptarët, janë një komb etnik evropian që ka banuar këto troje që në kohët prehistorike dhe kjo dëshmohet nga të dhënat historike, gjuhësore, arkeologjike e antropologjike.

Shqiptarët quhen nga të huajt si Alban dhe këtë emër duket se ata e lidhin me fisin e Albanëve që përmend gjeografi Ptoleme në shek.II. Shqiptarët e kanë quajtur veten e tyre Arbën, pra që është e njëjta fjalë me Alban dhe do të thotë se ata e kanë mbajtur veten e tyre për Alban. Kështu që është një emër lidhur me etninë shqiptare.

Fjalët Alban, Arban dhe Arian kanë të njëjtin kuptim, **i bardhë**. Pra, shqiptarët ruajnë në emrin e tyre simbolin e racës së bardhë.

Shqiptarët e quajnë veten e tyre gjithashtu me emrin shqiponjë, ashtu si dhe gjuhën e tyre. Shqiponja është simboli më i vjetër i arianizmit, e cila ruhet sot në emërtimin tjetër me të cilin e quajnë veten e tyre shqiptarët. Shqiponja lidhet me Zeusin që kishte simbol shqiponjën dhe shqiptarët duhet ta kenë quajtur veten bijë të shqiponjës qysh në kohë të hershme.

Shqiponja, është një simbol që është përdorur nga stërgjyshërit e shqiptarëve si nga Aleksandri i Madh, Pirroja, që e quante veten shqiponjë. Perandorët nga dardania e Ilirisë dhe pikërisht Konstandini i Madh e vendosi shqiponjën si simbol në perandorinë romake. Ky simbol mbeti dhe në Bizant ku perandorët e fundit Arbëresh të Bizantit luftonin nën këtë flamur. Flamuri, që u bë simboli i Bizantit, mbeti dhe si simbol i fesë së lindjes, asaj ortodokse. Kastriotët e patën si flamurin e tyre dhe sot është flamuri kombëtar i shqiptarëve. Flamuri i shqiptarëve pa frikë mund të thuhet që është më i vjetri në botë.

Shqiptarët flasin një gjuhë të veçantë dhe të vjetër, e cila gjendet në të gjitha gjuhët e Evropës, si të vjetrat dhe të rejtat. Pse pikërisht shqipja gjendet në të gjitha gjuhët e Evropës?

Shqipja është nëna që ka folur e gjithë Evropa prehistorike dhe antike. Duke qënë se shqiptarët flasin gjuhën e vjetër të ilirëve, e cila u ruajt për shkak të maleve dhe karakterit kokfortë të shqiptarit, ajo është e vetmja gjuhë ndoshta në të gjithë Evropën që nuk u prek dhe nuk u ndikua nga gjuhët e tjera. Shqiptarët kanë kaq shekuj që jetojnë në kufij me sllavët, por shqipja nuk ka huazuar nga sllavët dh këto huazime janë tepër të rralla. Shqipja është gjuha e maleve ndaj dhe u ruajt në këtë formë të shkëlqyer që është sot. Duke qënë gjuha e substraktit evropian pan-pellazgo-ilirë të bronzit, ajo ishte gjuha nga e cila lindën gjuhët e kombeve evropiane. Është gjuha që lindi gjuhët latine dhe gjermanike.

*Shqiptarët arritën t'i sjellin Evropës sot, një thesar të vërtet arkeologjik, i cili në ndryshim nga objektet memece ka një favor të madh, se flet. Shqipja është vlera më e lartë kulturore që kanë krijuar shqiptarët, përkrah vlerave të tjera dhe padiskutim është edhe një nga vlerat më të mëdha filologjike të qytetërimit Evropian dhe atij Botëror.*

Lidhur me origjinën e shqiptarëve historianët janë të mendimit se kemi të bëjmë me një komb etnik Evropian, që është krijuar në territorin Evropian. Tre janë popujt nga të cilët mendohet se kanë dalë shqiptarët dhe këta janë ilirët, thrakët dhe dakët.

**Teza ilire** e prejardhjes së shqiptarëve është edhe më e përhapura, pasi shqiptarët jetojnë në truallin historik Ilir dhe ka një vazhdimësi kulturore në këto territore kur ridalin në histori me emrin Alban apo Arbën.

**Teza iliro-thrake** sipas së cilës ilirët dhe thrakët ishin nga një grup etnik dhe shqiptarët janë të vetmit pasardhës të tyre. Disa nga historianët tanë dhe të huaj janë zënë midis tyre me shkrime historike duke argumentuar se shqiptarët janë autokton dhe nuk kanë ardhur nga Thrakia.

**Teza dake** është ngritur pasi shqipja përkthen dakishten, ndaj studiuesit janë të mendimit se ata janë dakë, pasi atë gjuhë nuk e përkthen dot rumanishtja, pasardhësja e dakishtes.

Të gjithë studiuesit gabojnë, por edhe kanë të drejtë njëkohësisht. Pse?

Gabojnë pasi kapen pas një emërtimi, i cili nuk ka të bëjë me etninë, se ilirët dhe dakët quhen me emërtime të ndryshme, por ama kanë folur gjuhë të njëjtë, të cilën sot e përkthen shqipja. Kanë të drejtë pasi vërejnë këto ngjashmëri midis fiseve dhe thonë se shqiptarët janë pasardhës të dakëve pasi shqipja përkthen gjuhën e tyre, por ata gabojnë rëndë pasi nga të dhënat arkeologjike, historike, gjuhësore nuk ka dallim etnik midis thrakëve, ilirëve dhe dakëve. Pra, e thënë më qartë shqiptarët për nga gjuha dhe gjaku janë pasardhës të këtyre popujve dhe janë të vetmit sot në Evropë që ruajnë atë gjuhë arkaike. Pra, shqiptarët sot janë:

**Janë ilirë** pasi jetojnë dhe e ruajtën truallin ku u shtri shteti i ilirëve

**Janë epirotë** pasi ato zënë një pjesë të konsiderueshme të etnicitetit aktual shqiptar. Territori i shtetit të sotëm shqiptar shtrihet në pjesën më të madhe të tij mbi territorin e shtetit të Epirit.

**Janë maqedon**, pasi shqiptarët e sotëm banojnë një pjesë të madhe të Maqedonisë antike. Madje po të mos i kishte shpërngulur Greqia me forcë nga Maqedonia jug-perëndimore (Follorin, Kozan, Kastoria, Grevena etj.) shqiptarët sot do të banonin pjesën më të madhe të saj.

**Janë dardanë** pasi dardanët sot përbëjnë sërish një pjesë të konsiderueshme të etnisë shqiptare.

**Janë trojanë** pasi dardanët e Ilirisë ishin ata që themeluan Trojën.

**Janë pellazg** pasi epirotët dhe maqedonët janë quajtur pellazg dhe sot quhen shqiptar.

**Janë romak** pasi vet Roma u themelua nga këta dardanë dhe nga fiset ilire të Italisë.

**Janë panonas** pasi maqedonët, ndryshe quheshin edhe panonas. Panonasit janë quajtur si fis ilir.

**Janë mysë** pasi mysët ishin iliro-thrakë dhe fusha më e madhe në Shqipëri sot mban emrin e mysëve dhe quhet Myze-qe.

Shqiptarët janë edhe **thrakë, dakë, skithë, saramant e baltë**, pasi këto popuj ishin të një origjine me ilirët.

Shqiptarët janë pasardhës të qytetërimit të parë kreto-mikenas dhe qytetërimit antik i quajtur si greko-romak.

Ata janë farefis me racën latine, gjermanike, angleze pasi dhe kjo racë rrjedh nga substrakti ilir i Evropës së bronzit dhe dyndjet gjermanike janë dyndje ilirike.

Të dhënat historike dëshmojnë për një autoktoni dhe vazhdimësi të shqiptarëve në këto territore. Gjuha e shqiptarëve me dy dialekte të mëdha dhe tepër të pasura e të larmishme dhe disa nëndialekte e cila sot gjendet në të gjitha gjuhët e Evropës, dëshmon se ata janë pasardhësit e vetëm nga ana gjuhësore e këtij substrakti ilirik. E them nga ana gjuhësore pasi nga ana e genit kombet gjermanike janë ilire të pastra dhe një racë e vjetër evropiane.

Edhe të dhënat antropologjike dëshmojnë për një vazhdimësi të shqiptarëve në këto territore dhe që janë pasardhës i substraktit të vjetër evropian. Kështu sipas të dhënave antropologjike, shqiptarët janë brachycefal dhe hiperbrachycefalik dhe treguesi qefalik arrin deri në 85-90 që është edhe një nga treguesit më të lartë në Evropë.

Brachycefalik ka qënë edhe popullsia më e vjetër e Evropës që tregon se shqiptarët e kanë ruajtur mirë atë racë. Edhe Epiri ka nga ana antropologjike, popullsi brachycefal dhe hiperbrachycefal njëlloj si të gjithë shqiptarët, edhe Greqia perëndimore ku shtrihet Epiri i Jugut vazhdon ta ketë një dallim të tillë, madje deri në Korinth. Sot pasardhës të popullsisë së lashtë brachycefalike të Evropës së paleolitit, janë shqiptarët dhe raca gjermanike dhe disa rajone të kufizuara malore në Evropë.

Heberland, pohon se në Shqipëri, gjenden të gjitha kostumet që ndodhen në Ballkan. Dhe në fakt Shqipëria ka 220 kostume popullore një numër rekord nga i cili kanë marrë të gjithë fqinjët. Ai e shtrin këtë ndikim kostumesh nga Azia e Vogël, Evropa Qendrore, Ballkani, Italik pikërisht aty ku ka qënë dhe shtrirja më e madhe dhe më e fortë e racës pellazgo-ilire. Nga kostumet, xhubleta e veriut, është si kostumet e etruskëve dhe kretasve. Veshja e burrave të veriut gjendet edhe tek fise gjermanike. Ndërsa veshja me fustanella gjendet në Skoci dhe Gali. Qeleshja shqiptare del tek frigët dhe tek hiperborealët.

Panajot Kupitori në veprën e tij “Studime Shqiptare” thotë se: “**Historianët e Bizantit të shekujve XIV, XV, XVI shqiptarët i quanin arvanit, alvanus, ilirus, trivallus, skithas, mysë, kroat, polanius dhe saramantes.**” (Panajot Kupitori, Studime Shqiptare, Athinë 1879, f.6-7).

Pra, për historianët Bizantin, shqiptarët ishin të vetmit që kishin trashëguar gjuhën dhe racën e vjetër evropiane. Pra, me një fjalë shqiptarët janë i vetmi popull që ruajnë gjuhën dhe etninë e këtij substrakti të vjetër evropian dhe janë pasardhës të popullsisë më të vjetër të Evropës.

### **Gjuha shqipe, substrakti i gjuhëve romano-gjermanike**

.....

#### **Kombet latine**

.....

#### **Origjina e kombit anglez**

.....

#### **Skithët dhe piktët**

.....

#### **Raca e gjermanëve**

.....

### **Kombi grek dhe roli i arvanitëve**

Lidhur me etnicitetin e kombit modern grek ka shumë të dhëna dhe teori kontradiktore. Në antikitet Greqia ka qënë banuar nga disa fise që janë quajtur si helen por me gjuhë apo dialekte të veçanta që sot askush nuk i di se çfarë gjuhe kanë qënë, pasi nuk janë të përkthyer.

Dialekti jonik i Athinës është po aq mister sa dhe gjuhët e vjetra të padëshiruara pasi sot askush nuk ka mundur të përkthejë atë. As gjuha e vjetër greke dhe aq më pak e reja nuk mund të përkthejnë gjuhën origjinale të popullsisë së vjetër helene, pra atë gjuhë që kanë folur jonët, akejt, dorët. Pse? A nuk janë këta grek ata grek?

Kjo është me të vërtetë një nga çështjet më interesante dhe më e paprecedent që ndodh në histori sot, pasi gjuhët që nuk janë përkthyer në antikitet janë lënë pa emër, pra nuk janë të askujt. Ndërsa në Greqi ndodh e kundërta, gjuha e vjetër që kanë folur grekët nuk përkthehet as

nga greqishtja e vjetër dhe as nga ajo e re dhe quhet se është një lloj gjuhe greke. Madje disa shkojnë më larg duke e quajtur edhe gjuhën e Mikenës greke, disa shkojnë edhe më larg dhe e quajnë gjuhën greke të themeluar në vitet 2000 p.k. Do ta quaja një lajthitje në fushën e historisë e cila duhet korrigjuar sa më shpejt.

Se si kanë arritur ta bëjnë këtë kjo është një çështje më vete. Nuk shihen fare këto fakte, thjesht i quajnë grek dhe se pse këto nuk përkthehen nga greqishtja, nuk e vret mendjen asnjë historian e të thotë se çfarë është duke u bërë kështu.

Thjesht greqishtja nuk përkthen dialektet e vjetra të folura në territorin që në antikitet është quajtur grek. Por ashtu siç e pamë kur folëm për etnicitetin e grekve të lashtë ata ishin pellazg dhe shqipja e sotme është nëna që zbërthen fjalë shumë të rëndësishme të gjuhës Homerike dhe dialekteve antike madje dhe tek ajo gjuhë që quhet greqishtja e vjetër gjuha e kishës ka shumë fjalë shqipe. Greqishtja e vjetër mendohet të mos ketë qënë gjuha që ka pas folur populli vendas por gjuha e administratës. Populli duhet të ketë folur një gjuhë që nuk ngjan as me greqishten e vjetër as me atë të re, por pellazgjishten apo një dialekt të saj.

Ashtu si dhe për Ilirinë edhe për Greqinë nuk flitet për disa shekuj që nga shekujt VII deri XI, XII dhe në këto shekuj nuk dihet asgjë për Ballkanin nga pikpamja etnike.

Në shekujt XII-XIII dalin të dhënat e para për Greqinë, por aty nuk del një popullsi greke por një popullsi shqiptare që fliste gjuhën arvanite që është një shqipe e pastër e dialektit tosk. Të gjithë prisnin që në atë tokë të shikonin grek por në vend të tyre dilnin disa shqiptar luftëtar. Meqë në Greqi nuk ka grek studiuesit filluan të hidhnin idera se grekët u zhdukën nga sllavët dhe se shqiptarët ishin ata që zhdukën sllavët që aty dhe e bënë të tyren atë territor. Madje disa studiues dalin dhe me idetë se grekët u asimiluan nga shqiptarët. Duke ndenjtur shumë me shqiptarët që erdhën nga Shqipëria ata e lanë gjuhën e tyre dhe u bënë shqiptar.

Problemi është pra ku janë dhe kush janë grekët? Tashmë kjo ndoshta nuk diskutohet aq shumë por në shekullin e XIX Evropa u shokua nga zbulimi që bëri se në territorin e Greqisë antike nuk kishte popull grek, por vetëm shqiptar.

Duke qënë se në antikitet autorët antik shkruajnë për fiset që kanë përbërë Greqinë se ato ishin të gjitha me prejardhje pellazgo-ilire. Duke qënë se në shekullin XII-XIII kur flitet për territorin e Greqisë ka një popullsi shqiptare dhe jo Greke. Popullsia fliste shqip dhe vetëm kleri dhe gjuha e shtetit ashtu si në të gjithë Bizantin ishte greqishtja. Pra duke marrë parasysh të dhënat që japin autorët antik, mesjetar dhe modern arrihet në një konkluzion se, grekët e vjetër ishin Pellazg dhe se Grekët e rinj në territoret historike të fiseve helene ishin shqiptar. Pra kombi i ri Grek në pjesën më të madhe të tij ishte shqiptar. Gjendja etnike u ndryshua me zgjerimin e territoreve të shtetit grek dhe futjen aty të një popullsie të huaj pra jo shqiptare si turq, sllavë etj.

Disa historianë grek e kundërshtojnë këtë, me arsyen se shqiptarët kanë ardhur në Greqi në shekullin e XIV-XV. Të dhënat tregojnë se atje ka shqiptar edhe para kësaj kohe.

E dhëna e parë që flet për një prezencë të një gjuhe të huaj pra jo-greqisht në Athinë jepet në vitin 1180 dhe është dëshmia e një metropolitit të Athinës i quajtur Mihal Akominatos i cili e cilëson vendosjen e tij në Athinë si një lloj ndëshkimi ai thotë se: **“Athinet që kanë banuar në Atik dhe fshatarët dhe kryesisht këta flasin një gjuhë barbare.”**(Po aty, f.154) Kjo do të thotë se ata flisnin një gjuhë jo-greke dhe kjo gjuhë ka qënë shqipja pasi Athina ka folur historikisht shqipen madje deri në ditët tona. Nëse kjo gjuhë do të ishte greqishtja sigurisht që metropolit do e kuptonte pasi ajo ishte gjuha e kishës dhe nuk kishte prift që të mos e njihje dhe jo më metropolit. Nëse do ishte sllave sigurisht që do e kishte kuptuar që bëhej fjalë për

sllavishten. Pra tjetër gjuhë fqinje ishte shqipja, të cilën sigurisht nuk kishin nga ta mësonin metropolitët dhe as që iu interesonte ta mësonin.

Gjatë kësaj kohe në Greqi udhëheqësit që spikatin janë Arbëresh dhe populli që këta udhëhiqnin ka qënë Arbëresh dhe ka folur këtë gjuhë barbare që ai nuk e kupton.

**Kështu është princi i Naflios, Luan Zguro që luftoi kundër frankëve.**(A.Kola, Arvanitasit, f.149) **Në Mesinë po në këtë kohë sundonin Vranajt.**

**Në 1207 në 17 ishuj të Egjeut sundonte arbëreshi Marino Sanuto. Vëllezrit Andrea dhe Jeremina Giza që ishin udhëheqës të Mikonit dhe Jakob Boroci I që u vendos në krye të Santorinit.**(Po aty, f.152). Pra prania e arvanitëve në Greqi është para se disa shqiptar epirot të emigronin në këto territore dhe është ajo popullsi që edhe qeveris mbi një popull që nuk flet greqisht.

Në shekujt XIV-XV ka dhe valë të zbritjes së arbëreshve në Greqi. Arbëreshët u ftuan për t'u vendosur atje me vulë të Artë të perandorëve Bizantin, të cilët në bazë të disa burimeve dukeshin se ishin me origjinë nga arbëreshët apo pellazgët që kanë banuar gjatë gjithë historisë Greqinë.

**Në vitin 1295 vendosen arbëreshët e parë në Thesali e cila në atë kohë ishte e pushtuar nga tufat e dhënve të Vllehve por që në pak vite Thesalia u kthye në fushë shqiptare dhe Vllehët u tërhoqën në malet e Pindit.**(Po aty, f.158) **Më pas në Thesali dhe Akarnani vijnë Arbëresh të tjerë rreth 12 mijë nga despotati i Epirit që në atë kohë ishte shkatërruar.**(Po aty.)

**Në kohën e Johan Katakuzhinit, despoti i Mistrisit Manuil Kadakuzhini thërret 10 000 shqiptar me familjet e tyre të popullojnë Peloponezin që ishte dobësuar nga sulmet e frankëve dhe turqëve. Pas disa vjetësh një despot tjetër i Mistrisit, Teodori i I i biri i Joanit të V Paleolog thërret edhe 10 000 të tjerë.**(Po aty, f.160)

**Vëllai i tij Mihail Paleologu e lavdëron për këtë veprim të tij dhe thotë “rreth 10 mijë ilirë i solle bashkë me fëmijët dhe gratë, ata e kaluan ismin dhe më pas u zgjeruan dhe ata vetë ishin engjëj dhe nuk është se ishin të papërvojë, por kishin luftuar shumë”**(Lambros, Mbi Paleologët dhe Peloponezin, pjesa II, f.41-42).

**Zbritja e parë në More u krye në 1348 dhe e dyta 1405**(A.Kola, Arvanitët, f.160)

**Ata zbritën në Beoti dhe Lokrida 1383 me thirrjen dhe lejen e zotit të Tebës, Ramon de Vilanova dhe me lejën që mori nga mbreti i tij Petro IV.**(Po aty, f.161).

**Që nga 31.12.1382 Arbëreshët marrin leje të banojnë në Atikë ku zunë fshatrat dhe rrëzët e Akropolit.**(Po aty).

**Venedikasit i thirrën Arbëreshët që të banonin në ishullin e madh të Eube duke filluar nga viti 1402.**(Po aty).

Pra arbëreshët ftuan në Greqi vet sundimtarët e këtij vendi të cilët në disa raste ishin nga arbëreshët e tjerë që ishin vendas. Ata erdhën për të mbrojtur principatat e këtyre sundimtarve pra si ushtarak. Arbëreshët ishin ata që luftuan në vitet e fundit të Perandorisë Bizantine krahas perandorve Bizantin të cilët kishin gjithashtu origjinë arbëreshe. Ishte Pjetër Bue Sklepa i Arkadhias ai që u ngrit të ndalonte që perandori i fundit i Bizantit t'i dorëzohej turqëve të cilët shpallin perandor të Bizantit një Kataguzhin në vend të Paleologut të fundit. Ishin ata që luftuan për të mbrojtur atë territor nga turqit. Pas tradhëtisë së tyre nga Paleologët të cilët e dorëzuan

Peloponezin një pjesë e Arvanitëve filloi të emigrojë drejt Italisë pra pas rënies së Konstandinopojës 1453. Ata u vendosën në Siçili, Kalabri dhe Napoli.

**Në këngën Moj e bukura More ata e quajnë Moren e Peloponezit jo si Greqi por si Arbëri** Kjo do të thotë se shqiptarët e kanë parë territorin e Greqisë së sotme si atdheun e tyre.

Një pjesë tjetër e arbëreshve u vendos në Kretë (Sfaqa), Zakinth, Qefalonia, Korfuz dhe Qipro të cilat i zotëronte në atë kohë Venediku. A.Kola thotë se “Zografot, Kunduruiotët, Markopulosit, Venizelosit, Vretosit që janë familje Kretane janë Arbëresh”(Po aty, f.237). Edhe gjatë kohës së pushtimit turk të gjitha lëvizjet e armatosura i bënin shqiptarët.

Arvanitët janë ata që bënë edhe revolucionin grek dhe formuan shtetin e parë grek. Revolucionin i ashtuquajtur i 1821 nuk ishte as më pak as më shumë një revolucion shqiptar për çlirimin e tokave arbërore nga turqit.

A.Kola thotë se heronj të tjerë arvanit ishin Mjauli, Bubulina, Bakolët, Kriezoti, Kunduriotët, dhe përgjithësisht hidriotët, speciotët, psarianët, grivët, spiromilla dhe përfundimisht për të mos na dhëmb koka duhet të përmendim vetëm ata që nuk janë arvanit. Do me thënë Arvanitas nuk janë Fanariotët (Mavrokordati, Ipsilantët) dhe vllahët dhe maniatët në një far pike.(Po aty, f.479).

Shpesh shqiptarët akuzohen se kanë luftuar për të tjerët dhe jo për vendin e tyre. Në fakt ata nuk kanë qënë naiv pasi ajo tokë që u quajt Greqi ata e quanin Arbëri. Nëse një pjesë e rilindësve kombëtar që e kanë dashur Shqipërinë më tepër se kokën e tyre propozuan bashkimin e Shqipërisë me Greqinë në një shtet, kjo vinte për faktin se ai shtet që quhej Grek ishte shqiptar pra ata kërkonin në një farë mënyre bashkimin e trojeve ku banonin shqiptarët e asaj kohe në një shtet.

Po kështu mbretit të Greqisë së asaj kohe kurorën e shtetit grek ia dorëzuan tre shqiptar. Vet mbreti **Gjergji I** ka thënë se: “**... Arvanitët përbëjnë shumicën e popullsisë sonë**”.(Po aty f.31). Të gjithë kryeministrat në shekullin e XIX ishin arvanit pasi popullsia në shumicën e atij shteti ishte arvanite.

A. *Falmejareri*, një historian i famshëm gjerman, shkruan se: “**...nëse e quajmë Atikën, Shqipëria e re kemi kapur dhe thelbin e teorisë.**”(A.Kola, Arvanitët, f.137)

Pra, në shtetin e ri modern grek të shekullit të XIX popullsia ishte në pjesën më të madhe të saj Shqiptare. Ndërsa një pjesë tjetër ishte Vllahë, e cila nuk ka luajtur rol në krijimin e shtetit modern grek pasi ishin Arvanitët ata që e krijuan dhe ata që e qeverisën atë shtet deri në 1922. Pas këtij viti gjendja ndryshoi pasi arvanitët humbën disi pushtet nga futja e popullsisë të reja në atë territor. Megjithatë arvanitët edhe sot kanë pushtetin në Greqi pasi ata mbahen si zotër të saj dhe aktualisht presidenti i vendit Papulja është një shqiptar i pastër nga të dy prindërit.

### **Pse arvanitët humbën fuqinë që kishin në shtetin grek?**

Ka një numër të madh arsyesh të cilat do të mundohem t’i analizoj si më poshtë:

**Së pari** kryengritja e 1821 ishte një kryengritje shqiptare të krishterë dhe mysliman për të çliruar trojet e tyre nga Turqia. Kjo kryengritje u nxit nga jashtë dhe nga Ali pash Tepelena i cili planifikonte që të bashkonte trojet shqiptare në një shtet dhe në të të fuste dhe Greqinë e kohës që banohej në shumicë nga shqiptarët. Pasi kryengritja e ndihmuar nga jashtë, filloi që të fitonte dhe në këtë kohë kisha ortodokse futi përçarjen midis shqiptarëve krishterë dhe të mysliman dhe nxiti vëllavrasjen. Kjo bëri që shqiptarët të përçaheshin dhe të dobësonin pozitën e tyre. Kisha i quante shqiptarët mysliman si turq pasi nuk i pëlqente feja që ata kishin. Nëse ata e ndërronin fenë dhe bëheshin ortodoks atëherë quheshin grek. Pra ishte roli i kishës ai që e quajti popullsinë ortodokse me emrin grek.



**Së dyti** ishte roli i fuqive të mëdha ku rol ekskluziv ka luajtur Rusia me Francën dhe më vonë Anglia të cilat kërkonin të krijonin një shtet Grek, por jo-shqiptar ashtu siç ishte edhe shumica e popullsisë së shtetit që u krijua. Bota u shokua kur zbuloi se Greqia nuk kishte grek, por në pjesën më të madhe të saj rreth 70% e popullsisë ishte shqiptare dhe një pjesë e tyre dhe mysliman. Kjo nuk ua mbushte mendjen këtyre fuqive. Si është e mundur që këta shqiptar të ishin vet grekët? Bota po ta studionte mirë historinë e shqiptarëve dhe të analizonte shqipen do e kuptonte se grekët e vjetër dhe romakët dhe gjithë qytetërimi antik është vepër e gjyshërve të shqiptarëve, pra me një fjalë e këtyre shqiptarëve që bota ka një shekull që po i persekuton dhe nuk u ka dhënë vendin që meritojnë. Sot mburren disa kombe falco dhe të stisura me kulturën dhe qytetërimin pellazgo-ilir apo e thënë më qartë atë shqiptar dhe shqiptarët që i kanë dhënë botës kaq shumë janë poshtëruar vlarë e përçarë mu në zemër të Evropës. Kjo ka ardhur nga injoranca dhe disinformimi historik që duhet të korrigjohet.

Pra ato nxitën krijimin e një shteti artificial grek që në shumicë ishte shqiptar të cilët me ose pa dëshirë dhe të drejtuar nga kleri ortodoks filluan të zhdukin të gjithë udhëheqësit shqiptar të Revolucionit shqiptar për krijimin e shtetit grek. Kështu heroi kombëtar i atij që quhet shtet grek sot shqiptari Kolokotroni u burgos dhe u dënua me vdekje dhe për mëshirë u fal. U vranë apo u zhdukën Andrucua, Karaiskaqi, Bubulina etj. Bashkëpunimi ndërkombëtar me atë kishtar dhe pak neglizhenca e shqiptarëve përballë këtij presioni bëri të mundur që të hidheshin bazat e një kombi artificial grek dhe që la në hije kombsin e vërtet të tij më shumicë shqiptare. Shteti grek nuk është gjë tjetër veçse shteti i parë shqiptar që u krijua në Ballkan në kohët moderne, por që iu ndërrua identiteti etnik, pasi i bënë të flisnin një gjuhë artificiale me zor.

**Së treti** diskriminimi i gjuhës së arvanitëve. Kjo gjuhë deri sot nuk lejohet të mësohet në shkollat vetëm çfarë mësohet privatisht. Jo që nuk u bë gjuhë zyrtare por edhe u përndiq nga kleri ortodoks çmenduria e të cilit shkonte deri aty sa t' u thoshte arvanitëve se Zoti nuk kupton shqip. Një komb po i hoqe gjuhën dhe i imponove një gjuhë tjetër ai ka mbaruar pra është asimiluar. Arvanitët edhe pse nuk e kanë përdorur gjuhën e tyre në shkollë e flasin atë në shtëpi. Janë qytetet e Thivës, Livadjas rrethinat e Athinës dhe mbi 300 fshatra në të gjithë territorin e Greqisë së sotme që nuk njohin gjuhë tjetër në përdorim të përditshëm veç shqipes së tyre të lashtë.

Pra shtetit të ri me shumicë popullsi shqiptare iu imponua një gjuhë artificiale ajo greke. Greqia e përbërë nga disa etni, nuk njeht asnjë minoritet, pasi të gjitha këto etni i qan si Grek. Kjo është pjesa e lojës pasi nëse shqiptarët, vllahet, sllavët, turqit e atjeshëm do të ishin secili sipas etnisë së tij atëherë merrte fund kjo lojë që krijoi një kombësi artificiale dhe ai shtet shpërbëhej ose hynte në konflikte etnike të brendshme.

Arvanitët nuk pranojnë që në shtetin e tyre të quhen minoritet, por nga ana tjetër atyre nuk iu është lejuar që të mësojnë gjuhën e nënës dhe e flasin atë në shtëpi. Pra ajo gjuhë artificiale që u fut si zyrtare ashtu siç ishte në shtetin e Bizantit u bë dalëngadalë edhe gjuha e popullit pasi fëmijët atë mësonin në shkollë deri sa zëvendësoi në pjesën më të madhe të saj gjuhët e secilës etni që përbënte kombin grek.

**Së katërti** pas vitit 1922 hynë popullsi të reja si pasojë e zgjerimit territorial. Deri në këtë vit pothuajse të gjithë kryeministrat edhe presidenti pra elita politike e shtetit ishte arvanite pasi shumicën e popullsisë e përbënin arvanitët. Por pasi zgjerimi solli popullsi sllave turke, vllahë. Gjithë këta popuj të tjerë shuan historinë e arvanitëve pasi nuk u leverdis që të thonë se ata ishin që bënë Greqinë dhe janë autokton në ato territore. Pas kësaj filloi edhe persekutimi i arvanitëve sidomos të myslimanëve të cilët u kristianizuan të gjithë.

Edhe sot e kësaj dite një pjesë e madhe e kombeve që përbëjnë shtetin grek si arvanitët, sllavët dhe vllahët flasin gjuhët e tyre në shtëpi dhe greqishten e përdorin në publik e në shkollë.

Pra, nuk ka komb grek të mirëfilltë, por një komb artificial me një gjuhë që nuk është gjuha e popullit. *Për t'i bërë të gjithë këta një komb u përdor greqishtja si gjuhë, feja ortodokse dhe ideologjia heleniste si nacionalizëm.*

Një nacionalizëm i tejskajshëm nga një shtet që nuk është as komb, është i pashembullt në histori. Madje shumë studiues janë marrë të analizojnë nacionalizmin grek të etnive të ndryshme që duket një nacionalizëm sa i rrezikshëm, por edhe qesharak për atë kohë sa nuk ka një komb grek.

Kisha dhe struktura të caktuara kanë përpunuar një ideologji të tërë nacionaliste për të krijuar një ndërgjegje kombëtare greke artificiale e cila vazhdon edhe sot. Pra roli i saj është i madh madje nuk do ishte e ekzagjeruar të thoshim se pa kishën ortodokse të Greqisë nuk do ishte krijuar kjo etni greke artificiale.

Provë e qartë që kemi të bëjmë me një komb të stisur është fakti se grek mund të bëhesh lehtësisht. Kështu nuk ka rëndësi se je i zi apo i bardhë se je nga Kina apo nga Afrika, rëndësi ka vetëm një gjë të kesh dëshirë të bëhesh grek. *Pra nuk merret fare parasysh etnia që ti je rëndësi ka që ti të jesh dakort që të marrësh etninë greke. Kështu ata që janë brenda, kanë etni të ndryshme por kanë një dëshirë të përbashkët që të jenë grek, kështu që nuk prish punë fare se vijnë të bardhë apo të zinj brenda shtetit grek pasi aty të gjithë janë të ndryshëm por kanë një gjë të barabartë se të gjithë vdesin nga dëshira të jenë grek.*

Arvanitët përbëjnë sot një pjesë të madhe të atij që quhet komb grek në mënyrë të pranueshme janë dy milion dhe sipas organizatave të të drejtave të njeriut janë katër-pesë milion. Pas vitit 1922 kisha ndoqi një politikë represive ndaj gjuhëve të tjera sidomos shqipes dhe sot e kësaj dite ku në Greqi jetojnë me miliona shqiptar nuk ka një shkollë shqip dhe kjo tregon mos tolerancë ndaj kulturës së arvanitëve. Kjo vjen edhe për shkak të neglizhencës së arvanitëve atje të cilët kanë qënë të përcarë nga kisha ortodokse dhe që marrëzit kanë shkuar deri atje sa disa prej tyre që seriozisht nuk dinë se kush janë në të vërtetë, flasin shqip dhe thonë që nuk jemi shqiptar.

Greqia nuk ka vetëm pellazgët e vjetër që sot quhen arvanit, por ka dhe një popullsi tjetër shqiptare nga Epiri i Jugut dhe Maqedonia perëndimore e cila në masë është asimiluar dhe kush nuk pranoi që të bëhej ortodoks me bekimin e kishës u degdis në shkretëtirat e Anadollit. U ç'popullua me forcë fara e Aleksandrit të Madh dhe Pirros në mes të Evropës. Popullsia që u suall nga Azia ishte një popullsi ortodokse por shqiptare në pjesën më të madhe të saj. Shkëmbimi i popullsisë u bë për tekat e kishës e cila mori myslimanët shqiptarë dhe i shkëmbu me ortodoksit shqiptar.

Megjithatë që vazhdojnë të thuhet dhe bëhen pjesa e Epirit deri në Korinth sipas të gjitha të dhënave antropologjike është e një etnie me shqiptarët dhe del me karakteristikat Brachycephalas ashtu siç janë shqiptarët e sotëm. Bregdeti i Epirit dhe Greqia veri-perëndimore deri në Korinth antropologjikisht ka një popullsi të pastër e të vjetër evropiane. Më pas ajo vjen e përzierë ashtu si dhe është faktikisht.

Në territore të Greqisë ku ka influencë sllave dalin karakteristikat e popullsisë sllave dhe në territoret e tjera ato të popullsisë aziatiko-afrikane.

Pra, nuk ka komb grek në kuptimin e mirëfilltë të fjalës dhe as nuk ka patur ndonjëherë. Kombi i vjetër grek është më tepër një shpikje e historianëve sesa një e vërtetë ku greqishtja e vjetër dhe e re nuk përkthejnë gjuhën që ka folur i ashtuquajtur i komb antik grek.

Fiset që kanë banuar Greqinë antike kanë qënë të gjitha pellazgo-ilire dhe kanë folur një gjuhë që nuk ka të bëjë fare me greqishten e vjetër apo të re përderisa ajo nuk përkthehet. Fakti që në mesjetë nuk ka sërish komb grek por shqiptar tregon qartë se grekët jo më shumë dhe jo

më pak por janë vetë arvanitët. Edhe sot nuk ka komb grek por një komb i stisur me disa raca brenda që mëson greqishten artificiale sërish nën parullën e Sokratit që grek është ai që mëson greqishten.

Studiuesit vrasin mendjen për të shpjeguar se ku shkuan grekët që nuk ka asnjë gjurmë të tyre, si u zhdukën. Grekët nuk janë zhdukur ata janë ku ishin por nuk janë ata lloj grekësh që kanë përkufizuar disa historian romantik, por janë vet arvanitët. Historianët sot dëshirojnë të gjejnë të vërtetat, por nisen mbi një bazë të rreme ndaj dhe nuk u del asnjë gjë në lidhje me kombin grek. Ata nuk kanë ekzistuar kurrë në atë mënyrë që historianët i kanë përkufizuar ndaj dhe nuk gjenden. Historianët kërkojnë grekët pasardhësit e grekve të vjetër por ata kanë konceptuar etninë greke të vjetër shumë gabim ndaj dhe nuk kanë gjetur të rinjtë. Grekët e vjetër ishin pellazg dhe pasardhësit e tyre të vetëm janë shqiptarët arvanit të Greqis së sotme dhe shqiptarët kudo që janë. Nëse vazhdojnë akoma me këtë teorira që kanë vazhduar deri tani të presin se do t'i gjejnë.

Arvanitët dhe shqiptarët Epirot dhe Maqedon janë ata që përbëjnë edhe sot pjesën më të rëndësishme të kombit grek dhe gjuha e tyre është shqip dhe nuk kam përse të ndalem në gjuhën e etnisë më të rëndësishme të kombit grek pasi ajo është shqipe e pastër e dialektit Tosk. Ajo që do ndalem është që të analizoj disa fjalë të gjuhës artificiale greke të cilat janë shqip apo që shpjegohen nga shqipja. Ato janë trashëguar nga trungu pellazgo-ilir.

**vazo** vendos pra një folje **vë**

**voras** **veriu**

Fjala ka rrjedhur nga fjala bora, nga që në antikitet veriu i territoreve nga ku ndodheshin pellazgët e Greqis, është quajtur me fjalën **boras**. Kështu fjala shqip e ruan të dy variantet edhe fjalën veri siç e ka greqishtja edhe fjalën boria për borën. Kështu fjala boria ku v zëvendëson b quhet voria apo veri. Por fjalën borikos që tregon veriun me borë mund ta përkthejë vetëm shqipja e cila edhe sot borës i thotë borë ndërsa greqishtja ka marrë fjalën borë të shqipes ku b është zëvendësuar me v dhe në vend që për vendet e veriut të përdorë fjalën boria ashtu siç e përdor gjithë Evropa, përdor fjalën voria.

**botanika** **botanika**

Fjala botanika është një fjalë origjinale shqipe që tregon planetin dhe sot shqiptarët e përdorin fjalën bota për të emërtuar planetin dhe asnjë gjuhë tjetër përveç shqipes nuk e ka si të tillë. Në asnjë mënyrë nuk mund të jetë e huazuar kur është një fjalë kaq e rëndësishme dhe që aktualisht e përdor shqipja me një kuptim të tillë, por jo greqishtja dhe gjuhët e tjera latine apo gjermanike, pasi ato kanë fjalë tjetër për fjalën bota. Shqipja me këtë fjalë ka formuar disa fjalë të tjera si botoj, botkuptim, botëror, botim, botues etj.

Shqip **bota**

italisht **mondo**

spanjisht **mondo**

frëngjisht **monde**

anglisht **world**

greqisht **kozmos**

**vronto** **bubullon**

Fjala e ka origjinën tek fjala vrenjtur që është koha kur bie shi, nga ka rrënjën edhe fjala shi në greqisht. Kjo fjalë është trashëguar edhe tek disa gjuhë sllave ku koha quhet vreme.

Greqishtja nga fjala shqip vronto që tregon se është vrenjtur ka nxjerrë fjalën bubullij. Gjatë kohës që moti është i vrenjtur ka edhe bubullima dhe ajo gjuhë për të treguar bubullimën ka marrë fjalën vronto. Po të shikosh edhe fjalën bubullij është një fjalë arkaike dhe tepër origjinale, pasi ajo është formuar nga vet zhurma që shkakton bubullima që bën bu-bu dhe si e tillë është quajtur bubullim. Kjo tregon dhe arkaizmin e gjuhës shqipe.

**gdhermo rrjep**

Edhe shqipja sot e përdor në formën **gdhen** që tregon edhe rrjepjen e drurit.

**gjitonas fqinjë**

Fjala gjitona do të thotë **gji+ton=komshiu apo gjiton apo vllazërin**.

Fjala gjiton tregon se e kemi fqinjë afër në gjirin tonë. Ndryshe për afërsin që ka gjitoni quhet ndryshe dhe vëlla apo vllazëri.

**Gji toka**

Kjo fjalë e ka origjinën tek fjala gji e shqipes pasi është toka ajo që e ushqen njeriun ashtu si nëna fëmijën me gji dhe për këtë fakt ajo ka marrë këtë emër kaq kuptimplot pasi ajo e ushqen njeriun ashtu si nëna fëmijën me gjirin e saj. Janë disa fjalë që e kanë rrënjën tek fjala gji si *gjeografia, gjeofizik, gjeoteknika, gjeometria*. Njerëzit e tokës quhen **gjin**os.

**gjidha dhia**

Ashtu si dhe lopa e kanë të dyja rrënjën tek fjala gji pasi me ato japin qumësht dhe për këtë është thënë gjitha për të treguar dhin.

**gremizo gremis** nga fjala gremis

**glosa gjuha**

Fjala glosa e ka origjinën tek fjala **glu** pasi në këtë rast gegërishtja nuk e përdor gj por g. Kjo fjalë është e pastër shqip dhe në fakt greqishtja e vjetër për çudinë e të gjithëve ka shumë nga gegërishtja e shqipes sesa nga toskërishtja. Të gjitha fjalët që kanë për bazë **glosën** janë me origjinë shqipe.

**gurgurizo gurgullon**

Kjo fjalë tregon ujin që gurgullon në një përrua apo lum me gur. Kjo fjalë është shqip pasi fjala gur greqishtja nuk e ka por ka fjalën petra. Pra greqishtja e përdor artificialisht pasi vetëm shqipja e ka fjalën gur në gjuhën e saj edhe sot.

**grinia grindja**

Fjala tregon dy persona që zihen apo grinden me njëri-tjetrin. Kjo fjalë është shqip pasi personat që grinden arrijnë të grihen me njëri-tjetrin. Këtu është përdorur folja grij apo grin e shqipes për të treguar grindjen.

**gjimni lakuriq**

Tregon një person që është pa rroba dhe që në radhë të parë ka nxjerrë gjijtë përjashta. Nga fjala gji del fjala gjimni që tregon se personi është lakuriq. Këtu e ka origjinën dhe fjala gjimnastik.

Shqipja përdor një fjalë tepër arkaike **lakuriq** për të treguar që je pa rroba. Kjo fjalë duhet të jetë formuar në kohë tepër të lashta pasi aty tregohet qartë kuptimi i fjalës nga **lakur-iq** pra personi që ka heq lëkurën. Kjo fjalë është formuar në atë kohë kur njerëzit rrinin të veshur ende me lëkura pra tepër arkaike dhe tepër origjinale për gjuhën shqipe pasi ajo i ka që të dyja sot si dy fjalë të veçanta fjalët që përbëjnë këtë fjalë.

**gjineka grua**

Gruaja në greqisht shpjegohet nga shqipja që tregon edhe kuptimin e saj **gji-ne-ka pra ka gji**. Në fakt edhe anglishtja për fjalën sistër përdor të njëjtën formë të shqipes kështu **sistregon** që ajo është femër ashtu si këtu **gji** tregon se ajo është femër.

**dhino jap**

Kjo fjalë shpjegohet nga folja në shqip jep e cila në kohën e shkuar bënë dhenë apo dhino. Në fakt edhe vetë procesi i të dhënit tregon se ajo tashmë ka ndodhur pra ti e jep apo e ke dhënë.

**dhorizo dhuroj** po tek folja dho apo dha  
**ethonos etni** apo komb.

Kjo fjalë është shqip pasi fjalën **etër** sot e përdor vetëm shqipja dhe që ka kuptimin e baballarëve apo të etërve që formojnë së bashku kombin. Fjala **at** në njëjës bën etrit në shumës. Nga kjo fjalë janë formuar disa fjalë si *etnografia, etnikotita*.

**ekinisi nisje** nga fjala **nis** që është edhe më e shkurtër në shqip  
**thrino kujë** ulërim

Rrjedh nga fjala **thrino apo thëras** që tregon ndryshe edhe vënie e kujës.

**qendrikos qendër**

Kjo fjalë kudo që përdoret mund të shpjegohet vetëm nga shqipja. Kështu ajo e ka kuptimin **që** është **ndër** të tjerat dhe që tregon edhe vetë kuptimin e fjalës qendër.

**kuvenda kuvend**

Një fjalë shqipe e cila përdoret edhe sot kështu madje edhe vet parlamenti quhet si kuvend. Kjo fjalë që greqishtja e ka marrë nga arvanitët pasi ata mblidheshin dhe bënëin kuvende është një fjalë e pastër shqip që tregohet nga ku+vend.

**krato shtet**

Fjala Krato në greqisht ka dalë nga folja kratao, që do të thotë mbërthej mbaj. Me çfarë mban njeriu? Sigurisht që me krat që kra i quan vetëm shqipja sot por jo greqishtja.

**krio ftoht**

Fjala e ka origjinën tek fjala **ngri** e shqipes pasi personi që ka ftohtë krin, ngrin ku k dhe g janë zëvendësuar nga njëra-tjetra.

**krunis krua**

Një fjalë e dialektit geg të shqipes, e cila në këtë formë shqiptohet edhe në greqisht.

**pan tan**

Pra fjala pan në shqip përkthehet me fjalën tan apo të gjithën. Kjo fjalë është tërësisht shqip ku p dhe i kanë zënë vendin njëra tjetrës. Është vetëm fjala shqip tan që mund të tregojë edhe kuptimin e vërtetë të fjalës pan.

**paradhino kapitulloj**

Shpjegohet nga të dyja fjalët e shqipes **para-dhino** pra që para-jepem pra që ka edhe kuptimin e kapitulloj.

**paraveno dal nga fjalët para-ven** që tregon edhe kuptimin e fjalës që kanë dal përpara apo ven para nga shqipja.

**pelagos pellg**, oqean në antikitet

Kjo fjalë përdoret në disa gjuhë në këtë kuptim por rrënjën e ka tek fjala pellg e shqipes. Fjala pellg tregon ndryshe edhe një vend plot me ujë që në këtë rast nxjerr oqeanin. Këtu e ka origjinën edhe fjalë arqipelag.

**Pelargos lejlek** nga fjala **pe-larg** që është edhe cilësia e lejlekut që shtegton larg. Kjo fjalë që përmendet tek Straboni tregon se si i thoshin lejlekut në dialektin Jon që sot nuk

është përkthyer ende. Kur u bë pastrimi i gjuhës artificialisht u fut edhe kjo fjalë meqë e kanë folur jonët.

### **Pera matan tutje**

Shpjegohet nga **para** e shqipes e cila e përdor edhe sot në këtë form dhe tregon saktësisht përpara. Greqishtja përdor fjalën mbrosta për të treguar para ndërsa shqipja edhe sot fjalën para.

**Pigadhi**        **pusi** nga fjala pi

**Pigji**        **burim nga pi-gji** pra pi si në gji pasi në burim ashtu pihet sikur je në gji.

**Pino**        **pi** folje që në formën e saj më të shkurtër pra rrokore gjendet edhe sot tek shqipja.

**pis**        **pas** apo mbas

**pirgos**        **kështjell**

Kështjellat ndërtoheshin mbi një vend të ngritur të izoluar për të qënë të mbrojtur nga sulmet e huaja. Pirg sot në shqip i thonë një vendi të ngritur që është sinonimi i kodrës mbi të cilën ngrihet kështjella.

**pluto**        **pasuria**

Fjala e ka origjinën tek fjala shqip pluto që tregon edhe pasjen plot.

**spile**        **shpell**

Fjala spile rrjedh nga fjala shqip shpell.

**thema**        **tema**

Tema e ka fjalën për diçka që do trajtohet dhe për të cilën do flitet. Meqë do flasim për diçka ndryshe në shqip thuhet që do themi. Pra nga folja **them** ka dalë dhe tema.

**tromazo**        **tromaksem** sërish nga fjala trembem e shqipes.

### **Kombi Rumun**

.....

### **Illirët dhe sllavët**

.....

### **Origjina e etnisë dhe gjuhës sllave**

.....

### **Epilog**

Populli pellazgo-ilir ka qënë populli më i rëndësishëm i antikitetit dhe nga ai rrjedhin qytetërimet, kombet, gjuha dhe kultura e lashtë evropiane si dhe ajo moderne. Këto dëshmohen nga të dhënat historike, arkeologjike, gjuhësore dhe antropologjike.

1. Qytetërimet e vjetra evropiane si ai i Kretës, Mikenës, Trojës dhe Etruskë kanë qënë vepër e popullit pellazgo-ilir pasi kjo dëshmohet nga të dhënat historike që tregojnë se kjo etni ka ngritur këto qytetërimet. Edhe të dhënat antropologjike dëshmojnë se popullsia e vjetër e këtyre qytetërimeve ka qënë Brachycephala ashtu siç janë Shqiptarët sot pasardhësit e popullsisë pellazgo-iliro-thrako-dako-trojano-skithe e më gjërë. Por qytetërimi i bronzit dhe i hekurit i

Evropës është një qytetërim pellazgo-ilir. Nëse do iu referohemi të dhënave të tjera nga kjo etni duket se janë themeluar edhe shtetet e vjetra si ai Egjiptiane dhe shtetet e Mesopotamisë duke filluar me qytetërimin Sumer. Kjo dëshmohet nga të dhënat historike që tregojnë për një prezencë të kësaj race në këto territore që në kohë të hershme. Kështu të dhënat antropologjike dëshmojnë se në deltën e Nilit dhe tek Sumerët tre mij vjet para krishtit, ka banuar një popullsi e bardhë. Të dhënat e mëpasme historike tregojnë se kjo popullsi ka qënë me origjinë pellazgo-ilire. Madje edhe dyndet e popujve të detit janë dyndjet e kësaj popullsie drejt këtyre territoreve në shekullin e XIII p.k. pasi aty dalin dardanët, lidët etj. që ishin fise pellazgo-ilire.

2. Grekët antik nuk janë një etni ata janë thjesht fiset pellazgo-ilire që kishin një nivel kulturor më të lartë se fiset e tjera të këtij trugu dhe kjo fal pozitës gjeografike dhe kushteve natyrore. Ai që quhet qytetërim antik grek është qytetërim pellazg pasi të tre popujt që kanë banuar Heladhën antike ishin me origjinë pellazge. Kështu jonët ishin pellazg, dorët ishin ilir dhe eolët pellazg. Atëherë ku janë grekët?

Nuk ka dhe nuk ka ekzistuar kurrë komb grek. Gjuha e vjetër greke është një gjuhë e stisur për t'u përdorur nga të diturit e kohës. Si mund të dal në këtë konkluzion? Është e lehtë, ajo gjuhë e vjetër greke nuk përkthen asnjë fjalë të jonishtes, dorishtes dhe eolishtes. Shkrimet e tyre edhe sot janë në gur dhe nuk flasin, askush nuk e di se çfarë gjuhe kanë përdorur, por një gjë është e sigurt se ajo është një gjuhë e ndryshme nga gjuha greke e vjetër dhe e re. Pse greqishtja nuk përkthen këto gjuhë? Ajo nuk ka sesi t'i përkthejë kur popullsia ishte e gjithë pellazgo-ilire dhe fliste këtë gjuhë që sot gjendet tek shqiptarët. Mirë do bëjnë studiuesit që të marrin shqipen e sotme dhe sidomos gegërishten dhe t'i futen punës të përkthejnë shkrimet antike. Fakti që në kohët moderne në Greqi nuk kishte popull grek por shqiptar tregon se asnjëherë nuk ka patur grek. Kombi modern grek një komb artificial i përbërë nga disa etni ku pjesën më të madhe e zënë shqiptarët kanë një gjuhë artificiale që nuk është gjuha e tyre por gjuha që kisha dhe shteti vendosi të kishte. Kjo gjuhë u pastrua dhe rregullua dhe iu imponua popullit duke ja vendosur si gjuhë të detyrueshme, dhe kështu u krijua një etni artificiale ashtu siç është edhe sot.

Edhe qytetërimi antik romak ishte pellazgo-ilire pasi Italinë në antikitet e kanë banuar këto fise nga jugu në veri. Vetë romakët e mbanin veten e tyre si pasardhës të dardanëve të Trojës, por dardanët e Trojës janë ata të Ilirisë që sot ende jetojnë në territorin e tyre dhe quhen shqiptar. Qytetërimi romak rrodhi nga ai etrusk apo tusk që ishte gjithashtu një qytetërim pellazg. Disa studiues kanë arritur që me shqipen e sotme të përkthejnë shumë shkrime etruske.

3. Evropa e kohës së bronzit ka patur një popullsi të njëjtë nga ana etnike që ka pas folur të njëjtën gjuhë apo dhe dialektet e saj. Të dhënat tregojnë se pellazgët, ilirët, thrakët, dakët, skithët, saramantët, trojanët deri në Atlantik kanë qënë popuj të një etnie. Sipas të dhënave ata kanë folur një gjuhë të përbashkët e cila ka qënë shqipja arkaike. Ka qënë kjo gjuhë sepse ajo gjendet në të gjithë gjuhët antike dhe moderne evropiane dhe iu jep kuptimin fjalëve të këtyre gjuhëve. Shumë fjalë të gjuhës së vjetër latine dhe fjalë që kanë përdorur pellazgët e quajtur si helen janë shqip madje shqipja i përdor edhe sot. Këto fjalë nuk janë të huazuar pasi në shqip ato kanë kuptimin e asaj që duan të shprehin. Megjithëse gjuha latine dhe ajo greke e vjetër duket se janë gjuhë të krijuara ato sërish kanë shumë fjalë shqipe brënda tyre. Populli që është quajtur me emrin romak apo dhe helen ka qënë një popullsi ilire që ka folur këtë gjuhë, pasi të dy gjuhët si latinishtja dhe greqishtja nuk përkthejnë gjuhën që ka shkruar dhe folur populli i tyre. Shumë nga fjalët që kanë mbërritur nga kjo gjuhë që kanë folur pellazgët helen dhe romak janë sot tek shqipja dhe marrin kuptim nga ajo. Nga ana tjetër shqipja përkthen edhe gjuhën e dakëve dhe është e vetmja gjuhë që iu jep kuptim fjalëve të tyre pasi ajo i ka edhe sot këto fjalë në fondin e saj të gjuhës së përditshme.

Straboni dëshmon se dakët kanë patur të njëjtën gjuhë me thrakët, skithët. Kjo do të thotë se dhe këto fise kanë folur një gjuhë shqipe, për aq kohë sa shqipja është e vetmja që i përkthen gjuhën dake. Trojanët kanë pas folur një gjuhë shqipe pasi shumë nga fiset trojanë janë me origjinë nga Thraka dhe iliria ashtu si dardanët që përbëjnë sot një pjesë të konsiderueshme të kombit shqiptar.

4. Në shekujt V-VI kur fuqia e Romës ra, të shtyrë nga dyndjet e popullsisë me origjinë Aziatike një pjesë e popullsisë etnike evropiane u detyrua të emigrojnë nga territoret e Ilirisë dhe Detit të Zi në drejtim të perëndimit që njihen dhe si dyndje gjermanike. Të dhënat mesjetare tregojnë se këto fise ishin me origjinë Ilire. Ato ndikuan shumë në krijimin e kombeve moderne gjermane, angleze, franceze etj.

Faktet antropologjike, historike dhe ato arkeologjike dëshmojnë një gjë të tillë. Shqipja luan sot një rol shumë të madh në shpjegimin e kuptimit të fjalëve që këto gjuhë flasin aktualisht. Shpjegimi i fjalëve “të mëdhaja” që kanë përdorim ndërkombëtar tregon se ato janë formuar nga dy fjalë të shqipes që ajo sot i ka si operator të lirë, pasi janë fjalë rrokore. Për shumë fjalë të tyre kuptimin e vërtet e ruan gjuha shqipe. Gjetja e shqipes si gjuhë shpjeguese në këto gjuhë tregon se ato kanë lindur nga një gjuhë e përbashkët e racës së bardhë apo siç quhet ndryshe Japetike dhe këtë gjuhë sot e ruan shqipja për shkak të kushteve gjeografike, historike dhe karakterit të shqiptarët.

5. Teoria e gjuhëve indo-evropiane është një teori që duhet rishikuar pasi ajo është ngritur pa studiuar gjuhën shqipe e cila është gjuha që kanë folur edhe popujt të vjetër Evropian dhe shumë e quajnë gjuhën e racës së bardhë asaj Japetike. Nuk mund të nxirren teorira të tilla pa studiuar gjuhën substrakt të Evropës atë shqipe me gjithë dialektet e saj të pasura. E them këtë pasi vërej se fondi i fjalëve të përbashkëta midis gjuhëve evropiane dhe sanskritishtes gjendet i gjithë tek shqipja. Madje shqipja këto fjalë i ka dhe sot në gjuhën e saj të përditshme dhe këto fjalë marrin shpjegimin vetëm nga kjo gjuhë. Gjuhtari i mirë është ai që është së pari një historian i mirë, pasi nuk mund të përcaktosh një gjuhë në disa kategori pa parë se si kanë qënë kushtet historike që kanë çuar në këtë përfundim.

Fjalët që sot gjenden tek gjuha indiane dhe iraniane nuk janë fjalë që gjenden nga gjuhët evropiane me këto gjuhë por gjenden midis shqipes dhe këtyre gjuhëve. Këto fjalë janë marrë nga shqipja si tek evropianët dhe tek aziatikët. Ky është edhe çelsi që tregon për gabimin e bërë deri më sot nga gjuhëtarët të cilët kanë nxjerrë konkluzione pa studiuar shqipen dhe historinë. Historia dëshmon se në periudhën e bronzit këto territore janë pushtuar dhe sunduar nga një racë e bardhë. Kështu shumerët janë një popullsi jo-semite. Po të shikosh me vëmendje ka një ko incidencë midis një fisi ilir të quajtur medë me Medët. Jordanes dëshmon se parthët janë mysë pra ilirë. Tek ilirët ka gjithashtu edhe një fis të quajtur parthë dhe nga këta duhet ta kenë origjinën dhe parthët. Nga ana tjetër dëshmohet se skithët kanë patur nën pushtetin e tyre Azinë deri në oqeanin Lindor që duhet të bëhet fjalë për Paqsorin pasi ai ndodhet në lindje. Madje një popullsi indo-skithe ka qënë prezent deri vonë në Indi dhe ka lënë edhe gjurmët e saj atje edhe sot. Kjo popullsi ishte e një rrace e Dakët dhe fliste një gjuhë me ta, pra një gjuhë shqipe. Duke qënë se Skithët dhe Parthët apo ndoshta dhe Medët ishin një popullsi që ka emigruar nga Evropa në Azi atëherë ajo ka lënë edhe fjalët e saja tek këto gjuhë. Pra lidhjen e gjuhëve Evropiane me gjuhët Aziatike gjuhëtarët duhet ta shikojnë nëpërmjet shqipes. Shqipja është çelsi për të zbrëthyer të vërtetën rreth këtyre gjuhëve.

Shqiptarët sot janë një komb prehistorik që jeton në trojet e tij në Ballkan prej mijra vjetësh. Paraardhësit e shqiptarëve i kanë dhënë Evropës qytetërimin etnik Evropian si atë



prehistorik dhe atë antik që u bë baza e qytetërimit modern. Ata kanë luajtur një rol të madh në formimin e kombeve moderne të Evropës dhe gjuhëve të tyre.